GRATIS SHQ ENG

Prishtinart

KORRIK 2025

Prishtina – qytet që frymon përmes artit

Monumentet
që rrëfejnë historinë

Kitaristi
virtuoz i rokut

Ms. Indefinite:
Artistja
që thyen heshtjen

Kurrizi
i dy kohëve

Shtrirja e
kulturës me objektet e harruara

Mirë se vini në Prishtinë

Numri i tretë i revistës PrishtinArt vë në fokus gratë dhe artin. Në të, po ashtu, trajtohet hapësira, dhe veçmas rigjenerimi i hapësirave të reja të artit në kryeqytet. Kthimi pas në kujtesën mbi rezistencën paqësore të Kosovës është një dëshmi e kujdesit ndaj themeleve të shtetit, e shëtitja nëpër monumentet e trashëgimisë kulturore është thirrje për vizitorët që të eksplorojnë Prishtinën dhe Kosovën në përgjithësi.

Welcome to Prishtina

The third issue of PrishtinArt magazine focuses on women and art. This edition also explores urban space, with particular attention to the regeneration of new artistic spaces in the capital city. Looking back on Kosovo's peaceful resistance is a testament to the care and respect for the foundations of statehood, while a walk through the monuments of cultural heritage serves as an invitation for visitors to explore Prishtina—and Kosovo more broadly.

PRISHTINA**ART**

Nr. 3 – Korrik 2025

Drejtore e kulturës
Sibel Halimi

Kryeredaktor
Artan Krasniqi

Gazetarë/Redaktorë
Alberina Haxhijaj
Elvira Berisha
Gent Mehmeti
Gili Hoxhaj
Taulant Qenaj

Lektore
Adelinë Selmani

Përkthyes
Salih Mehmeti

Bashkëpunëtorë
Baki Hoti
Shemsi Krasniqi
Sabit Gashi

Fotograf
Xhevdet Dervodeli

Layout & disenj
Enisi Vidishiqi

Marketing
info@utk-ks.org

Shtypi
Blendi

Komuna e Prishtinës
Republika e Kosovës

Unioni i Turizmit të Kosovës
Tourism Union of Kosova

SHQIP

Arti që ngjall qytetin: Një vizion për Prishtinën si hapësirë e ndjeshmërisë publike

Hyjnesha në fron disa interpretime dhe ripërdorime

Rrëfimi i Herticëve për shtëpitë-shkolla

Shtrirja e kulturës me objektet e harruara

Kurrizi i dy kohëve

Lagjja ku merr jetë arti

Prishtina – qytet që frymon përmes artit

Kitaristi virtuoz i rokut

"Defy Them" Një mikrokozmos rezistence artistike

Një rrugë e re për "Dodonën": Vizioni i Arta Muçaj

ENGLISH

06 Art that Revives a City: A Vision for Prishtina as a Space of Public Sensitivity

10 Goddess on Throne Some Interpretations and Reusages

14 The Hertica Family Story

18 Cultural Enrichment Through Forgotten Spaces

22 The Spine of Two Eras

26 The Neighborhood Where Art Is Brought to Life

30 Prishtina – A City That Breathes Through Art

34 The Virtuoso Guitarist of Rock

38 "Defy Them" A Micro-Cosmos of Artistic Resistance

42 A New Path for "Dodona": The Vision of Arta Muçaj

Prishtina bëhet një me artin e Armendit

Kultura në focus

Fiona Llapashtica: Muzika gjithmonë më ka bërë të lumtur

"Çast" kundër stigmës e nxitje për drejtësi

"FemArt": Arti si protestë e skena si fuqi

"Shliroj Cicat" kundër kancerit të gjirit

Ms. Indefinite: Artistja që thyen heshtjen

Zërat e "Zanave": Një lidhje moderne me trashëgiminë muzikore

Prishtina më dha guximin dhe lirinë e ëndrrave

Në cep të qytetit: "Open Art" dhe vizioni i një artisti

Engji Jaha zëri i veçantë i brezit të ri në artin kosovar

Si u bënë muret e Prishtinës kanavacë e shpirtit të qytetit

Kosova drejt zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm

E pa botën, rrëfen Kosovën

Monumentet që rrëfejnë historinë e Prishtinës

Festë, ngrohtësi dhe vëmendje ndërkombëtare

"Lady" - dera që për gratë nuk mbyllet kurrë

Rrëfimi i një trashëgimie që i shpëtoi harresës

46 Prishtina Becomes One with Armend's Art

48 Culture in Focus

59 Fiona Llapashtica: Music Always Made me Beautiful

62 "Çast": A Stand Against Stigma, A Call for Justice

66 "FemArt": Art as Protest, Stage as Power

70 "Free the Boobs" Against Breast Cancer

74 Indefinite: An Artist Who Breaks the Silence

78 The Voices of 'Zanat': A Modern Bond with Musical Heritage

82 Prishtina Gave Me the Freedom and Courage to Dream

86 Engji Jaha, The Distinct Voice of Kosova's New Artistic Generation

90 Engji Jaha, The Distinct Voice of Kosova's New Artistic Generation

94 How Prishtina's Walls Became the City's Soulful Canvas

98 Kosova Towards a Sustainable Tourism

100 She Saw the World, She Speaks of Kosova

103 Monuments that Reveal Prishtina's History

108 Festivity, Warmth, and International Attention

110 "Lady", A Door That Never Closes For Women

114 A Story of a Legacy that Escaped Oblivion

Arti që ngjall qytetin

Një vizion për Prishtinën si hapësirë e ndjeshmërisë publike

Art that Revives a City

A Vision for Prishtina as a Space of Public Sensitivity

Sibel HALIMI
DREJTORE E KULTURËS

DIRECTOR OF CULTURE

Çfarë e bën një qytet të jetë më shumë sesa grumbull ndërtesash dhe rrugësh? Është mënyra se si kujdesemi për hapësirat e përbashkëta, si i ndajmë kujtimet, tingujt, fjalët dhe heshtjet. Është mënyra si i japim kuptim jetës së përditshme, përtej funksionalitetit dhe përtej nevojave bazë. Në këtë kuptim, arti nuk është luks dhe as dekor, është formë themelore e ndërtimit të qytetit. Është mënyra si qyteti flet, si reflekton dhe si guxon të mendojë ndryshe.

Prishtina nuk është thjesht kryeqyteti administrativ i Kosovës, është një hapësirë në transformim të vazhdueshëm. Është një qytet me histori të thella dhe plagë të hapura, me energji të reja dhe vizione që kërkojnë përkrahje. Në këtë udhëtim, arti është pasqyrë dhe udhërrëfyes, një formë rezistence ndaj harresës, një mënyrë për të rikrijuar bashkëjetesën dhe për të rizbuluar ndjeshmërinë publike.

Në kohë fragmentimesh urbane dhe shpirtërore, arti është ndërhyrje. Ai nuk është zbukurim festiv, por ndërtim themelor i strukturës sonë si qytet. Theodor W. Adorno e përshkruante artin si "negativitet i pastër", një fuqi që shfaq boshllëqet e botës dhe i jep formë së mundshmes. Kjo fuqi është jetike për Prishtinën tonë, një qytet që ka kaluar përmes traumave kolektive dhe tani e ka gjetur gjuhën e re për ta përfytyruar të përbashkëtën.

Me edicionin e tretë të "Prishtina Art", nuk flasim vetëm për artin si përjetim, por si strukturë rezistence, si mënyrë e re e të jetuarit hapësirën. E kemi nisur aty ku më parë kishte harresë dhe frikë, në bunkerët e Ulpianës, të shndërruar në qendra arti; në Tunelin e Kurrizit, dikur simbol i errësirës urbane, sot shteg simbolik ndërmjet së shkuarës dhe imagjinatës së re kolektive. Michel Foucault do t'i quante këto heterotopi, hapësira reale që sfidojnë rendin dominues dhe imagjinojnë të mundshmen përtej tij. Këto hapësira janë tani pjesë e një hartografie të re kulturore që po e

What makes a city more than a cluster of buildings and streets? It is the way we care for shared spaces, the way we share memories, sounds, words, and silences. It is how we imbue daily life with meaning, beyond mere functionality and basic needs. From this perspective, art is neither a luxury nor decoration. It is a fundamental form of city-making. It is how a city speaks, how it reflects, and how it dares to think differently.

Prishtina is not merely the administrative capital of Kosovo. It is a space in constant transformation. A city with deep histories and unhealed wounds, yet also pulsing with new energy and visions that seek support. On this journey, art is both a mirror and a guide, a form of resistance against forgetting, a way to reimagine coexistence and rediscover public sensitivity.

In times of urban and spiritual fragmentation, art becomes an intervention. It is not a festive adornment, but a structural cornerstone of our identity as a city. Theodor W. Adorno described art as "pure negativity," a force that reveals the voids of the world and gives shape to what is possible. This force is vital for our Prishtina, a city that has endured collective trauma and now seeks a new language to imagine that which is common.

With the third edition of Prishtina Art, we do not speak of art solely as experience, but as a structure of resistance, a new way of living space. We began in places once marked by neglect and fear: in the bunkers of Ulpiana, transformed into art centers; in the Kurrizi Tunnel, once a symbol of urban darkness, today a symbolic pathway between the past and a renewed collective imagination. Michel Foucault would call such places heterotopias, real spaces that defy dominant order and imagine new possibilities beyond it. These spaces are now part of a

ndërtojmë për Prishtinën.

Rikthimi i degës së bibliotekës në "Ulpianë" pas vitesh të tëra mbylljeje, inicimi i ndërtimit të qendrës së re kulturore dhe degën e bibliotekës në "Kodrën e Trimave", si dhe renovimi i qendrës kulturore dhe degën e bibliotekës në Llukar, janë akte të kujdesit, jo veprime teknike. Kujdesi nuk është më përjashtim, është drejtim. Siç thoshte Hannah Arendt, veprimi politik lind aty ku njerëzit ndajnë një hapësirë të përbashkët dhe e ndërtojnë botën së bashku.

> **Prishtina nuk është thjesht kryeqyteti administrativ i Kosovës, është një hapësirë në transformim të vazhdueshëm. Është një qytet me histori të thella dhe plagë të hapura, me energji të reja dhe vizione që kërkojnë përkrahje.**

Inaugurimi i Orkestrës së Kryeqytetit është një tjetër gur themeli i këtij vizioni. Muzika, në këtë kontekst, nuk është vetëm tingull, është kujtesë, emocion, dhe shpirt i një qyteti që kërkon të flasë dhe të ndiejë. Ashtu siç thoshte Nietzsche, "Jeta pa muzikë do të ishte një gabim". Orkestra nuk është trupë artistike, por trup i përbashkët i qytetit, një vend ku përmes tingullit, ndërtojmë ndjeshmëri publike.

E gjithë kjo qasje është pjesë e një plani të qëndrueshëm, Strategjia për Art dhe Kulturë 2026–2030. Një strategji që nuk fokusohet vetëm në festivale apo performanca madhështore, por në punën e përditshme, të vogël e të domosdoshme, që e mban gjallë shpirtin e qytetit. Ne synojmë arkitekturë kulturore të decentralizuar, ku çdo lagje ka hapësirën e vet të artit, të librit, të mendimit. Ky investim është njëkohësisht edhe investim në demokracinë e përjetuar të qytetit. Jacques Rancière e quan artin "rindarje e ndjeshmërisë",

new cultural cartography we are drawing for Prishtina.

The reopening of the Ulpiana library branch after years of closure, the initiative to build a new cultural center and library branch in Kodra e Trimave, and the renovation of the cultural center and library in Llukar, these are not technical gestures, but acts of care. Care is no longer an exception, it is a direction. As Hannah Arendt observed, political action begins where people share a space and build the world together. These interventions are not just infrastructure. They are restored collective life, an investment in the future of critical thinking, creativity, and free expression.

The inauguration of the Capital City Orchestra is another cornerstone of this vision. Music, in this light, is not merely sound. It is memory, emotion, and the spirit of a city that longs to speak and feel. As Nietzsche once said, "Life without music would be a mistake." The orchestra is not simply an artistic ensemble. It is the shared body of the city, a space where, through sound, we cultivate public sensitivity.

This entire approach is part of a sustainable plan, the Strategy for Art and Culture 2026 to 2030. A strategy that does not focus solely on festivals or grand performances, but on the daily, quiet, necessary work that keeps the spirit of the city alive. We endeavor for a decentralized cultural architecture, where each neighborhood has its own space for art, books, and thought. This investment is equally an investment in the lived democracy of the city. Jacques Rancière describes art as a redistribution of the sensible, for it opens new paths for collective experience. This is why, through Prishtina Art, we do not treat art as a theme but live it as a worldview of critical thought, a way to understand how a city speaks, remembers, and interacts.

For the first time, during the year-end holidays, Prishtina took on an atmosphere reminiscent of modern metropolises, with visually engrossing, warm, and contemporary decorations. This year's decor resonated not only in local media but also internationally, placing Prishtina on the visual map of cities that celebrate with dignity and identity.

> **Prishtina is not merely the administrative capital of Kosovo. It is a space in constant transformation. A city with deep histories and unhealed wounds, yet also pulsing with new energy and visions that seek support.**

Just in this year alone, the Directorate for Culture has supported 250 projects, including 143 in the fields of visual arts, cultural heritage, publishing, and cultural organizations, and 107 in areas such as festivals, music, film, theater, and other cultural events. This support is not merely statistical. It is a profound commitment to a diverse, inclusive,

sepse ai krijon rrugë të reja të përjetimit kolektiv. Pikërisht për këtë, në "Prishtina Art", ne nuk përfaqësojmë artin si temë, por e përjetojmë si botëkuptim të të menduarit kritik, si mënyrë për të kuptuar si flet qyteti, si kujton e si ndërvepron.

Për herë të parë, gjatë festave të fundvitit, Prishtina mori një pamje dhe atmosferë që i afrohet metropoleve moderne, me dekorime vizuale tërheqëse, të ngrohta dhe bashkëkohore. Dekorimi i këtij viti ka bërë jehonë jo vetëm në mediet vendore, por edhe në artikuj ndërkombëtarë, duke e sjellë Prishtinën në hartën vizuale të qyteteve që festojnë me dinjitet dhe identitet.

> **Në kohë fragmentimesh urbane dhe shpirtërore, arti është ndërhyrje. Ai nuk është zbukurim festiv, por ndërtim themelor i strukturës sonë si qytet.**

Vetëm gjatë këtij viti, Drejtoria për Kulturë ka mbështetur 250 projekte, duke përfshirë 143 projekte në fushat e artit vizual, të trashëgimisë kulturore, të botimeve dhe të organizatave kulturore, si dhe 107 projekte në fusha, si: festivale, muzikë, kinematografi, teatër dhe manifestime kulturore. Kjo mbështetje që ofrojmë nuk është thjesht statistikë, është përkushtim i thellë ndaj një jete kulturore të larmishme, gjithëpërfshirëse dhe të gjallë për të gjithë qytetarët.

Në çdo projekt që mbështesim, synojmë të nxjerrim në pah zërat unikë të artistëve dhe të krijojmë hapësira ku kultura mund të lulëzojë pa kufij, siç na kujton Paulo Freire, "Arti është një vegël për emancipimin dhe transformimin shoqëror." Prandaj, besojmë se arti është ura që lidh njerëzit, duke ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të hapur, më tolerante dhe më të bashkuar. Ne si institucion e kemi obligim të orientojmë vendin, të prijmë në këtë rrugëtim dhe të krijojmë hapësira ku kreativiteti dhe diversiteti kulturor shërbejnë si forcë për zhvillim dhe emancipim.

Prandaj, përmes artit dhe kulturës ne kemi komunikuar duke respektuar të gjitha grupet shoqërore, pa dallim, sepse arti shpreh në thelb dashurinë ndaj njeriut, ku të qenët ndryshe nuk është tjetërsim, por pasuria që na bën shoqëri.

Në një botë që shpesh na ndan në individë të izoluar, ku koha rrëshqet përmes shpejtësisë digjitale, ne zgjodhëm të investojmë në atë që na mban bashkë, fjalën, tingullin, imazhin, ndjeshmërinë kolektive. Kultura nuk është luks, është strukturë e nevojshme për një qytet që kërkon të mbijetojë me dinjitet dhe të zhvillohet me ndjenjë.

Kultura është rezistencë ndaj harresës, banalitetit dhe dhunës

and vibrant cultural life for all citizens.

> **In times of urban and spiritual fragmentation, art becomes an intervention. It is not a festive adornment, but a structural cornerstone of our identity as a city.**

For this reason, we believe art is the bridge that brings closer people, helping to build a more open, tolerant, and united society. As an institution, it is our duty to guide the country, to lead this journey, and to create spaces where creativity and cultural diversity serve as forces for development and emancipation.

Through art and culture, we have communicated with respect toward all social groups, without exception, because art, at its core, expresses a love for humanity, where being different is not alienation, but the richness that makes us a society.

In a world that often isolates us as individuals, where time slips away in digital haste, we choose to invest in what keeps us together, words, sounds, images, collective sensitivity. Culture is not a luxury. It is a necessary structure for a city that aims to survive with dignity and grow with heart.

Culture is resistance, against forgetting, against banality, and against the symbolic violence

simbolike që e zvogëlon njeriun në konsumator. Arti, përkundrazi, e kujton njeriun si krijues, bashkëpërgjegjës dhe të aftë për krijimtari të lirë e mendim kritik.

Ky është vizioni ynë. Një Prishtinë që nuk e koncepton kulturën si përjashtim të rrallë, por si përditshmëri të përbashkët. Një qytet që nuk i sheh institucionet si mure, por si ura. Një qytet ku fëmijët rriten me librin pranë, me muzikën në rrugë dhe me artin si pjesë të vetes. Një qytet që guxon të kujdeset për shpirtin e vet.

Dhe ky është vetëm fillimi.

Me edicionin e tretë të "Prishtina Art", nuk flasim vetëm për artin si përjetim, por si strukturë rezistence, si mënyrë e re e të jetuarit hapësirën.

With the third edition of Prishtina Art, we do not speak of art solely as experience, but as a structure of resistance, a new way of living space.

that reduces the human to mere consumer. Art, on the contrary, reminds us of our human capacity to create, to be responsible together, and to think critically and freely.

This is our vision. A Prishtina that does not conceive culture as a rare exception, but as a shared everyday life. A city that does not view institutions as walls, but as bridges.A city where children grow up with books nearby, music in the streets, and art as part of their being. A city that dares to care for its own soul. And this is only the beginning.

HYJNESHA NË FRON
Disa interpretime dhe ripërdorime

Hyjnesha në fron, artefakti muzeal ndër më kryesorët në Kosovë dhe logo e qytetit të Prishtinës, paraqet një figurë mjaft komplekse dhe sinkretike, që në vete ngërthen sisteme të ndryshme simbolike. Origjina e saj daton nga parahistoria, por në kohën tonë është riaktualizuar duke u bërë simbol identitar dhe imazh i përditshëm në jetën institucionale, kulturore dhe publike në Kosovë.

SHEMSI **KRASNIQI**

Disa interpretime

Është misterioze kjo figurë dhe sekreti kryesor i saj nuk është forma e dukshme, por përmbajtja e padukshme; nuk është simbolika dhe stili i paraqitjes, por materiali përbërës dhe motivi i bërjes së saj. Ajo përbëhet prej dheut, prej tokës, prej kësaj materie jetëdhënëse, e cila është faktike e reale, por njëkohësisht hyjnore dhe sakrale. Pra, ajo përbëhet prej materies që jep jetë dhe që realisht është vetë jeta në llojllojshmërinë dhe përhershmërinë e saj. Hyjnesha në fron paraqet tokën hyjni, tokën me "shpirt", tokën e gjallë dhe jetëdhënëse. Jeta dhe gjallëria në tokë janë domethënia e saj kryesore, prandaj ajo është një përtokëzim i hyjnores, sikurse edhe një hyjnizim i tokësores. Edhe Gaya Hypothesis thotë se planeti Tokë është i gjallë dhe duhet ta trajtojmë si të tillë. Në raport me Tokën jemi sikurse në raport me jetën. Edhe kjo figurinë e vogël, tashmë simbol dhe pjesë e jetës sonë të përditshme, na bën me dije se lidhja jonë me tokën nuk është vetëm materiale dhe fizike, por edhe shpirtërore dhe simbolike.

Trupi i saj është i pozicionuar në mënyrë frontale, është stabil dhe elastik, misterioz dhe enigmatik, por edhe simetrik e estetik. Është i vogël dhe i bukur, por njëkohësisht solemn e madhështor. Ajo nuk ka gojë, por ka hundë për të marrë e për të dhënë frymë, për të marrë e për të dhënë erë. Ushqimi i saj është frymëmarrja, aroma e jetës, e tokës, e farës, e bukës. Jeta është frymëmarrje, sikurse që frymëmarrja është jetë. Vijat dhe vrimat në trupin e saj janë akte veprimi, pune, rituali, dekori dhe ceremonie; janë brazdat e pllugut në arë, janë fidanët e mbjellë në kopsht, janë farat e futura në dhe, janë sythat, janë shenjat e reprezentimit simbolik të marrëdhënies sonë me tokën. Puna, rituali, besimi dhe arti kanë qenë një në kulturat e lashta.

Hyjnesha në fron nuk është vetëm hyjnore, por edhe njerëzore, animale, vegjetale, minerale, energjike dhe substanciale. Ajo është vetë larmia e jetës dhe asaj që e mundëson jetën. Pse s'ka gjinj? Sepse ka duar që ushqejnë me punë. Duart e vendosura në bel, në pjesën jetëdhënëse të trupit, janë mjetet e punës të lidhura me tokën, po ashtu jetëdhënëse, janë mjetet e jetës që ushqejnë, që mbajnë gjallë.

GODDESS ON THRONE
Some Interpretations and Reusages

The Goddess on Throne, one of the most outstanding museal artefacts and the emblem of Prishtina, represents a complex and syncretic figure conveying various symbolic systems. Though it stretches back to prehistory, it has been recontextualized in our time as a symbol of identity and a daily image in the institutional, cultural, and public life in Kosova.

Some Interpretations

The figure remains mysterious, and its principal secret lies not in its visible shape, but in its invisible content; not in its symbolism or the style of its appearance, but in the material it is made of and the motive behind its creation. It is composed of earth, this life-giving matter that is tangible and real, yet at the same time divine and sacred. It consists of the substance that gives life, which, in truth, is life itself in all its variety and permanence. The Goddess on the Throne represents the divine Earth – Earth with a 'soul,' the living, life-giving Earth. Its essential meaning lies in the presence of life and vitality within the Earth; that is why it stands as both an earthly embodiment of the divine and a divinization of the earthly. Even the Gaia Hypothesis maintains that Planet Earth is alive and should be treated as such. Our relationship with the Earth mirrors our relationship with life itself. And this small figurine, now a symbol and part of our daily lives, reminds us that our bond with the Earth is not merely material and physical, but also spiritual and symbolic.

Her body is positioned frontally, stable and elastic, mysterious and enigmatic, yet also symmetrical and aesthetic. It is small and beautiful, yet at the same time solemn and

Pse s'ka këmbë? Sepse ka rrënjë. Eshtë statike, por edhe dinamike, ceremoniale dhe sedentare. Ajo përbëhet nga toka, është e lidhur për tokë, mbahet për tokë, bie në tokë dhe çohet prej toke. Prandaj është pikërisht tokësore, e jo jashtëtokësore, siç thonë disa. A është shtatzënë? Po, sepse toka përherë është shtatzënë. Shtatzënia është gjendje e saj e përhershme. Jetëdhënia është dhèjetëdhënie. Akti i lindjes, nuk është momental, por procesual, ritmik, permanent.

Pse i ka sytë e mëdhenj? Sepse sheh përtej, sheh nga çdo anë, sheh gjithçka dhe gjithmonë. Sheh tokën dhe qiellin, sheh brenda e jashtë, sheh poshtë e lart, sheh anash, para e mbrapa. Sheh ditën e natën, sheh në dritë e në terr, sheh mbitokë e nëntokë. Sheh trupin dhe shpirtin, sheh gëzimin dhe dhimbjen, sheh bulëzimin dhe frytnimin e natyrës. Me sytë e saj ajo sheh dhe e ndien impulsin e jetës në çdo gjë, sheh dhe ndien farën e vet në krejt ciklin jetësor, në krejt rruzullin tokësor. Shikimi i saj është frytnim i farës, mbarësim i jetës.

Disa mënyra të përdorimit

Duke e konsideruar si njërin ndër artefaktet e tij kryesore, Muzeu Kombëtar i

majestic.

She has no mouth, but a nose to breathe, to take in and release air, to receive and give scent. Her nourishment is breath: the aroma of life, of earth, of seed, of bread. Life is breath, just as breath is life. The lines and holes on her body are acts of labor, ritual, decoration, and ceremony. They are the furrows plowed in a field, the saplings planted in a garden, the seeds pressed into the soil, the budding shoots. They are signs, symbolic representations of our relationship with the earth. In ancient cultures, labor, ritual, belief, and art were one.

The Goddess on the Throne is not only divine – she is also human, animal, vegetal, mineral, energetic, and substantial. She embodies the diversity of life itself and everything that makes life possible. Why does she have no breasts? Because she has hands that nourish through labor. Her hands, placed at her waist, in the life-giving part of the body, are tools of work, connected to the earth, which is also life-giving. They are instruments of life: they feed her, they keep her alive.

Why does she have no legs? Because she has roots. She is static, yet dynamic, ceremonial and sedentary. She is made of earth, connected to the earth, grounded in it; she falls to the earth and rises from it. She is, therefore, fully terrestrial, and not extraterrestrial, as some might suggest.

Is she pregnant? Yes, because the Earth is always pregnant. Pregnancy is her perpetual state. Life-giving is earth-giving-life. The act of birth is not a momentary event, but a process: rhythmic, ongoing, and permanent.

Why are her eyes this large? Because she sees beyond, she sees in every direction, sees everything, and sees always. She sees the earth and the sky, the inside and the outside, below and above, to the sides, ahead and behind. She sees day and night, in light and in darkness, above ground and underground. She sees both body and soul, joy and sorrow, the budding and the fruition of nature. With her eyes, she sees and senses the impulse of life in all things; she sees and feels her own seed throughout the entire cycle of life, across the whole Earth. Her gaze is the fertilization of the seed, the conception of life itself.

Some Ways the Figure Has Been Used

Recognizing as one of its most important artifacts, the National Museum of Kosova has adopted the figure as its emblem. The Goddess on the Throne also serves as the emblem of the Municipality of Prishtina. In the aftermath of the war, the figure emerged as a symbol of the city's identity – not only because it was discovered in Prishtina, but also because it embodies the antiquity and continuity of life and culture in Kosova since prehistoric times. Its selection as a logo was influenced not just by its age, but also by its striking and mysterious appearance. Another important factor was its symbolic return: it was the only artifact recovered and brought back to Kosova after having been looted by the Serbian regime in the 1990s, when around 1,500 archaeological, ethnological, and historical artifacts were taken from the Museum of Kosova.

Being part of Prishtina's identity, the Goddess on the Throne appears

Kosovës këtë figurë e ka bërë logo të vet. Por Hyjnesha në fron është logo edhe e Komunës së Prishtinës, kryeqytetit të Kosovës. Pas luftës, u bë simbol i identitetit të qytetit, sepse përveç se ishte gjetur në Prishtinë, ajo paraqiste lashtësinë dhe kontinuitetin e jetës dhe të kulturës në Kosovë që nga periudhat parahistorike. Përveç lashtësisë, edhe pamja e saj e bukur dhe misterioze ishte shtysë për përzgjedhjen e saj si logo, e sigurisht se edhe fakti se ishte artefakti i vetëm i kthyer në Kosovë, nga plaqkitja që kishte bërë regjimi serb i viteve '90 - rreth 1500 artefakteve arkeologjike, etnologjike dhe historike të Muzeut të Kosovës.

Duke u bërë pjesë e identitetit të Prishtinës, Hyjnesha në fron haset vizualisht nëpër disa pika të rëndësishme të kryeqytetit, por atje ku shihet si skulpturë është hyrja në qytet kah ana e Veterrnikut, atje pra te Rrethi i Flamurit, pastaj edhe te Rrethi i Arbërisë, te Hotel Prishtina etj., kurse si foto shihet në shtyllat e lajmërimeve publike, pastaj në kabinat e stacioneve të autobusëve urbanë, në shtyllat e semaforëve në Bulevardin "Bill Clinton", e madje edhe në kunjat që e pengojnë parkimin e veturave nëpër trotuare. Veç kësaj, për të huajt që vizitojnë shitoret e suvenireve nëpër Prishtinë ose edhe ato në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" ku, pa dyshim se, suveniri i parë që u bie në sy është figura e reprodukuar e Hyjneshës në fron. Krejt kjo tregon se ky imazh është bërë i pandashëm nga kryeqyteti ynë dhe nga identitetit kulturor dhe shtetëror i Kosovës.

Krahas kësaj, kjo figurë aktualisht po përdoret edhe si logo e festivaleve të filmit në Kosovë, si "Pri-Film Fest" në Prishtinë, "Hyjnesha në fron" në Fushë-Kosovë, si dhe e njëjta vlen edhe për Seminarin Ndërkombëtar të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare që mbahet çdo vit në Universitetin e Prishtinës.

Po ashtu, ka shumë raste kur kopertinat e librave të historisë janë ilustruar me imazhin e Hyjneshës në fron. Së fundmi, shumë artistë kosovarë janë duke e përdorur këtë si motiv artistik nëpër pikturat e tyre. Në të vërtetë përdorimi i saj në krijimtarinë artistike është goxha i moçëm, sepse artisti i njohur

---

visually in several important locations throughout the city. As a sculpture, it is prominently displayed at the city's entrance from the Veternik side, at the Flag Roundabout, at the Arbëria Roundabout, near Hotel Prishtina, and in other places. As a photograph, it can be seen on public notice boards, in urban bus station cabins, on traffic light poles along Bill Clinton Boulevard, and even on the bollards that prevent cars from parking on sidewalks. In addition, for international visitors who frequent souvenir shops in Prishtina or at the Adem Jashari International Airport, the first item that often grabs their attention is the reproduced figure of the Goddess on the Throne. All of this shows how this image has become inseparable from the capital city and from the cultural and national identity of Kosova.

In addition, this figure is currently being used as the logo of film festivals in Kosova, such as 'Pri-Film Fest' in Prishtina, 'The Goddess on the Throne' in Fushë Kosovë, and likewise by the International Seminar on Albanian Language, Literature, and Culture, held annually at the University of Prishtina.

Similarly, there are many cases where the covers of history books have been illustrated with the image of the Goddess on the Throne. Most recently, many Kosovar artists have been using this as an artistic motif in their paintings. In fact, its presence in artistic creation goes back quite some time, as the well-known Kosovar artist Simon Shiroka, distinguished for his works in the filigree technique, had already created several pieces with this motif during the 1980s.

In October of last year, Kosova participated for the first time in "Village de la Francophonie, 2024", which was held in Paris, at the margins of the 19th Summit of the International Organization of La Francophonie; the figure of the Goddess on the Throne was one of the representative images of Kosovo.

The image of the Goddess has frequently appeared in caricature. The well-known Kosovar cartoonist Jeton Mikullovci used this motif at the moment when Kosova failed in its attempt to join UNESCO. At that time, he depicted the Goddess in three poses: first with her hands covering her mouth, then her head, and finally in the third image, the Goddess is shown weeping and rubbing her eyes in sorrow over Kosovo's rejection from UNESCO.

Another caricature by the same artist carries an environmental message. During the winter months, the air in Kosova's capital becomes extremely polluted, often reaching hazardous levels. In this caricature, the Goddess appears shrouded in thick clouds of dust, showing visible signs of suffocation.

The news outlet Kallxo, on the occasion of Kosova's acquisition of its own dialing code (+383), published a caricature of the Goddess holding a phone, with the caption "Goodbye 038." The figure was also used as a caricature during the COVID-19 pandemic, depicted wearing a face mask.

Beyond its artistic use, the Goddess

kosovar, Simon Shiroka, i njohur për punimet e tij në teknikën filigran, qysh në vitet `80 ka bërë disa punime me këtë motiv.

Në tetor të vitit të kaluar, Kosova mori pjesë për herë të parë në festivalin "Fshati i Frankofonisë, 2024" ("Village de la Francophonie, 2024") që u mbajt në Paris, në margjinat e Samitit të 19-të të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe figura e Hyjneshës në fron ishte njëri prej imazheve më reprezentative të Kosovës.

Bukur shpesh, imazhi i Hyjneshës është përdorur edhe si karikaturë. Karikaturisti i njohur kosovar, Jeton Mikullovci, e përdori atë në momentin kur Kosova dështoi në përpjekjen e saj për t'u anëtarësuar në UNESCO. Ai atëherë e pati paraqitur Hyjneshën në tri pozicione: fillimisht me duar në gojë, pastaj në kokë dhe në pamjen e tretë Hyjnesha qan dhe i fërkon sytë nga pikëllimi pse Kosova nuk u pranua në UNESCO. Karikatura tjetër e po këtij autori është e karakterit mjedisor. Siç dihet, gjatë stinës së dimrit, ajri në kryeqytetin e Kosovës është tepër i ndotur, aq sa arrin edhe gjendjen Hazardous. Në këtë karikaturë Hyjnesha paraqitet e mbështjellë me re të dendura pluhuri dhe me shenja të ngulfatjes. Portali "Kallxo", me rastin e lejimit të prefiksit të Kosovës (+383) kishte bërë karikaturën e Hyjneshës me telefon në dorë, ku shkruante "Lamtumirë 038". Si karikaturë qe përdorur edhe gjatë pandemisë COVID-19, kur në fytyrën e saj qe vendosur një maskë.

Përveç përdorimit me karakter artistik, Hyjnesha është duke u përdorur shumë edhe për qëllime komerciale dhe artizanale. Tashmë dyqanet e argjentarisë në Prishtinë, kanë nxjerrë në shitje aksesorë me imazhet e saj, kurse dyqanet e suvenireve përveç reprodukimeve, shesin edhe magnetë për frigoriferë, si dhe aksesorë për çelësat e veturës ose të shtëpisë me imazhin e saj. Bluza për burra dhe për gra, me këtë simbol, po ashtu gjenden nëpër shitore suveniresh, kurse imazhi i figurinës së njohur shfaqet edhe në produktet e stilisteve kosovare të modës.

Fusha e cila më së shumti e fuqizon imazhin e Hyjneshës, është ajo e dokumenteve civile. Letërnjoftimet biometrike që kanë filluar të lëshohen viteve të fundit në Kosovë, në pjesën

e prapme të tyre e kanë imazhin e Hyjneshës në fron. Në sfondin e figurës paraqitet harta e Kosovës, kurse prej Hyjneshës dalin rrezet të cilat shpërndahen në të gjitha anët e hartës. Kjo e bën këtë figurë të lashtë si simbolin kryesor të Kosovës bashkëkohore; kjo në të vërtetë paraqet identitetin e ri të Kosovës dhe kjo e bën Hyjneshën brendim kosovar.

Ripërdorimi i simboleve të mëhershme në kohë të mëvonshme, është praktikë e njohur jo vetëm e shoqërisë sonë dhe as vetëm e kohës sonë. Ripërdorimi i Hyjneshës në fron, kësaj figure parahistorike, në ditët e sotme, është një përpjekje për ta dëshmuar kontinuitetin e jetës në Kosovë, por edhe për të treguar autenticitetin dhe identitetin e trashëgimisë sonë kulturore, qëndrueshmërinë e saj në kohë dhe integrimin e saj në identitetin bashkëkohor, kulturor dhe shtetëror të Kosovës.

has increasingly become a motif in commercial and artisanal products. Jewelry shops in Prishtina have begun selling accessories bearing her image, while souvenir stores offer not only replicas but also refrigerator magnets and keychains for house or car keys featuring the same figure. T-shirts for men and women bearing this symbol are also widely available in souvenir shops, and the image of the figurine has made its way into the designs of Kosovar fashion stylists.

The field where the image of the Goddess has gained the most symbolic weight is that of civil documents. The biometric ID cards issued in Kosova in recent years feature the image of the Goddess on the Throne on their reverse side. In the background it appears the map of Kosova, with rays of light emanating from the Goddess and spreading in all directions across the map. This visual composition positions the ancient figure as the central symbol of contemporary Kosova; it reflects Kosova's new identity and elevates the Goddess into a truly Kosovar brand.

The reuse of ancient symbols in later periods is a well-established practice, not only in our society and not only in our time. Reviving this prehistoric figure in the present day is an attempt to affirm the continuity of life in Kosova, while also asserting the authenticity and identity of our cultural heritage, its resilience through time and its integration into the contemporary cultural and national identity of Kosova.

Rrëfimi i Herticëve për shtëpitë-shkolla

Kulla e Herticëve sot nuk është as shtëpi banimi e as shkollë. Është muze, është kujtim, është simbol.

TAULANT **QENAJ**

The Hertica Family Story

The Hertica family's house was neither just a home nor a typical school. Now, it is a museum, a memory, a symbol.

Për gati një dekadë, shtëpia e tyre që është ndërtuar rishtas, nuk do të ishte vetëm e tyre. Ishte edhe e nxënësve, për të cilët dhomat e reja e të pabanuara më parë u bënë klasë mësimi. Ishte edhe e arsimtarëve, për të cilët u la oda.
E njohur si Kulla e Herticëve, objekti trekatësh që ndodhet në Kodrën e Trimave në Prishtinë, ishte shtëpia dhe shkolla e shumë nxënësve gjatë viteve `90.

“

For over a decade, their freshly built home was not only theirs. It also belonged to the students, for whom the new rooms, which had never been lived in, were transformed into classrooms. The house was also for the teachers, to whom the main room was dedicated. Known as Kulla e Herticëve (The House of Hertica family), the three-story building, situated in the Kodra e Trimave neighborhood of Prishtina, operated both as a home and a school for numerous students during the1990s.

"Mësimi që zhvillohej në shtëpinë-shkollë fillonte në orën 7:30 e mbahej deri në orën 17:00, ndërsa në mbrëmje ne si familje e shfrytëzonim odën (që gjatë ditës shfrytëzohej si sallë e arsimtarëve) dhe dhomat e tjera i shfrytëzonim si dhoma gjumi, të cilat pastaj në orën 6:30, në baza ditore, i rregullonim që të fillonte prapë mësimi në to prej orës 7:30", fillon rrëfimin Fadil Aliu, babai i të cilit, Mehmet Aliu, dhe familjarë të tjerë, i kishin lëshuar shtëpitë e tyre për mbajtjen e mësimt, pra të shërbenin si shkolla.

"Me solemnitet donim të zhvendoseshim në shtëpinë e re"

Dëftesat e lëshuara në këtë shtëpi, më tepër sesa rezultatin e nxënësve, mbajnë vulën e pasigurisë, por edhe dinjitetin e një populli që përballë dhunës dhe poshtërimit zgjodhi të lexojë Faik Konicën dhe Gabriel García Márquez-in në dhomën e gjumit. Sot, kjo shtëpi nuk është më shkollë. Është një kujtim. Është simbol.

Në vitin 1992, para se shtëpia e tyre e re të mbushej me nxënës, Fadil Aliu ishte nxënës i vitit të dytë të shkollës së mesme ekonomike "Hoxhë Kadri Prishtina".

"Në janar të vitit 1992, babai më pyeti se çfarë është duke ndodhur, a ka ndonjë plan për shkolla, si do të bëhet për të filluar mësimi, sepse koha po ecën, dhe është rrezik të humbet komplet viti shkollor", thotë Fadil Aliu, duke shtuar se i ati i kishte kërkuar të pyeste kujdestarin dhe drejtorin e shkollës se cilat ishin planet për mbajtjen e mësimit.

Ato ditë po mbaheshin edhe protesta me kërkesën për rihapjen e shkollave të mbyllura nga regjimi i Millosheviçit. Arsimtarët dhe personeli i shkollës nuk kishin hapësirë për mbajtjen e mbledhjeve.

Mehmeti i kishte të thënë të birit gjimnazist që stafi i shkollës mund të shkonte të mbante mbledhje në shtëpinë e tyre të re, e cila ende nuk ishte shfrytëzuar as nga familjarët.

"Ne si familje jetonim së bashku me familjen e axhës, dhe në total ishim 17 anëtarë, pra të gjithë jetonim në një shtëpi katërdhomëshe. Mirëpo ndër vite kishim investuar shumë në ndërtimin e shtëpisë sonë të re 15-dhomëshe, e cila ishte përfunduar, gjithçka ishte gati, komplet interieri i shtëpisë ishte i disenjuar me dru, dhe ishte çështje ditësh kur me solemnitet donim të zhvendoseshim në shtëpinë e re", tregon Fadil Aliu.

Gjatë vizitës në shtëpinë e re, arsimtarët i propozuan familjes Aliu që kjo shtëpi të shndërrohej në shkollë. Pas një diskutimi me familjarët e tjerë,

"Lessons in our home-school began at 7:30 in the morning and continued until 5:00 in the afternoon. During the night, my family used the main room, the oda, which during the day was used by the teachers, and we slept in the other rooms. We would wake up early every morning at 6:30 to rearrange everything so that teaching could begin at 7:30", begins Fadil Aliu, whose father, Mehmet Aliu, along with his family, offered the house to be used as a school.

"We Were Eager to Move Into Our New Home"

The diplomas issued in that house, more than reflecting the students' academic achievements, carry the weight of insecurity. Nevertheless, they also reveal the dignity of a people who, in the face of violence and humiliation, chose instead to read Faik Konica and Gabriel García Márquez. Today, this house is no longer a school. Still, it remains both a memory and a symbol.

In 1992, before his newly built house began to be filled with students, Fadil Aliu was a second-grade student at the "Hoxhë Kadri Prishtina" Economics High School.

"In January1992, my father asked me what was happening, whether my school had any plans to start teaching, since time was passing and we were about to lose an entire academic year," recalls Fadil. He adds that his father told him to ask his teacher and the school director about the teaching plans.

At that time, protests were demanding the reopening of schools closed by Milošević's regime. The academic staff had nowhere to meet.

Mehmet told his son that the school staff could hold their meetings in their newly built house, which was still unused by the family.

"Our family lived together with my uncle's family, 17 members in total, in a four-room house. However, during those years, we managed to build a new house with 15 rooms. Everything was

shtëpia iu dha shkollës dhe në të u vendosën nxënësit.

"Familjarët vendosën që të ofrojnë gjashtë shtëpi të familjeve tona për shkollë. Shtëpitë që u ofruan menjëherë për shkollë ishin dy shtëpi të Mehmet dhe Ahmet Aliut për gjimnazin 'Sami Frashëri', ndërsa një shtëpi e Haxhi Musa Aliut dhe tri shtëpi të Haxhi Hamdi Aliut u ofruan për "Shkollën e Mesme Ekonomike", vazhdon rrëfimin Fadil Aliu.

Me datën 25 janar 1992 filloi mësimi, ku mbi 3.200 nxënës kanë mbajtur mësimin deri më 30.3.1999 kur edhe është granatuar shtëpia-shkollë nga forcat serbe.

Përballja me regjimin

Ndër goditjet e para që regjimi i Sllobodan Millosheviçit i dha shqiptarëve të Kosovës në vitet '90 të shekullit të kaluar, ishte përpjekja për shkatërrimin dhe ndalimin e arsimimit në gjuhën shqipe, duke i dëbuar nga objektet e shkollave të mesme dhe nga hapësirat universitare.

Shtëpitë-shkolla u mbështetën në solidaritetin e sinqertë të mësimdhënësve, që për një kohë punuan pa pagesë, derisa nisën të merrnin një pagë nga Fondi i 3-përqindëshit. Rol kyç luajtën edhe prindërit, të cilët dhuronin dru për ngrohje dhe ndërtonin karrige e banka. Derisa nxënësit pastronin klasat e tyre e të shtunave pastronin edhe dritaret e shtëpive.

Mbështetja më e rëndësishme ishte nga njerëzit që

↑

Shumë familje në Kosovë, ndërmorën në atë kohë një akt të guximshëm, duke shndërruar shtëpitë në dispozicion për shkollat e të cilat më pas u bënë dhe objekt i sulmeve serbe.

Many families at that time undertook a bold act, transforming their houses into schools, which soon became targets of assaults by Serbian forces.

"Lessons in our home-school began at 7:30 in the morning and continued until 5:00 in the afternoon. During the night, my family used the main room, the oda, which during the day was used by the teachers, and we slept in the other rooms. We would wake up early every morning at 6:30 to rearrange everything so that teaching could begin at 7:30", begins Fadil Aliu, whose father, Mehmet Aliu, along with his family, offered the house to be used as a school.

"We Were Eager to Move Into Our New Home"

The diplomas issued in that house, more than reflecting the students' academic achievements, carry the weight of insecurity. Nevertheless, they also reveal the dignity of a people who, in the face of violence and humiliation, chose instead to read Faik Konica and Gabriel García Márquez. Today, this house is no longer a school. Still, it remains both a memory and a symbol.

In 1992, before his newly built house began to be filled with students, Fadil Aliu was a second-grade student at the "Hoxhë Kadri Prishtina" Economics High School.

"In January1992, my father asked me what was happening, whether my school had any plans to start teaching, since time was passing and

me zemërgjerësi, hapën dyert e shtëpive të tyre për gati një dekadë.

Familja Aliu ofroi pesë objekte banimi në shfrytëzim si shkolla ku u arsimuan nëntë gjenerata. Kanë qenë të shpeshta e të pandalshme presionet e vizitat e befasishme në familjen Aliu nga regjimi i atëhershëm.

"Babai im Mehmet Aliu – Hertica është arrestuar dhe torturuar pothuajse në baza javore e mujore nga policia serbe. Tri herë është torturuar aq shumë, saqë s'kemi besuar se do t'u mbijetojë plagëve të marra", tregon Fadil Aliu.

Po ashtu të rrezikuar në baza ditore kanë qenë edhe arsimtarët e nxënësit.

"Ne si familje gjithmonë i kemi dalë në mbrojtje shtëpisë-shkollë, dhe shpeshherë kanë tentuar që ta pengojnë dhe bllokojnë procesin mësimor, mirëpo fatbardhësisht kemi arritur që t'i tejkalojmë këto pengesa", tregon Aliu, teksa ndalet te një rast i veçantë.

"Në pranverën e vitit 1993, tre agjentë serbë të maskuar si punëtorë të KEK-ut, kishin ardhur në vizitë inspektuese në shtëpinë-shkollë, ku me pretekstin se po harxhoni rrymë shumë, ata e shkëputën rrymën elektrike e shtëpisë-shkollë", tregon ai, duke shtuar se anëtarë të familjes Aliu ishin përballur edhe fizikisht me serbët, të cilit ishin të armatosur.

Gjatë përleshjes, anëtarë të familjes Aliu kishin konfiskuar amët e serbëve që ishin futur dhunshëm në oborrin e tyre.

"Njëri prej këtyre agjentëve të Serbisë iku dhe i njëjti gjatë ikjes me vrap, e shkrepi revolen e vet disa herë në drejtim të anëtarëve të familjes Hertica. Para se të vinte policia serbe prapë në oborrin tonë, babai ua mori armët këtyre agjentëve dhe i përzuri nga shtëpia jonë, e po ashtu udhëzoi farefisin që për shkak të rrezikut të madh, në të cilin gjendeshim, të mos qëndronin sot burrat në shtëpitë e tyre", rrëfen Aliu.

Forcat serbe arritën në oborrin e shtëpisë dhe e gjetën të vetëm Mehmet Aliun. Ai i dorëzoi armët e konfiskuara dhe policia e mori në stacionin policor në Kodrën e Trimave. Falë intervenimit të KMDLNJ-së dhe OSBE-së, Mehmet Aliu u lirua atë natë, për të shkuar në spital për ta marrë trajtimin shëndetësor për torturat që i kishte përjetuar.

Gjatë viteve `90, që njihet edhe si periudhë e arsimit paralel, rreth 3200 shtëpi e lokale private u bënë vatra të arsimimit për mijëra nxënës në Kosovë.

we were about to lose an entire academic year," recalls Fadil. He adds that his father told him to ask his teacher and the school director about the teaching plans.

At that time, protests were demanding the reopening of schools closed by Milošević's regime. The academic staff had nowhere to meet.

Mehmet told his son that the school staff could hold their meetings in their newly built house, which was still unused by the family.

"Our family lived together with my uncle's family, 17 members in total, in a four-room house. However, during those years, we managed to build a new house with 15 rooms. Everything was completed; the interior was made of wood. It was a matter of days before we eagerly would move into the new house," says Fadil.

During a visit to their home, the teachers proposed to Aliu's family to let their house become a school. After discussing the matter with family members, the house was offered to the school, and students were placed there.

"Our family decided to offer six of our houses to be used as schools. Soon, two houses, those of Mehmet and Ahmet Aliu, were allocated to the "Sami Frashëri" gymnasium, while the house of Haxhi Musa Aliu and three houses of Haxhi Hamdi Aliu were assigned to the Economics High School," Fadil recounts.

On January 25,1992, the teaching process began, serving over 3,200 students until March 30, 1999, when the house-school was bombed by Serbian forces.

Confrontation with the Regime

One of the first blow delivered by Milošević's regime against Kosova's Albanians in the 1990's was the attempt to obliterate Albanian education, depriving them of middle schools and universities buildings. House-schools were sustained by the sincere solidarity of teachers, who worked for a time without wages until they were paid by the Three-Percent Fund. Parents played a pivotal role too, donating wood for heating and building benches and stools. Even the students took responsibility, cleaning their classrooms and windows on Saturdays.

Yet, the most important support came from those who generously opened their home's doors for over a decade.

The Aliu family offered five houses to be used as schools, from which nine generations graduated. There were continuous pressures and

Shtrirja e kulturës **me objektet e harruara**

GENT MEHMETI

Objekte të lëna pas dore e të harruara prej kohësh. Një shërbeu si bunker në kohën e Jugosllavisë dhe kur bota ishte në Luftën e Ftohtë. Atëherë kur nuk mund t'i besohej askujt. Dy objekte të tjera të vogla shërbyen si shtëpi kulture. Ama, koha e bëri të veten, i vjetërsoi e njeriu nuk u kujdes fare për to. Gati sa u zhdukën nga faqja e dheut.

Prishtina si pjesë e planit të modernitetit dhe shfrytëzimit të hapësirave i kishte në cak këto tri objekte që t'i restauronte dhe t'i kthente në funksion. Përveç shfrytëzimit, ato shërbejnë si kujtim i së kaluarës.

Shtëpia e kulturës në Llukar, bunkeri në lagjen Ulpiana dhe Shtëpia e Kulturës në Kodrën e Trimave po marrin jetë. Synimi është që të shfrytëzohen për organizime kulturore. Deri vonë nuk shfrytëzoheshin apo thënë më shkoqur - u ishte vënë dryni. E në rastin e bunkerit në Ulpianë madje ishte ngjallur edhe mister, se çfarë ka brenda. Tash të tria hapësirat do të shfrytëzohen për muzikë, teatër, kinema, sallë leximi dhe galeri ekspozitash.

"Stereospace" në periferi

Objekti i Shtëpisë së Kulturës në Llukar ka formën e shkronjës T. Pjesa qendrore e objektit është hapësirë teatri me karrige plastike të ruajtura që prej kohës së Jugosllavisë. Karriget kanë ngjyrë portokalli. Anësoret e T-së shfrytëzohen për bibliotekën e lagjes dhe si studio muzikore. Në pjesën e

Cultural Enrichment **Through Forgotten Spaces**

Forsaken objects that have long fallen into oblivion. Among them, a bunker from the Yugoslav era, build during the Cold War. A time when you couldn't trust anyone. Two other smaller objects served as cultural hubs. Nevertheless, time took its toll, aging them, while people's neglect brought them to the brink of extinction.

As part of its modernization plan and efforts to repurpose spaces, Prishtina has begun restoring and revitalizing these three objects. Beyond their functional reuse, they now stand as reminders of the past.

Now, the Culture House in Llukar, the bunker in 'Ulpiana' neighborhood, and the Culture House in Kodra e Trimave are undergoing revitalization. The goal is to repurpose them for cultural events. Until recently, they had been closed or abandoned. Moreover, the Ulpiana bunker drew a lot of mysteries and rumors about what might be concealed underneath. Now, these three spaces are being

djathtë të objektit, dera dhe dritaret janë me grila për shkak se është plaçkitur disa herë. Brenda janë të vendosura disa kitara dhe bateritë që shfrytëzohen nga anëtarët e bendit "Gillespie" të formuar në vitin 2005.

Guri Shkodra, kitarist i grupit dhe menaxher i "StereoSpace" në një të shtunë fundmaji kujton kohën kur kishin ardhur për herë të parë dhe përdornin hapësirën 16-metrakatrore për ushtrime të grupit.

"Kur kemi ardhur, kjo dhoma këtu krejt bërllok, dritaret kanë qenë të thyera. Nuk ka pasur as tualet", thotë Shkodra që është pjesë e grupit të rock n'rollit në Prishtinë.

Për shkak të zhurmës gjatë ushtrimeve, grupi ka preferuar hapësira më në periferi e larg shtëpive. Objekti i lënë pas dore ishte i përkryer për ta.

"Bënim ushtrime edhe në Prishtinë, por kishte zhurmë dhe u pengonte të tjerëve nëpër banesa. Këtu është periferi, larg shtëpive. Vijnë bende të ndryshme dhe bëjnë ushtrime. Nuk jemi vetëm ne. Krejt pajisjet këtu mund të shfrytëzohen nga kushdo që dëshiron të bëjë muzikë. Ua ofrojmë pa pagesë", thotë Guri Shkodra teksa prezanton edhe një hapësirë pak më të ngushtë bri dhomës kryesore në të cilën ka një kompjuter dhe sistem zërimi.

"Këtu mund të incizohen edhe këngët për të gjithë ata që dinë si ta bëjnë", sqaron ai. Shkodra thotë se gjithçka nisi si iniciativë e një grupi muzikantësh dhe aktivistësh nga Prishtina me qëllim që të rigjallërohet jeta kulturore në zonat rurale dhe krijimit të një hapësire ku artistë dhe komuniteti lokal bëhen bashkë dhe zhvillojnë aktivitetet krijuese.

"Shtëpia e Kulturës në fshatin Llukar ka filluar së funksionuari diku në vitet `60, dhe ajo ishte qendër shumë e rëndësishme për komunitetin në fshat. Aty janë mbledhur dhe kanë organizuar aktivitete të shumta kulturore. Atë kohë prepared to host music, theater, film screenings, reading rooms, and exhibitions.

"StereoSpace" on the Periphery

The Culture House in Llukar is shaped like a 'P'. At its center, there is a theater with plastic chairs, orange in color, preserved from the Yugoslav period. The side wings once housed a local library and music studios as well. On the right side, both windows and doors are shuttered, as the building has often been targeted by burglars. There are guitars and drums once used by members of the band 'Gillespie', founded in 2005.

Guri Shkodra, guitarist of the group and manager of 'StereoSpace', reminds the time when they first began using a 16-square-meter space for rehearsals.

> **"When we first came, the place was full of garbage, the windows were broken. There wasn't even a toilet," says Shkodra, who is part of a rock 'n' roll band in Prishtina.**

Because of the noise from rehearsals, the band looked for spaces in more remote areas, far from residential neighborhoods. The abandoned object seemed to be a perfect spot.

"We rehearsed in Prishtina, but people complained about the noise. Here, we are on the outskirts, far

away from apartments. Many other groups came to rehearse here, we were not the only ones. Anyone who is willing to make music can use the equipment. We don't ask for any payments," Shkodra explains, showcasing a narrower space in front of the main room where a computer and sound system are set up.

"This is where you can record songs", he adds.

Shkodra explains that it all began as an initiative by a group of musicians and activists aiming to revive cultural life in the countryside and create a space where artists and the local community could gather and engage in creative activities.

"The Cultural House in Llukar began operating in the 1960s. Back then, it was a fairly important venue for the local community. It was a place where they gathered and hosted a wide array of cultural activities. At the time, there were artistic groups, movie screenings, and many other activities. For a

në fshat kanë funksionuar edhe grupe artistike, kishte shfaqje filmash dhe shumë aktivitete të tjera. Për një kohë të gjatë, dhe sidomos në vitet '90, ajo u shfrytëzuar për organizimin e aktiviteteve të rezistencës, për t'u braktisur menjëherë pas luftës", tregon Shkodra.

"Duke qenë vetë artistë në nevojë për hapësira inkubimi, ne kemi identifikuar këtë hapësirë të lënë anash si dhe të dëmtuar, si dhe kemi bërë rinovimet fillestare dhe kemi filluar shfrytëzimin në pajtim me komunitetin si dhe Komunën e Prishtinës. Pas rritjes së interesimit të komunitetit për shfrytëzimin e hapësirës, Komuna e Prishtinës ka vendosur të bëjë rinovimin e tërësishëm të objektit", shton ai.

Në "StereoSpace" deri më tani janë organizuar koncerte, incizime profesionale të grupeve muzikore nga Kosova dhe nga jashtë vendit, ekspozita, punëtori arti, rezidenca, debate, diskutime publike dhe shfaqje filmash.

"Para rinovimit, vetëm gjatë dy muajve të shfaqjes së filmave të animuar me organizatën Anibar, ky program i kuruar i filmave arriti të sjellë mbi 1,000 vizitorë, dhe kjo tregon se komuniteti afër ka filluar të përfshihet më shumë në ngjarje kulturore dhe sociale", thotë Shkodra. Sipas tij, ka gjithnjë e më shumë përpjekje që jeta kulturore të ngritet dhe të zgjerohet në komunitetet rurale. Vlerëson se duhet më shumë angazhim, sepse ka objekte të tjera të lëna në harresë.

"Vetëm pak kilometra pas Shtëpisë së Kulturës në Llukar, në fshatin Prapashticë është edhe një shtëpi tjetër kulturore, dhe shumë sosh në zona rurale që nuk përdoren, apo në rastin më të mirë përdoren fare pak për qëllime kulturore, ndërsa në anën tjetër është një numër i madh artistësh që shpërfaqin shqetësimet për mungesë hapësirash", shprehet i bindur Shkodra

UNDP KOSOVO

very long time, especially during the 1990s, the space was used to host resistance activities, while after the war it fell into disuse," Shkodra recalls.

"As artists in need of space, we spotted this neglected, worn-out space. We made some repairs and started using it, in agreement with the local community and the Municipality of Prishtina. As local interest grew, the municipality decided to fully restore the object," he says.

At 'StereoSpace', they have hosted concerts, professional music recordings from local and international bands, exhibitions, artistic workshops, residencies, discussions, and film screenings.

"Before the restoration begun, we ran a two-month animated film screening program in collaboration with Anibar. This curated program managed to bring over 1,000 visitors and this proof that the local community is increasingly engaging with cultural and social life," says Shkodra.

According to him, efforts to boost cultural life in rural areas are growing. He considers that more efforts are required as many other objects are abandoned.

"Just a few kilometers from Llukar's Culture House, there's another one in Prapashtica, and many more that have fallen into disuse, or rarely serve for any cultural purpose. This happens while there is a growing number of artists that are worried about the lack of proper spaces", he says, while sitting in the musical studio beside the drums.

Still, Shkodra laments that the Culture House can't be used during the winter. The main hall has only two air conditioners and no heaters.

"In winter, we face more difficulties as the object needs six conditioners, but we only have two. Sometimes we need to turn them two days in advance just to warm up the hall," he says, explaining the problems they face.

The Art's Bunker

Because of the Cold War, Josip Broz Tito, then president of Yugoslavia, ordered the construction of 26 bunkers. Seven of them were built in Serbia, six in Bosnia and Hercegovina, five in Croatia, three in Slovenia and Montenegro, two in North Macedonia, and just one in Kosova.

The Ulpiana shelter covers 632 square meters, with two main entrances and two side exits. It contains six rooms totaling 184 square meters. It has four toilets, an emergency room, and a generator space.

tek qëndronte në studion muzikore pranë baterive.

Mirëpo Shkodrës e ka mbetur merak që Shtëpia e Kulturës nuk mund të shfrytëzohet gjatë dimrit aq sa stinëve të ngrohta. Salla e madhe ka vetëm dy kondicionerë dhe nuk ka ngrohëse. "Dimrit e kemi më vështirë, sepse në objekt janë paraparë gjashtë kondicionerë, ndërkaq i kemi vetëm dy. Shpesh na duhet që dy ose tri ditë më herët t'i lëshojmë që të ngrohet salla sadopak", tregon ai për vështirësitë.

Bunkeri i artit

Për shkak të Luftës së Ftohtë mes viteve 1949-1980, presidenti i Jugosllavisë, Josip Broz Tito kishte urdhëruar ndërtimin e 26 bunkerëve. Shtatë ishin në Serbi, gjashtë në Bosnjë e Hercegovinë, Kroacia kishte pesë, Sllovenia dhe Mali i Zi nga tre, Maqedonia e Veriut dy dhe Kosova një në lagjen e Ulpianës. Strehimorja në këtë lagje ka 632 metra katrorë me dy hyrje kryesore dhe dy dalje anësore. Janë gjashtë dhoma me 184 metra katrorë. Bunkeri ka katër tualete, dhomën e ndihmës së parë dhe atë të gjeneratorit.

Me përkrahje nga UNDP-ja dhe Ambasada e Dukatës së Madhe të Luksemburgut në Prishtinë, ka nisur projekti për Qendrën e Artit Ulpiana. Pjesë e projektit është edhe rivitalizimi i hapësirës së papërdorur të bunkerit në Ulpianë. Synimi është që ai të transformohet në hapësirë kreative ku rëndësia historike takohet me shprehjen moderne artistike. Bunkeri pritet të shfrytëzohet për ekspozita të ndryshme dhe workshop-e. Në faqen zyrtare në rrjetin social Facebook të UNDP-së në Kosovë, është shkruar se Bunkeri i Ulpianës në Prishtinë po shndërrohet në një Qendër dinamike të Artit dhe Kulturës. I planifikuar të hapet këtë shtator, bunkeri i dikurshëm do të ofrojë mundësi të reja për inovacion artistik dhe angazhim komunitar. Kjo nismë është pjesë e projektit për Industrinë Kreative, i mbështetur nga Ambasada e Dukatës së Madhe të Luksemburgut në Prishtinë, me synim përshpejtimin e zhvillimit komunal përmes planifikimit strategjik dhe një oferte më të fuqishme kreative lokale.

Një prej projekteve të rëndësishme për komunitetin e lagjes nga Komuna e Prishtinës është edhe Qendra e Kulturës dhe Biblioteka në Kodrën e Trimave. Drejtoresha për Kulturë në Komunën e Prishtinës, Sibel Halimi thotë se qendra do të ketë infrastrukturë moderne.

"Kemi rifilluar punimet për ndërtimin e objektit shumë të rëndësishëm. Qendra e re synon të ofrojë hapësirë dhe infrastrukturë moderne për aktivitetet arsimore, kulturore dhe shoqërore, duke krijuar mundësi të shumta për zhvillimin e komunitetit", thotë Halimi.

Një nga synimet kryesore të këtij projekti është zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe fuqizimi i komunitetit.

With the support of UNDP and the Embassy of the Grand Duchy of Luxembourg in Pristina, the project for the Ulpiana Art Center has been launched. It includes repurposing this unused bunker. The goal is to transform into a creative venue where historical importance meets contemporary artistic expression. The bunker is set to host various exhibitions and workshops. According to a post on the official Facebook page of UNDP in Kosovo, the Ulpiana Bunker in Prishtina is being repurposed as a dynamic Art and Cultural Center. Set to open this September, the former bunker will offer new opportunities for artistic innovation and community engagement. This initiative is part of the Creative Industries project, supported by the Embassy of the Grand-Duchy of Luxembourg in Pristina, aiming to accelerate municipal development through strategic planning and a stronger local creative offer.

Cultural House in Kodra e Trimave

One of the most significant community projects is the Cultural Center and Library in the Kodra e Trimave Neighborhood. According to Sibel Halimi, Director of Culture at the Municipality of Prishtina, the center will be equipped with modern infrastructure.

"We have launched construction on this important object. The new center aims to provide a space and infrastructure for educational, cultural, and social activities, offering real opportunities for community development," says Halimi.

One of the main goals of the initiative is to promote reading, support cultural activities, and strengthen community.

Kurrizi i dy kohëve

The Spine of Two Eras

"Kurrizi" është simbol i kryeqytetit. Lakorja e njohur për hapësira e kalimtarëve, lokalet e shumta përgjatë tunelit, shërbejnë si kujtesë kolektive për Prishtinën e dikurshme, jetën urbane dhe për rezistencën ndaj shtypjes. Hapësira prej betoni nga e shkuara jep mesazh për të ardhmen se si duhet të shmanget kaosi e të ruhet liria e qytetarit.

"Kurrizi" (translated as "The Spine") is a symbol of the city. This curving walkway, where pedestrians pass, filled with numerous locals throughout the tunnel, constitutes a collective memory for erstwhile Prishtina, urban life, and resistance against repression. The concrete space, as a reminiscence of the past, yields a message to the future – how to eschew chaos and retain the freedom of citizens.

GENT **MEHMETI**

Pikëtakim i shumë gjeneratave. Vend që gumëzhinte nga të rinjtë e Prishtinës që çdo natë i gjeje aty. Edhe po të shkonin të vetëm, dikë të njohur do e gjenin aty. Koha aty nuk ndalonte, derisa çdo sekondë e saj matej nga ora e madhe që ndodhej në ballë të hyrjes së madhe, që ka formë gjysmë-harkore. Lart e poshtë lokale nga më të ndryshmet, sipër platforma e përbërë nga betoni dhe xhami lidh lagjen "Dardania" si në formë lakoreje.

"Kurrizi" ishte një prej projekteve revolucionare të Prishtinës, i ndërtuar në vitin 1986. Platoja, diçka e padëgjuar më parë në kryeqytetin e atëhershëm, do të shndërrohej në atrak-

Fotografi e dërguar nga Bajram Bylykbashi - BB Poqi

It is a meeting point of numerous generations. A place humming with young people who were there every night. Even when one went alone, some acquaintance would appear for sure.

Time felt as if it stopped, as every second was measured by the big o'clock located at the very entrance, with its half-bent shape.

On both sides, there were plenty of locals, while above, a concrete and glass platform serves as a linking point for the 'Dardania' neighborhood.

'Kurrizi' was one of the most revolutionary projects of Prishtina, built in 1986.

Its plateau, something unheard of at the time, became an attraction as a modern idea. It rendered the 'Dardania' neighborhood one of the most planned across the city. It, thus, became an image of the Prishtina for which all yearned: a metropolitan Prishtina.

'Kurrizi' was part of a concept of a "raised urban platform." This modern idea purported to delineate functions: pedestrians walking above, and traffic flowing underneath. It was a concept inspired by the architectural models of the time.

A Place of Gathering

The project's name was not originally 'Kurriz.' It naturally acquired that name from the local residents. The plateau separated buildings in a vertebra-like form. So, when people greeted one another or made plans for the next day, they

sion. Qe ide moderne për kohën. E bëri lagjen "Dardania" një prej më të planifikuarave në Prishtinë. Kështu, "Kurrizi" u shndërrua në imazh për Prishtinën që e ëndërronin të gjithë: Prishtinën metropolitane.

"Kurrizi" ishte pjesë e konceptit të "platformës urbane të ngritur". Kjo ide moderniste synonte ndarjen e funksioneve: këmbësorët në sipërfaqe dhe komunikacioni nën të. Ishte koncept i frymëzuar nga modelet arkitektonike të kohës.

Vend i përbashkimit

"Kurrizi" nuk ishte emri i projektit. I mbeti nga prishtinasit dhe ishte emër i natyrshëm për të. Platoja ndan ndërtesat bash si një shtyllë kurrizore. Kështu, prishtinasit kur përshëndeteshin apo linin takim për të nesërmen, do të dëgjoheshin: "Shihemi te Kurrizi", "A takohemi te Kurrizi".

Kur Kosovës nisi t'i zihej fryma nga regjimi shtetëror serb dhe në vitin 1989 iu hoq edhe autonomia, shqiptarët më nuk kishin vend në institucione publike, sepse ato u uzurpuan nga serbët. Njerëz të zakonshëm, artistë, shkrimtarë, politikanë e të profesioneve tjera, do t'i gjeje në lokalet e "Kurrizit". "Hani i Dy Robertëve", "Papilloni" dhe "BB" ishin vetëm disa prej lokaleve më të frekuentuara në këtë kohë.

Albert Abrashi, që ka qenë myshteri i rregullt i "BB" dhe "Papillonit" në Kurriz ndan kujtime të veçanta nga ajo kohë.

"Grandin [hotelin], dua të them

Fotografi e dërguar nga Enes Berveniku

Fotografi e dërguar nga Arben Sylejmani

would say: "See you at Kurrizi" or "Shall we meet at Kurrizi?"

When the Serbian regime suppressed Kosova and revoked its autonomy, Albanians no longer had a place into public institutions as they were seized by Serbs.

In the bars along 'Kurrizi', one could encounter ordinary people, artists, writers, politicians, and people of various occupations.

'Hani i Dy Robertëve', 'Papillon', and 'BB' were some of the most frequented spots at the time.

Albert Abrashi, a regular visitor at both 'BB' and 'Papillon', shares his memories of that time.

"They (Serbs) took over the Grand Hotel, the promenade, the downtown area, so only 'Kurrizi' was left to us. For ten years, it was the main meeting place for most young people in Prishtina", says Abrashi.

He recounts that one of the first local places was the pizzeria 'Beni', followed by 'Papillon.'

"The pizzeria owner was from Gostivar, then 'Papillon' opened. But things got worse when our autonomy was revoked and the police hour came into force," Abrashi evokes.

> **"On a Wednesday in May, while he was drinking at 'Kafet e Rakisë', Pile, as many call Abrashi, recalls how the Serbian police would raid and strictly monitor the bars.**

"Almost every night, two policemen would show up and inspect the area. They accused us of using narcotics. The bars had two floors, and it often happened that they would take us upstairs to torture us. We hardly left with just a slap," he recalls.

Despite the repression, Albanians

edhe korzonë na e morën, qendrën na e morën, kështu 'Kurrizi' mbeti për ne. Për dhjetë vjet ka qenë vendi i pjesës më të madhe të rinisë shqiptare në Prishtinë", thotë Abrashi.

Ai thotë se një prej lokaleve të para ishte piceria "Beni" pastaj do të vazhdonte "Papilloni".

"Pronar i picerisë ka qenë një i Gostivarit, pastaj ishte Papilloni. Por gjërat u vështirësuan kur na u hoq autonomia dhe kur u vendos ora policore", kujton Abrashi.

> **Tek pinte një gotë te "Kafet e Rakisë", në një të mërkure të fundmajit, Pile siç e njohin të gjithë Abrashin, rrëfen se në lokalet e Kurrizit pas viteve '90 kishte kontrolle të rrepta të policisë serbe.**

"Pothuajse çdo natë vinin nga dy policë dhe na kontrollonin. Na akuzonin për përdorim droge. Lokalet ishin shumica me dy kate dhe shpesh na dërgonin lart dhe na keqtrajtonin. Nuk shpëtonim pa ndonjë shuplakë", kujton Abrashi.

Ky represion i bashkoi edhe më shumë shqiptarët që frekuentonin fort kafenetë e "Kurrizit".

"Njiheshim me njëri-tjetrin, shkoje edhe i vetëm në Kurriz, sepse e dije se do të ishte pamundshme të mos gjeje dikë të njohur aty", thotë Abrashi.

"Krejt lokalet ishin të organizuara. Punonin deri pasdite. I jemi përshtatur asaj kohe dhe para se të niste ora policore të gjithë iknin", thotë ai. "Edhe akullin për pije e sillnim prej shtëpisë", shton ai kur flet për vështirësitë pas dëbimit të shqiptarëve nga institucionet.

Investimi për rikthimin e namit

Kosova e pasluftës u përball me ndryshime të mëdha dhe të shpejta. "Kurrizi"

became even more unified, frequenting the bars of 'Kurrizi' even more regularly.

"We all knew each other. You could go to 'Kurrizi' alone and you would certainly meet someone you knew," Abrashi says.

"All the bars were organized. They worked until the afternoon. We adapted. Everyone would leave before the police hour started," he adds. "We even brought ice from home for our drinks", he says, recalling the difficulties Albanians faced when they were pushed out of public life.

Bringing Back the Reputation Through Investment

Postwar Kosova underwent rapid and dramatic changes. Even 'Kurrizi' could not withstand the wave of urban expansion that swept through Prishtina – it, too, fell into neglect.

Many shops and gathering spots were closed; others were converted into kebab shops or boutiques.

> **"These days, the place is barely frequented. There was a time you could hardly make your way through the crowds," says Abrashi, reflecting on 'Kurrizi' in the postwar years.**

He explains that the development of the downtown area had a widespread impact, including the opening of many new bars. "Today, young people tend to hang out in the newer bars. During summer, 'Kafet e Rakisë' is packed with people of all ages. Before that, places



nuk i rezistoi zgjerimit urban që po bëhej në kryeqytet dhe e la në hije edhe mungesa e mirëmbajtjes. Shumë dyqane e kafene u mbyllën. Të tjerat u shndërruan në qebaptore e butikë të ndryshëm.

> **"Tash nuk frekuentohet shumë, përpara nuk ke mundur të kalosh prej njerëzve", flet Abrashi për "Kurrizin" e pasluftës e deri në ditët e sotme.**

Ai thotë se të veten e ka bërë edhe zhvillimi i qendrës dhe hapja e shumë lokaleve të reja në Prishtinë.

"Tash të rinjtë frekuentojnë shumë lokale. Verës bllokohen 'Kafet e Rakisë', ka njerëz të moshave të ndryshme. Më herët kanë qenë Kafet e Vogla, 'Te qafa', tash qendra është më aktive. Pra, kemi zhvendosje", thotë Abrashi.

Tuneli ishte në funksion, por tek hyje aty me makinë kishe ndjenjën e ngufatjes dhe doje që të ikje sa më parë. Tash ai po merr pamje tjetër. Projekti i Komunës së Prishtinës do të rivitalizojë e funksionalizojë tërësisht këtë pjesë. Ka pasur shumë thirrje që "Kurrizi" të shndërrohet në hapësirë kulturore apo rekreative. Në vitin 2025 ka nisur edhe projekti për rinovimin e tunelit të Kurrizit dhe do t'i kushtojë Prishtinës 1.2 milionë euro. Shumë arkitektë dhe banorë të kësaj zone kanë bërë thirrje që "Kurrizi" të ruhet si pjesë e historisë dhe e rrëfimeve të një jete të shumë gjeneratave. Në pritje të krejt këtyre projekteve "Kurrizi" shërben si mesazh se dikur mendohej më shumë për qytetarin dhe i jepej më shumë liri jetës së tij.

like 'Kafet e Vogla' and 'Te Qafa' were more popular, but now, the downtown has become the city's main hub. There's been a noticeable shift," Abrashi adds.

> **The Tunnel was still in use back then, but driving through it gave you an overwhelming sense of being stuck – you would do everything you could to get out as quickly as possible.**
> **Now, this part of the city is undergoing a complete transformation. The Municipality of Prishtina has launched revitalization efforts to restore and repurpose the area. There have even been proposals to turn 'Kurrizi' into a cultural or recreational space. In 2025, a €1.2 million project was initiated to renovate the tunnel.**

Many architects and residents have called for this area to be preserved as a piece of the city's social history.

While awaiting the completion of these projects, 'Kurrizi' stands as a reminder of a time when urban planning centered on the lives of everyday people – and how to offer them more freedom in the city they called home.

Lagjja ku merr jetë arti

The Neighborhood Where Art Is Brought to Life

ALBERINA **HAXHIJAJ**

"Lagjja e artistëve" në Ulpianë është më shumë se lagje. Në këtë pjesë të qytetit muret janë të mbushura me murale e shumica e lokaleve janë, në fakt, studio të artistëve. Atmosfera e ngrohtë dhe miqësore të pushton që në hyrje.

The 'Artists' Neighborhood' in Ulpiana is more than just a neighborhood. In this part of the city, the walls are replete with murals, and most of the venues are, in fact, artists' studios.

Aty kalimtarët përshëndesin artistët që nëse nuk janë duke punuar jashtë para studiove të tyre, dyert i kanë me patjetër hapur gjatë gjithë kohës, e era e ngjyrave e pushton hapësirën. Me mbi 20 artistë aktivë, ajo po shndërrohet në një qendër të vogël arti në Prishtinë.

Studio pas studioje

Në një cep të kësaj lagjeje është edhe studio e Anton Krasniqit, i cili tregoi prirje për art që në moshë të re. Studimet për pikturë i ndoqi në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku edhe përfundoi studimet pasuniversitare (magjistraturën). Stili i tij artistik është i dallueshëm, i karakterizuar nga përdorimi i ngjyrave të forta, kompozime të pasura dhe figura shpeshherë simbolike. Veprat e tij përfshijnë elemente të traditës shqiptare, jetës rurale dhe reflektime mbi historinë

Passersby greet the artists who, if not working outside in front of their studios, always keep their doors open, while the scent of paint fills the air. With over 20 active artists, the neighborhood is gradually transforming into a small art center in Prishtina.

Studio After Studio

In a corner of this neighborhood lies the studio of Anton Krasniqi, who displayed a keen interest in art from an early age. He completed his painting studies at the Faculty of Arts in Prishtina, where he also earned his Master's degree. His artistic style is distinctive, featuring strong colors, rich compositions, and figures that are often symbolic. His artworks comprise elements of Albanian tradition, rural life, and reflections on history and national identity. During our visit to his studio, he was working on a painting that he seemed to have decided to steer in a different direction from what he originally conceived. He was conversing with Valbona Gashi, who had just taken a studio in the same neighborhood, only a few steps away from that of Krasniqi.

While sipping a glass of wine, they talked about art and oil paintings. Gashi liked the new direction Krasniqi had taken with his work.

"No matter how many years pass, oil colors preserve their shine," she said. She works with acrylic, and for her, the choice was simply a practical one.

"When I painted at home, the children were always around. Acrylic colors are easier to use in a home environment, they dry quickly and are much safer," she says. Now, in the new studio she has taken, currently being renovated and prepared for opening, she believes she will have the chance to return to oil paints. Krasniqi encourages her. "They have a special feel," he says, referring to oil paintings.

This moment captures precisely the spirit of the Artists' Neighborhood. Here, art is found not only on the walls or in the paintings that hang there, but also in the daily conversations, in the support artists offer one another, and in the ever-present desire to create, a desire that never fades.

Krasniqi has taken part in numerous exhibitions, both within Kosova and internationally, including in Germany,

FOTO: XHEVDET DERVODELI

dhe identitetin kombëtar. Gjatë vizitës në studion e tij, po punonte në një pikturë që siç duket ka vendosur që ta ndryshojë kahe nga ajo që kishte nisur. Po bisedonte bashkë me Valbona Gashin, e cila sapo ka marrë një studio në këtë lagje. Disa hapa më larg asaj të Krasniqit.

Teksa pinin nga një gotë verë bisedonin rreth artit dhe pikturave me vaj. Gashit, i pëlqente me shumë kahja e re që Krasniqi i kishte dhënë pikturës së tij. "Pavarësisht sa vjet kalojnë ngjyrat e vajit e ruajnë atë shkëlqimin e tyre", thotë ajo. Ajo punon me akrilik, dhe për të kjo zgjedhje ishte thjesht diçka praktike.

"Kur pikturoja në shtëpi, fëmijët ishin gjithmonë përreth. Ngjyrat akrilike janë më të lehta për t'u përdorur në ambient shtëpie, thahen shpejt, janë më të sigurta", thotë ajo. Tani në studion e re që ka marrë, e që është duke e rinovuar e duke e bërë gati për ta hapur, mendon se do ketë mundësi t'u kthehet ngjyrave me vaj. Krasniqi e inkurajon për diçka të tillë. "Kanë një ndjesi të veçantë", thotë ai duke iu referuar pikturave me ngjyra të vajit.

Ky moment përfaqëson pikërisht frymën e Lagjes së Artistëve. Këtu, artin nuk e gjen vetëm në mure, apo në pikturat e varura, por edhe në bashkëbisedimet e përditshme, në përkrahjen që artistët i japin njëri-tjetrit dhe në dëshirën për të krijuar, që nuk shuhet asnjëherë.

Krasniqi ka marrë pjesë në shumë ekspozita, si brenda Kosovës, ashtu edhe ndërkombëtarisht si në Gjermani, Francë, Austri e më gjerë. Puna e tij është vlerësuar për qasjen autentike dhe identitetin e fuqishëm që përçon. Përveç krijimtarisë së tij, ai ka kontribuar aktivisht edhe në fushën e arsimit dhe kulturës, duke organizuar koloni artistike dhe ekspozita kolektive. Këtë vazhdon ta bëjë edhe në lagje. Ka 11 vjet që studion aty.

"Shumë artistë marrin pjesë në ngjarje të përbashkëta që ndihmojnë në ndërtimin e komunitetit dhe ndarjen e krijimtarisë", thotë ai.

Ekspozita kolektive, ku marrin pjesë disa artistë që paraqesin punët e tyre në një hapësirë të përbashkët shpesh me një tematikë të caktuar ose të përbashkët; pastaj organizohen "Ditë studioje të hapura", ku artistët hapin studiot e tyre për publikun dhe kolegët, duke ndarë me publikun procesin krijues dhe duke ndërtuar ura bashkëpunimi dhe rezidenca artistike; programe ku disa artistë qëndrojnë dhe krijojnë së bashku për një periudhë kohe, shpesh duke përfunduar me një ekspozitë ose prezantim publik, janë veç disa prej tyre.

Në anën tjetër, Valbona Gashi, tregon se shumë shpejt është përshtatur me energjinë e lagjes. "Më tërhoqi që këtu ekziston një komunitet i gjallë, me shumë artistë që sjellin ide dhe projekte të reja, si dhe mundësia për bashkëpunime të frytshme për të promovuar trashëgiminë kulturore në

France, Austria, and beyond. His work has been praised for its authentic approach and the strong sense of identity it conveys. In addition to his artistic practice, he has actively contributed to the fields of education and culture by organizing artist residencies and group exhibitions. He continues this work in his own neighborhood, where he has been based for the past eleven years.

"Many artists take part in collaborative events that help build community and provide a platform for sharing creative expression," he says.

There are collective exhibitions, where several artists showcase their works in a shared space, often centered on a specific or common theme. Then there are Open Studio Days, during which artists open their studios to the public and fellow artists, sharing their creative processes and fostering collaboration. Artistic residencies are another format – programs where artists live and work together for a set period of time, often culminating in an exhibition or public presentation.

Meanwhile, Valbona Gashi shares how quickly she adapted to the neighborhood's vibrant energy. "I was drawn by the fact that there's a thriving community here, with so many artists bringing forth new ideas and projects, as well as opportunities for meaningful collaborations to promote cultural heritage in a contemporary context," she says. Gashi is a painter and accessory designer, devoted to preserving and reviving elements of cultural heritage through her art. She began her artistic

kontekst bashkëkohor", thotë ajo. Gashi është piktore dhe krijuese aksesorësh, e përkushtuar ndaj ruajtjes dhe rikthimit të elementeve të trashëgimisë kulturore përmes artit. Rrugëtimin e saj artistik e filloi me pikturë, duke pikturuar peizazhe dhe gradualisht vazhdoi me krijimin e aksesorëve që sjellin në pah motive tradicionale. Ajo del në atele posa përfundon punën, pasi ka 21 vjet që është profesoreshë e artit.

"Kjo lagje është një oazë e artit dhe kreativitetit, ku çdo cep frymëzon, nga muret e vjetra me murale deri tek ambientet moderne që mbulojnë hapësirën e studiove. Për një artiste që merret me trashëgimi kulturore, ky vend është një qendër e gjallë që ofron mundësi për shprehje dhe bashkëpunim, duke u ndier si një fushë loje mes së vjetrës dhe së resë", thotë ajo. Potencon se një prej sfidave më të mëdha është sigurimi i mbështetjes financiare dhe mbajtja e hapësirave të pavarura artistike, sidomos në një mjedis ku çmimet dhe kostot rriten vazhdimisht.

"Gjithashtu, shpesh është vështirë të gjesh kohë dhe burime për edukim dhe promovim të trashëgimisë kulturore, gjë që ndikon drejtpërdrejt në mundësitë për inovacion dhe përhapje të artit", thekson ajo. Ka dëshirë që lagjja të vazhdojë të rritet dhe të forcohet, pasi për të ky ambient ofron mundësi të rrallë për të mësuar, për të krijuar, por edhe për tu rritur artistikisht, dhe gjithë kjo falë komunitetit mbështetës.

Atelieja si hapësirë jete

Biseda u bë edhe më e ngrohtë kur na u bashkua edhe Saba Berisha-Ismajli, e cila solli me vete disa ushqime të përgatitura në shtëpi. Teksa të tre rrinin së bashku, ajo nuk e fshehu entuziazmin për pamjen e re që kishte marrë piktura më e fundit e Krasniqit.

"Ngjyrat janë edhe më të gjalla, ka një ndjesi tjetër tani", tha ajo, duke e vështruar me vëmendje veprën. Edhe Saba Berisha-Ismajli ndan dashurinë për ngjyrat me vaj, por me veprat e saj shkon përtej kanavacës.

"Kjo loja me skulptura po më pëlqen shumë, sepse vetëm pëlhura nuk po më mjafton", thotë ajo, duke potencuar kombinimin që bën në mes të pikturës dhe të skulpturave të hekurit. Ndryshe

journey with landscape painting and gradually expanded into designing accessories that feature traditional motifs. After finishing her workday – she has been an art professor for 21 years – Gashi heads straight to her studio.

"This neighborhood is an oasis of art and creativity, where inspiration lurks in every corner – from old walls adorned with murals to sleek, modern spaces that host studios," she says. "For an artist working with cultural heritage, it feels like a living hub – a place that offers room for expression and collaboration, like a playground where the past and present intersect."

Gashi notes that one of the biggest challenges is securing financial support and sustaining independent art spaces, particularly in an environment where prices and costs are steadily on the rise.

"Moreover, it's often challenging to find both the time and resources needed to promote and educate others about cultural heritage – something that directly impacts innovation and the broader spread of art," she emphasizes. Gashi hopes the neighborhood will continue to grow and thrive, as she sees it as a rare environment – one that nurtures learning, creativity, and artistic growth, made possible by a supportive and engaged community.

The Studio as a Living Space

The conversation grew even warmer when Saba Berisha-Ismajli joined them, bringing along some homemade food. As the three sat together, she couldn't hide her enthusiasm for the new form that Krasniqi's latest painting had taken.

"The colors are even more vibrant; it gives off a different feeling now," she said, attentively observing the artwork. Saba Berisha-Ismajli also reveals her love for oil colors, though her work goes beyond the canvas.

"I really like this play with sculptures because canvas alone is no longer enough for me," she says, emphasizing the combination she creates between painting and iron sculptures. Unlike Krasniqi's studio – which retains the classic features of an artist's atelier and is located between Gashi's and Berisha-Ismajli's studios – hers contains more personal details. It is a blend of home comfort and a quiet place to work, where creativity flows naturally and every corner is filled with works from different periods of the artist's life, ranging from those made during her studies to her most recent pieces.

It is in this very studio that Saba Berisha-Ismajli begins her day, with a cup of coffee, music, and a moment of calm among the materials around her. "I love connecting with the space through the touch of wood, stone, glass, or metal. The creative process is flexible, sometimes it starts with an idea, sometimes with a sketch, or even from the material itself," she explains.

She grew up surrounded by art in her father's studio, the well-known artist Budim Berisha, where from a very young age she experimented with different structures and materials. After completing her studies at the Faculty of Arts, she partook in both solo and group exhibitions and opened her first studio in Prishtina, specializing in handcrafted jewelry made from copper, ceramics, and glass. Her other artworks are also characterized by the use of diverse materials such as wood, glass, stone, and metal – each carrying its own life and history.

Through them, I create forms that

nga studioja e Krasniqit - e cila ruan tiparet klasike të një atelieje artistike, e që është në mes të studios së Gashit e asaj të Berisha-Ismajlit - kjo ka futur më tepër detaje personale në të. Është një kombinim mes rehatisë së shtëpisë dhe një vendi të qetë për punë, ku krijimtaria rrjedh natyrshëm dhe ku çdo cep i saj është i mbuluar me vepra nga periudha të ndryshme të artistes, prej atyre të punuar gjatë studimeve e deri tek ato më të fundit.

Pikërisht në këtë studio Saba Berisha-Ismajli e nis ditën, me kafe, muzikë dhe një moment qetësie mes materialeve përreth.

"Më pëlqen të lidhem me hapësirën përmes prekjes së drurit, gurit, xhamit apo metalit. Procesi krijues është i ndryshueshëm — ndonjëherë nis me një ide, ndonjëherë me një skicë apo me vetë materialin", siç tregon ajo.

Ajo është rritur mes artit, në studion e të atit, artistit të njohur Budim Berishës, ku që e vogël ka eksperimentuar me struktura dhe materiale të ndryshme. Pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Arteve, ka marrë pjesë në ekspozita personale dhe kolektive dhe ka hapur studion e saj të parë në Prishtinë me stoli punëdore artizanale, të punuara nga bakri, qeramika dhe xhami. Edhe veprat e tjera artistike karakterizohen nga përdorimi i strukturave të ndryshme si druri, xhami, guri dhe metali, materiale që mbartin jetë dhe histori në vetvete.

"Nëpërmjet tyre, krijoj forma që ndërthurin të përditshmen me simbolikën tradicionale shqiptare. Një vend të veçantë në punët e mia zë figura njerëzore si gruaja, burri, fëmija, si një përfaqësim i shpirtit të shoqërisë dhe i rrënjëve tona kulturore. Punimet janë shpesh të frymëzuara nga motivet dhe traditat popullore, por i qasem me një ndjeshmëri bashkëkohore që synon të krijojë një urë mes së kaluarës dhe së tashmes", thotë ajo. Inspirimin e gjen në detajet që shpesh kalojnë pa u vënë re, gjeste, simbole, objekte të zakonshme që mbartin histori dhe ndjenja.

"Tradita jonë është një burim i vazhdueshëm frymëzimi për mua, jo vetëm në formën e saj të jashtme, por edhe në thellësinë shpirtërore dhe simbolike që ajo përçon. Veshjet,

ornamentet, zakonet, ritualet, të gjitha këto më ndihmojnë të krijoj vepra që ruajnë kujtesën kolektive dhe ndërtojnë ura mes brezave", thotë Saba Berisha-Ismajli që ka tre vjet në këtë lagje. E kishte tërhequr atmosfera krijuese që e karakterizon.

"Kjo është një hapësirë që jo vetëm më motivon si artiste, por edhe krijon mundësi për bashkëpunim, shkëmbim idesh dhe komunikim të drejtpërdrejtë me artistë të tjerë, me publikun dhe ndonjë herë edhe me kalimtarë të rastit", thekson ajo. Për të kjo lagje është ndryshe nga çdo pjesë tjetër e qytetit. Po ashtu, edhe Gashi e Krasniqi pajtohen me të. Theksojnë se kjo lagje është një hapësirë ku arti nuk është vetëm brenda mureve të një studioje, por ndihet edhe në rrugë, në murale, në ndërveprimin mes njerëzve.

"Për dikë që nuk ka qenë kurrë këtu, do ta përshkruaja si një lagje të gjallë, ku ndihesh i mirëpritur sapo hyn. Nuk është thjesht një vend ku punohet, por një vend ku jetohet arti çdo ditë", pajtohen njëzëri ata duke shpresuar dëshirën që lagjja të vazhdojë të rritet si një qendër kulturore ku arti ndahet lirshëm me komunitetin. Madje e inkurajojnë çdo artist që mendon ta hapë studion këtu, pasi, siç thonë ata, kjo lagje të mbështet, të frymëzon dhe të lidh me diçka më të madhe - me një komunitet artdashës. Dhe çdo herë, mirëpret jo vetëm artistë, por edhe edhe të gjithë ata që kanë ndjeshmëri ndaj artit.

intertwine everyday life with traditional Albanian symbolism. A special place in my work is reserved for human figures such as woman, man, and child, as representations of the soul of society and our cultural roots. My pieces are often inspired by folk motifs and traditions, but I approach them with a contemporary sensitivity aimed at building a bridge between the past and the present," she says. She finds inspiration in details that often go unnoticed, gestures, symbols, and ordinary objects that carry history and emotion.

"Our tradition is a constant source of inspiration for me, not only in its outward form but also in the spiritual and symbolic depth it conveys. Costumes, ornaments, customs and rituals all help me create artworks that preserve collective memory and build bridges between generations," says Saba Berisha-Ismajli, who has resided in this neighborhood for the past three years. She was drawn by the creative atmosphere that pervades the area.

"It is a space that not only motivates me as an artist, but also creates opportunities for collaboration, idea exchange, and direct communication with other artists, the public, and sometimes with passersby," she notes. To her, this neighborhood feels different from any other part of the city. Gashi and Krasniqi agree with her. They emphasize that this neighborhood is a place where art is not confined within the walls of a studio but it permeates throughout the streets, in murals, and in the interactions between people.

"For someone who has never been here, I would describe it as a lively neighborhood where you feel welcomed as soon as you step in. It is not just a place to work, but a place where art is lived every day," they all agree unanimously, hoping that this neighborhood will continue to grow as a cultural center where art is freely shared with the community. They encourage any artist to open a studio here, because they believe this neighborhood supports, inspires, and connects them to something bigger – that is an art-loving community. And it always welcomes those who are not artists by profession but who love art.

Prishtina – qytet që frymon përmes artit

Prishtina – A City That Breathes Through Art

PËRPARIM RAMA
KRYETAR I PRISHTINËS

MAYOR OF PRISHTINA

Në Prishtinë, transformimin nuk e masim vetëm me ndërtimet e reja ose me projektet infrastrukturore. E masim me mënyrën se si qyteti ynë krijon hapësira për shprehje, kujtesë dhe bashkëjetesë kulturore. Që nga viti 2021, kryeqyteti e ka nisur një rishpikje serioze të rolit që arti dhe kultura luajnë në jetën tonë, me politika konkrete që mbështesin skenën artistike e kulturore. Strategjia jonë për artin dhe kulturën 2026–2031, e hartuar me pjesëmarrje të gjerë hisedarësh prej komunitetit artistik, është plani më ambicioz që kemi krijuar ndonjëherë – jo vetëm për të ruajtur trashëgiminë tonë, por edhe për të nxitur inovacion, kreativitet dhe ndërlidhje ndërkombëtare, që kulturën tonë ta paraqesim jashtë kufijve të Kosovës. Prishtina po shndërrohet në destinacion kulturor, një model që i gjithë rajoni ta lakmojë.

Përkrahja jonë reale për kulturën matet edhe me festivalet që spikasin në arenën botërore. **Sunny Hill** Festival, (që sivjet mbahet më 1–3 gusht), si dhe Festivali Ndërkombëtar i Operës "Rame Lahaj" (27 korrik – 2 gusht) janë dëshmi të fuqishme që programi muzikor i Kosovës është në nivelin më të lartë global. Sunny Hill, i kuruar nga Dua Lipa – që në vitin 2025 sjell yje si Shawn Mendes, Fatboy Slim dhe Peggy Gou – është treguesi më i qartë: ky vend po flet në gjuhën e muzikës botërore.

Komuna e Prishtinës ofron mbështetje institucionale edhe për festivalin **Chopin Piano Fest Prishtina**, që sivjet, fjala bie, solli pianistë nga Kosova, Shqipëria, Polonia, Austria, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar, Sllovakia, Hungaria, Lituania, Kroacia, Luksemburgu, Italia, Franca dhe Kuba e Suedia, e që po ashtu ndërlidh talentët lokalë me audiencën globale. Përkrahim edhe festivalin ndërkombëtar të filmit **PriFilmFest** (Prishtina International Film Festival), i cili që nga viti 2009 sjell regjisorë e producentë ndërkombëtarë, organizon forume bashkëprodhimi dhe promovon kinematografinë shqipe në skenën evropiane e më gjerë.

Përkrahim festivalin **FemArt** përmes ofrimit të hapësirave publiko-kulturore, mbështetjes logjistike dhe promovimit institucional të aktiviteteve që avancojnë barazinë gjinore dhe artin feminist. Bashkëpunojmë me festivalin **ReMusica**, duke siguruar mbështetje institucionale për programin "ReMusica Junior"), duke ofruar hapësira publike dhe atelier në Pallatin e Rinisë për masterklasa e koncerte, dhe duke lehtësuar bashkëpunime me artistë e organizata ndërkombëtare si European Union Youth Orchestra, teksa promovojmë festivalin edhe në kuadër të diplomacisë kulturore. Mbështesim edhe festivalin ndërkombëtar të romanit grafik **GranFest**, me çka qyteti ynë është i vetmi në krejt

In Prishtina, we do not define transformation by new buildings and infrastructure projects alone. We gauge it by how our city provides spaces for expression, memory, and cultural coexistence. Since 2021, Prishtina has begun a serious reinvention of the role that art and culture play in our lives, with detailed policies that support the artistic and cultural scene. Our Strategy for Art and Culture for the period 2026 to 2031, developed with broad participation from the artistic community, is the most ambitious plan we have ever conceived. It is not only about preserving our heritage, but also about encouraging innovation, creativity, and international connectivity so that our culture can be presented beyond the borders of Kosova. Prishtina is becoming a cultural destination, a model that the entire region looks to with admiration.

Our real support for culture is also measured by the festivals that stand out on the world stage. The Sunny Hill Festival, taking place this year from August 1 to 3, and the Ramë Lahaj International Opera Festival, from July 27 to August 2, are powerful evidences that Kosova's music program is at the highest global level. Sunny Hill, curated by Dua Lipa, which in 2025 features stars such as Shawn Mendes, Fatboy Slim, and Peggy Gou, is the clearest sign that this country is speaking the language of global music.

The Municipality of Prishtina offers institutional support to the Chopin Piano Fest Prishtina, which this year featured pianists from Kosova, Albania, Poland, Austria, Ukraine, the United Kingdom, Slovakia, Hungary, Lithuania, Croatia, Luxembourg, Italy, France, Cuba, and Sweden. The festival connects local talent with a global audience. We also support the PriFilm Fest International Festival, which since 2009 has brought international directors and producers, organized co-production forums, and promoted Albanian cinematography on the European stage and beyond.

We support the FemArt Festival by

rajonin që promovon këtë lloj arti me autorë e pjesëmarrës nga Franca, Kuba, Belgjika, Palestina, Tajvani, Irani, Izraeli, Ukraina dhe shumë vende të tjera, si dhe çdo vit rrit fondin e romaneve grafike ndërkombëtare të disponueshme në shqip. Më 2023, pas një pauze disavjeçare, rikthyem Festivalin **Prishtina Jazz Festival**, po ashtu ndërkombëtar në natyrën e tij, duke kontribuuar më tej në pasurimin e skenës kulturore të kryeqytetit. Mbështesim **Panairin e Librit** duke i ofruar hapësira, një pjesë të financimit dhe bashkërendim institucional për organizimin e këtij eventi që promovon leximin dhe zhvillimin e kulturës së librit në kryeqytet.

Një risi kulturore sivjet, si pjesë e strategjisë sonë për kulturën, është themelimi i Orkestrës Prishtina nga vetë institucioni ynë. Pse? Sepse kulturën e duam të rrjedhë në çdo hapësirë publike, t'i japë qytetit një identitet dinamik, që nuk varet vetëm nga festivalet e as kontributorët e jashtëm. Duke e pasur orkestrën tonë, ne nuk jemi vetëm spektatorë – jemi protagonistë në skenën kulturore.

Pra, misioni ynë është i qartë dhe i palëkundshëm: të fuqizojmë Prishtinën përherë e më shumë si një qendër të zjarrtë të kulturës dhe të artit, që çdo qytet në rajon ta shikojë me admirim dhe lakmi, dhe një pikë fokale prej ku talenti kosovar gjen hapësirë për të shkëlqyer në skenën globale. Kjo është ëndrra që po e ndërtojmë së bashku, duke krijuar jo vetëm ngjarje dhe hapësira, por një identitet të fuqishëm që e vendos Prishtinën në zemër të kulturës botërore. Pra, unë dhe ekipi im po ndërtojmë një Prishtinë që rreh sipas ritmit të botës, që krijon, depërton, frymëzon dhe tërheq vëmendje globalisht. Arti nuk është ornament, as vetëm mjet – është vetë thelbi. Dhe ky thelb është zëri ynë, është qenia jonë.

Hapësirat e rikthyera – nga pasiviteti në përdorim të gjallë

Veç këtyre, Komuna e Prishtinës ka ndërmarrë hapa konkretë për t'i rikthyer dhe rinovuar ndërtesat dhe ambientet publike me qëllim që të përdoren për aktivitete kulturore, duke e fuqizuar kështu jetën kulturore në kryeqytet. Disa prej veprimeve më të rëndësishme janë:

Rihapja e Sallës së Pallatit të Rinisë - Me një investim prej 350 mijë euro për

Orkestra e kryeqytetit

rinovimin dhe funksionalizimin e sallës, Komuna ka mundësuar zhvillimin e këtij festivali me rëndësi kombëtare, duke e pozicionuar atë si një ngjarje vjetore që jo vetëm sjell publikun pranë muzikës shqiptare, por edhe forcon përdorimin kulturor të një objekti emblemë të qytetit tonë.

Art-Tek Tulltorja - Kemi nisur transformimin e ish-Fabrikës së Tullave përmes projektit "Art-Tek Tulltorja", fitues i një konkursi ndërkombëtar të zhvilluar në bashkëpunim me arkitektin Rafi Segal dhe një ekip ndërkombëtar, që synon ta kthejë këtë hapësirë industriale në një qendër arti, inovacioni dhe teknologjie me studio artistike, galeri dhe ambiente për publikun. Me një buxhet rreth 1.2 milionë euro, projekti ka për qëllim të rigjallërojë zonën e Kodrës së Trimave dhe të krijojë një nyjë të re kulturore dhe urbane në kryeqytet. Fabrika është shfrytëzuar edhe nga Manifesta dhe nisma të tjera për evente kulturore e ekspozita, duke shërbyer si model për adaptimin e trashëgimisë industriale në funksion të kulturës publike.

Observatori i Prishtinës (në hapësirat e Pallatit të Rinisë)- I rindërtuar me mbështetjen e UNMIK-ut dhe të komunës, observatori u riaktivizua në korrik 2023 pas 43 vjetësh, duke u rikthyer si hapësirë për edukim shkencor dhe kulturor.

Sahat Kulla – në korrik të vitit 2021, Komuna ndau 70 mijë euro nga buxheti, ndërsa UNDP-ja kontribuoi me 50 mijë euro, për restaurimin e këtij monumenti dhe

offering public cultural spaces, logistical support, and institutional promotion of activities that advance gender equality and feminist art. We also collaborate with the ReMusica Festival, offering institutional support for the ReMusica Junior program, as well as public venues and ateliers at the Palace of Youth for masterclasses and concerts. We facilitate collaborations with international artists and organizations such as the European Union Youth Orchestra, while promoting the festival within the framework of cultural diplomacy.

We also support the international graphic novel festival GranFest, making our city the only one in the region to promote this art form through authors and participants from France, Cuba, Belgium, Palestine, Taiwan, Iran, Israel, Ukraine, and many other countries. Each year, the festival also expands the stock of international graphic novels available in Albanian. In 2023, after a pause of several years, we brought back the Prishtina Jazz Festival, once again international in its profile, contributing further to the richness of the cultural scene in the capital. We support the Book Fair by providing space, partial funding, and institutional coordination for this event, which promotes reading and the development of book culture in the capital.

A cultural innovation this year, as part of our cultural strategy, is the establishment of the Prishtina Orchestra. Why did we do this? Because we want

funksionalizimin e orës dhe të kambanës – ndërthurur me punime fizike dhe ndriçim të strukturës së jashtme për t'i rikthyer bukurinë e mëparshme.

Gërmia – Një projekt tjetër që e mishëron këtë frymë është rikthimi i ish-Shtëpisë së Mallrave "Gërmia" si sallë koncertale. Projekti është pezulluar përkohësisht për shkak të masave të BE-së ndaj Kosovës, por pritet të rifillojë sapo ato të hiqen, sipas zotimeve të dhëna publikisht nga zëvendëspresidentja e Komisionit Evropian Kaja Kallas, më 22 maj këtij viti në Prishtinë.

Sivjet e përcaktuam edhe projektin për **Muzeun e Paqes**, me qëllim që ta forcojmë kujtesën kolektive, t'i edukojmë qytetarët tanë me vlerat e demokracisë dhe të paqes, dhe ta shndërrojmë këtë muze në një pikë identitare për Prishtinën dhe Kosovën. Me mbështetjen bujare të Xhim Xhemës, i cili mori përsipër të financojë plotësisht disenjimin dhe ndërtimin, ky projekt mori hov të ri dhe e çliroi komunën nga barra financiare e realizimit.

Pra, në një kohë kur shumë kryeqytete i trajtojnë artin dhe kulturën si dekore – të përdorshme në ditë festive – Prishtina po u qaset atyre si elemente kyçe të jetës publike dhe të zhvillimit urban. Arti nuk është shtojcë e bukur, por mjet politik, social dhe ekonomik. Me investime të qëndrueshme, me politika të matshme dhe me përfshirje të vërtetë, arti në Prishtinë nuk është më mysafir, por banor.

Feminizmi – jo thjesht përmendje, por politikë

Në Prishtinë, ku lëvizjet shoqërore e kulturore gjithnjë më shumë kërkojnë institucione që e kuptojnë kompleksitetin e barazisë, institucioni ynë ka filluar të ndërtojë një qasje më të vetëdijesuar ndaj çështjeve që lidhen me gratë, vajzat dhe të drejtat e tyre. Megjithëse jo gjithmonë e artikuluar si "feministe", kjo qasje përshkohet nga elemente të qarta të feminizmit institucional – në planifikim, në buxhetim, në përkrahjen e nismave dhe në vetë strukturat e saj vendimmarrëse.

Në fund të vitit 2024, nisëm procesin e hartimit të një Plani Lokal për Barazi Gjinore për periudhën 2024–2026. Ky dokument, i hartuar përmes konsultimeve publike me organizata të shoqërisë civile, aktiviste dhe përfaqësuese të

culture to flow through every public space, giving the city a dynamic identity that is not dependent only on festivals or external contributors. By having our own orchestra, we are not only spectators. We are protagonists on the cultural stage.

So our mission is clear and unwavering. We want to strengthen Prishtina more and more as a vibrant center of culture and art, admired across the region, and as a focal point from which Kosovar talent finds space to shine on the global stage. This is the dream we are building together, by creating not only events and venues but a strong identity that places Prishtina at the heart of global culture. I and my team are building a Prishtina that moves with the rhythm of the world, that creates, connects, inspires, and attracts global attention. Art is not an ornament, nor merely a tool. It is the very essence. And that essence is our voice. It is who we are.

Reclaimed Spaces – From Passivity to Vibrant Use

Beyond these efforts, the Municipality of Prishtina has taken specific steps to reclaim and renovate buildings and public spaces with the aim of repurposing them for cultural activities, thus strengthening the cultural life of the capital. Some of the most significant actions are the following:

Reopening of the Palace of Youth Hall – With an investment of €350,000 for renovation and functional adaptation, the Municipality enabled the hosting of this nationally significant festival, establishing it as an annual event that not only brings the public closer to Albanian music but also reinforces the cultural use of an iconic structure of our city.

Art-Tek Tulltorja – We have initiated the transformation of the former Brick Factory through the 'Art-Tek Tulltorja' project, winner of an international competition held in collaboration with architect Rafi Segal and an international team. The project aims to render this industrial site into a center for art, innovation, and technology, with artist studios, galleries, and public spaces. With a budget of around €1.2 million, the project intends to revitalize the Kodra e Trimave area and establish a new cultural and urban hub in the capital. The factory has also been used by 'Manifesta' and other initiatives for cultural events and exhibitions, serving as a model for the adaptive reuse of industrial heritage in the service of public culture.

The Prishtina Observatory (in the Palace of Youth spaces) – Reconstructed with the support of UNMIK and the Municipality, the observatory was reactivated in July 2023 after 43 years, returning as a space for scientific and cultural education.

The Clock Tower – In July 2021, the Municipality allocated €70,000 from the budget, while UNDP contributed €50,000, for the restoration of this monument and the reactivation of its clock and bell – all that combined with physical works and external lighting to restore its former beauty.

Gërmia – Another project that embodies this spirit is the revitalization of the former 'Gërmia' Department Store into a concert hall. The project has been temporarily suspended due to EU measures against Kosova but is expected to resume once those are lifted, as publicly pledged by European Commission Vice-President Kaja Kallas during her visit to Prishtina on May 22 this year.

This year we also completed the concept for the Peace Museum, aimed at strengthening collective memory, educating our citizens on the values of democracy and peace, and rendering this museum into an identity point for Prishtina and Kosova. With the generous support of Xhim Xhema, who took on full responsibility for financing the design and construction, the project gained new momentum and freed the Municipality from the financial burden of implementation.

So, at a time when many capitals treat art and culture as decorative – reserved for festive occasions – Prishtina approaches them as essential elements of public life and urban development. Art is not some beauty accretion, but a political, social, and economic tool. With sustainable investments, measurable policies, and genuine inclusion, art in Prishtina is no longer a guest, but a resident.

komuniteteve të margjinalizuara, synon të bëhet një udhërrëfyes për mënyrën se si barazia gjinore duhet të jetë e pranishme në çdo politikë e projekt të Kryeqytetit. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare si UN Women ka sjellë edhe përfitime të prekshme: qasja në buxhetim të ndjeshëm gjinor është përfshirë në disa drejtori, duke i orientuar fondet komunale drejt përkrahjes së grave në biznes, në arsim profesional dhe në ndërmarrje sociale.

Por përkrahja nuk ka qenë vetëm në fushën e politikave të mëdha. Nëpër lagjet e Prishtinës janë bërë ndryshime të vogla, por të ndjeshme: përmirësimi i ndriçimit publik në rrugë e parqe ku gratë raportojnë ndjesi pasigurie, krijimi i hapësirave publike të qasshme për nënat me fëmijë, si dhe përfshirja e grave në proceset konsultative të planifikimit urban. Këto ndërhyrje janë themelore në përkthimin e perspektivës gjinore në përvojë të përditshme.

Në anën tjetër, Prishtina ka qenë skenë e nismave kulturore me theks të qartë feminist. Një prej tyre ishte projekti "Shliroj cicat" i artistes Ermira Murati, që nëpërmjet një transformimi simbolik të reçipetave në çanta mbledh fonde për pacientet me kancer të gjirit. Komuna e mbështeti këtë projekt si një mënyrë për të zgjeruar diskursin rreth shëndetit të grave.

Në bashkëpunim me organizata si Artpolis, janë zhvilluar trajnime dhe shkolla verore me fokus në edukimin gjinor për të rejat, përfshirë vajzat me aftësi të kufizuara – një hap drejt një barazie që nuk është vetëm gjinore, por edhe ndërlidhëse dhe gjithëpërfshirëse. Përmes projekteve të tilla, qasja e komunës ka dalë nga kuadri i dokumenteve për t'u kthyer në përjetime, ndërgjegjësime dhe forma të reja të përfaqësimit.

Përpiqemi të ndërtojmë një qytet ku barazia gjinore të mos jetë thjesht qëllim abstrakt, por praktikë e prekshme e përditshmërisë. Nëpërmjet politikave gjithëpërfshirëse, mbështetjes për artin feminist, dhe punës me grupet më të ndjeshme të shoqërisë, po ndërtojmë një frymë ku zëri i grave nuk është plotësues, por themelor.

Sot, kur shumica e qyteteve po zhvillohen në garë me kohën, por po harrojnë të ndalen për të pyetur se kush po përfiton vërtet, Prishtina po ndërton një model qyteti që nuk e sheh kulturën dhe barazinë si dekor politik, por si motor zhvillimi. Kjo nuk është thjesht çështje e mbështetjes së arteve apo e përfshirjes së grave, po zgjedhje strategjike për ta bërë qytetin një hapësirë ku të gjithë kanë jo vetëm vend, por edhe zë. Dhe pikërisht aty fillon të ndërtohet qyteti që nuk kërkon ta imitojë askënd tjetër – por të jetë vetvetja, me zë të lartë dhe pa asnjë kompromis.

"Prishtina po ndërton një model qyteti që nuk e sheh kulturën dhe barazinë si dekor politik, por si motor zhvillimi"

Feminism – Not Just Mentioned, but Enacted as Policy

In Prishtina, where social and cultural movements are steadily demanding institutions that understand the complexity of equality, our institution has begun to build a more conscious approach toward issues concerning women, girls, and their rights.

Though not always explicitly articulated as 'feminist,' this approach is apparently imbued with elements of institutional feminism – reflected in planning, budgeting, support for initiatives, and in the very structures of decision-making.

At the end of 2024, we launched the drafting process for a Local Gender Equality Plan for the 2024–2026 period. Built through public consultations with civil society organizations, activists, and representatives from marginalized communities, this document aims to become a guiding framework for ensuring that gender equality is embedded in every policy and project of the Capital. Collaboration with international organizations such as UN Women has also yielded tangible benefits: gender-sensitive budgeting has been encapsulated in various departments, channeling municipal funds toward support for women in business, vocational education, and social enterprises.

But support hasn't been limited to broad policy areas. In Prishtina's neighborhoods, small but impactful changes have been made: improving public lighting in streets and parks where women report feeling unsafe, creating accessible public spaces for mothers with children, and including women in consultative processes of urban planning. These interventions are pivotal to converting a gender perspective into everyday experience.

Meanwhile, Prishtina has been the stage for cultural initiatives with a clear feminist emphasis. One such project was 'Free the Boobs' by artist Ermira Murati, which, through the symbolic transformation of bras into bags, raises funds for breast cancer patients. The Municipality supported this project as a way of broadening the discourse around women's health.

In collaboration with organizations like Artpolis, trainings and summer schools focusing on gender education for young women have been developed, including programs for girls with disabilities – an important step toward an equality that is not only gendered but also intersectional and inclusive. Through such projects, the municipality's approach has moved beyond policy documents and into lived experiences, new forms of awareness, and representation.

We are striving to create a city where gender equality is not just an abstract goal, but a tangible, everyday practice. Through inclusive policies, support for feminist art, and engagement with society's most vulnerable groups, we are fostering a spirit in which women's voices are not supplementary, but essential.

Today, while most cities race against time without taking a stop to ask who is truly benefiting, Prishtina is building a city model that doesn't see culture and equality as political décor, but as engines of development. This is not simply about supporting the arts or including women – it is a strategic choice to make the city a space where everyone has not only a place, but a voice. And that is exactly where the city begins to be built, not by trying to imitate anyone else, but by being unapologetically itself, loudly and without compromise.

"Prishtina is building a city model that doesn't see culture and equality as political décor, but as engines of development"

Kitaristi virtuoz i rokut

GILI **HOXHAJ**

Shumë prej hiteve muzikore mbajnë vulën e tij të kompozimit. Jetëshkrimi i tij mbahet në gjashtë tela të kitarës. Nexhat Macula mbetet vital në muzikë duke krijuar për shumë artistë. Ai mësoi kitarën vetë e më pas luajti në skenat e ish-Jugosllavisë, ishte pjesë e themelimit të "FAN" dhe "TNT"- dy grupe të rokut në Kosovë. Universi i tij muzikor nuk ndalet veç në lojën me kitarën, është edhe përtej kësaj.

Të shumtën e rasteve teksa interpreton në kitarë sytë i mban mbyllur. Ka një përkulje të lehtë herë para e herë prapa, varësisht nga tingulli. Ca mimika në harmoni me muzikën. Është nga ata instrumentistë që praninë në skenë e justifikon me mjeshtërinë e lojës. Nexhat Macula ka një bagazh të madh muzikor si në interpretim, ashtu dhe në kompozim. Kitaristi virtuoz është edhe një personifikim i përhapjes së rokut në Kosovë. Ai mbeti besnik i tingullit shqip dhe asaj që krijojnë instrumentet tradicionale. Në krijimet e tij ky gërshetim është përherë i pritshëm.

I lindur në një familje 8-anëtarëshe, Macula thotë se fëmijëria e tij ishte pa diçka të veçantë, si e të gjithë fëmijëve të asaj kohe në Mitrovicë - por fati ia dha privilegjin që të merrej me muzikë meqë nga familja e të dy prindërve kishte shkencëtarë dhe muzicientë. Në klasën e gjashtë e regjistroi shkollën e ulët të muzikës dhe aty u hap shtegu drejt botës muzikore, ku filloi ta mësonte instrumentin e violinës.

"Nga aty fillon zhvillimi im si muzicient, e në veçanti për faktin se në të njëjtën kohë isha në kontakt me tri stile muzikore: muzikën klasike, atë popullore dhe rokun", ka treguar Macula. Muzikën popullore e kishte

The Virtuoso Guitarist of Rock

Many musical hits bear his compositional mark. His biography unfolds through the six strings of a guitar. Nex-hat Macula remains at his prime, composing music for many artists. This self-taught virtuoso guitarist performed across the stages of former Yugoslavia – being a founding member of the rock bands FAN and TNT in Kosova. Nonetheless, his musical universe extends far beyond the guitar.

For the most part, while performing with his guitar, he plays with his eyes closed. He leans slightly forward or backward, following the sounds. His facial expressions harmoniously follow the music. He is one of those performers whose presence is justified by pure skill. Nexhat Macu-la has a vast musical background, both in performances and compositions. He also embodies the rise of rock music in Kosova. Macula remained faithful to Albanian melodies and those rooted in traditional instruments —this musical fusion permeates all over his work. Born into a family of eight members, Macula recounts a childhood as ordinary as those of his peers in Mitrovica at the time—yet destiny reserved him the privilege of devoting himself to music as his family included both scientists and musicians. While he was in the sixth grade, he enrolled in Elementary Music School which marked the beginning of his journey into the realm of music—it was a time when he first took up the violin.

"That's where my growth as a musician commenced, all the more so since I was simul-

mësuar nga djemtë e axhës. Por këto përvoja thotë t'i jenë gjendur më vonë. E la instrumentin harkor për të luajtur me gishtat e duarve gjithë jetën mbi gjashtë telat e kitarës. Përcaktimi për kitarën tregon se përbrenda i peshonte më shumë pasioni për rokun. "Kitarën e mësova vetë me shumë mund e sakrificë", thotë Macula, që koncertin e parë ku preku skenën e pati si 13-vjeçar. Skenës nuk do t'i ndahej më.

"Vëllai im, ndjesë pastë, ka qenë 8 vjet më i madh se unë. Në të 66-ën unë në shtëpi të babait tim në Mitrovicë, atëkohë e kanë pasur një bend vëllai im, djali i axhës, djali i hallës dhe dy serbë. Aty, unë krahas shkollës së ulët të muzikës – atëherë ka qenë e madhe edhe edukata, edhe respekti, e s'ke guxuar të hysh në dhomë ku ushtronin ata - shoh një akord të vëllait. Tinëz e hap derën, e shoh njëfarë trekëndëshi. Pas tre vjetësh i kam ra në fije që është D-dur", tregon ai. Ishin të ndikuar nga grupet rok të njohura të atëhershme botërore që i dëgjonin në LP pllaka ku Macula thotë se edhe e zhvilloi veshin muzikor. E kujton se kitarën e parë e kishte blerë 20 marka gjermane edhe atë tek më vonë, sepse më parë ushtronte me kitarat akustike që kishte në shtëpi.

Nga themelimi i FAN-it deri te skenat e ish-Jugosllavisë

Në vitin 1967 u bë pjesë e themelimit të rok-grupit muzikor "FAN", pjesë e të cilit ishin edhe Ramadan Ismajli-Ukça, Nexhip Abrashi, Skënder Jetullahu, si dhe Faruk Xhelili dhe Xhevdet Gashi me intervale. Rryma e rokut filloi të përhapej nga qyteti i minatorëve.

"Ky grup ishte dhe do të jetë përherë në zemrën time. Aty u avancova tepër shumë si i ri pasi i deshifroja të gjitha këngët për repertorin tonë", ka treguar tutje Macula. Ai konsiderohet instrumentist i saktë e preciz që e zotëron kitarën në çdo lëvizje të gishtërinjve. Energjik dhe i pandalshëm.

"Me FAN, me disa kredi bankare blemë disa amplifikatorë dhe filluam të ushtrojmë. Aty ka qenë periudha më produktive për mua si amator. Kemi pasur sukses me grupin FAN, kemi qenë grupi më i njohur", ka treguar instrumentisti dhe kompozitori Macula.

Në bisedë me të e heton që Macula nuk ia kishte besuar karrierën veç talentit. Thotë se kishte punuar shumë dhe me entuziazëm. Universi i tij muzikor ishte vazhdimisht në eksplorim. Kështu që mori vëmendje dhe përtej. Preku dhe skenat matanë Kosovës. Por, gjithë këtë e tregon me modesti. Në vitin 1976 mori ftesën për t`u bërë autori i grupit "YU" në Beograd – i cili bëri jehonë në hapësirat e ish-Jugosllavisë dhe që ishte pionier

taneously exposed to three musical styles: classical music, folk, and rock", Macula says. He was introduced to folk music through his cousins. These experiences proved later to be profoundly useful. Then, he set aside the violin and dedicated his artistic life to guitar strings. This choice meant that his passion for rock outweighed everything else.

"I acquired the guitar through great efforts and sacrifice."

He was only 13 when he first set foot on a concert stage. From that moment, he would never left it.

"My brother—may he memory be blessed—was eight years older than me. In 1966, in our fa-ther's house in Mitrovica, he had a band with two of our relatives and two Serbs. The sense of respect back then was so compelling that I did not even dare to enter the room where they re-hearsed—yet, one day, I randomly stumbled across a chord of my brother. I surreptitiously opened the door and saw something triangular. Three years later, I realized it was D major", he recounts.

They were influenced by world-renowned rock bands through vinyl LPs, which helped develop their musical ear. He bought his first guitar for 20 German marks, as he initially practiced on acoustic guitars.

From the Founding of FAN to the Stages of Former Yugoslavia

In 1967, he joined the rock band FAN, whose members included Ramadan Ismajli-Ukça, Nexhip Abrashi, Skënder Jetullahu, and occasionally Faruk Xhelili and Xhevdet Gashi. It was a time when rock music had just begun to spread in the mining city.

"This group will always have a place in my heart. As a young man, I advanced very well, decipher-ing all the songs in our repertoire," says Macula. He is deemed a precise performer who skillfully plays the guitar—being so energetic and unstoppable.

"With some bank loans, we bought amplifiers and began rehearsing. It was the most productive period of my nascent career. Our band FAN became quite successful—the most famous at the time."

As the conversation goes on, Macula makes it clear that he did not rely on talent alone. He worked tirelessly, driven by enthusiasm. His

në gërshetimin e motiveve folklorike ballkanase në atë rok. "Kjo ka qenë një eksperiencë tejet e madhe mu për shkakun se kishte profesionalizëm tejet i madh. E realizuam një album muzikor ku kritikët e muzikës rok më vlerësuan si shumë produktiv", ka treguar ai. Aty, Macula qëndroi për dy vjet. Vetëm për një vit ata kishin realizuar rreth 250 koncerte.

"Gjithmonë kam tentuar që këngët e mia të jenë në frymën e rokut"

Nexhat Macula është një nga figurat më të rëndësishme të muzikës rok në Kosovë dhe si anëtar themelues i grupit legjendar TNT, i cili u identifikua me muzikën e zhanrit pop-rok. Ka kompozuar për disa nga këngët më të njohura të grupit TNT – këngë që identifikohen që në melodinë e parë e janë kënduar e këndohen përmendsh tok me këngëtarët. Rruga e tij me rokun mori një kthesë përgjatë kompozimeve për TNT-në, por kishte një arsye që e bëri Maculën të pajtohej me këtë. Ato këngë edhe u bënë hitet më të mëdha të grupit.

"Gjithmonë kam tentuar që këngët e mia të jenë në frymën e rokut si 'Loqka'

dhe 'Ata sy', mirëpo diçka ndryshoi me kohë, në momentin kur kompozova 'Moj bjondinë me sytë e zi' dhe '200 ditë' u pajtova me këtë, mu për faktin që tingëllojnë shqip dhe nuk është kopje e asgjësë", u shpreh tutje Macula.

Zëri i solistit Ferki Shala thotë se e kishte mahnitur dhe e nxiste për të krijuar edhe më shumë. TNT u themelua në vitin 1974 duke sjellë një frymë të re muzikore. Janë kryesisht këngë dashurie që himnizojnë bukurinë, i këndojnë nostalgjisë, pritjes e dashurisë ndaj gjuhës dhe atdheut. TNT ka qenë grupi që ka mbushur sallat kudo që ka kënduar, edhe nëpërmjet baladave i ka bërë të pranishmit të vallëzojnë – si një festë për dashurinë e kujtimet. TNT është rritur ndër dekada bashkë me publikun e tij. "I falënderohem përzemërsisht adhuruesve të TNT-së që na përkrahen me shpirt me dekada dhe do të vazhdojnë besoj se TNT-ja është ende gjallë", thotë Macula, teksa përmend se kënga që i fle në zemër është "Lumi që na

musical universe kept constantly expanding, and thus he began to draw attention by making appearances on stages outside Kosova. He recalls with humility all these experiences. In 1976, he received an invitation to join the group YU in Belgrade—echoing all over former Yugoslavia for pioneering the fusion of Balkan folk music with rock.

"To me, it was a tremendous experience, full of professionalism. We succeeded in releasing an album, and I received accolades from critics," he evokes. He remained with the group for two years. In just one year, they performed on 250 concerts.

"I always Strived for My Songs to Embody the Spirit of Rock"

Nexhat Macula is one of the most outspoken figures in Kosova's rock scene, as a founding mem-ber of the legendary pop-rock group TNT. He composed some of TNT's best-known songs—so recognizable from the very first melody, and still sung today. His journey in rock music took a turn, yet for a good reason that Macula endorsed. These songs became the greatest hits of the band.

"I always strived to keep my songs in the spirit of rock—like 'Loqka' and 'Ata sy'—but some-thing changed over time as soon as I composed 'Moj bjondinë me sytë e zi' and '200 ditë'. I ac-cepted that shift because they sounded so Albanian, unlike anything nothing else," says Macu-la.

He confesses he was deeply impressed by the voice of Ferki Shala, something that encouraged him to create more. Founded in 1974, TNT introduced a new musical spirit. Its songs—by and large love ballads—extoll beauty, emanate nostalgia, and celebrate love for language and homeland. TNT filled concert halls with its romantic ballads that enticed the

ndan", me tekst të Hivzi Krasniqit dhe orkestrim të Riza Dolakut, të dy të ndjerë tashmë.

"Të dy gjigantë të artit dhe kulturës", shprehet Macula.

Prishtina ka marrë profil metropoli

Kujtimet e tij me Prishtinën janë kryesisht në skenë dhe në studiot e Radiotelevizionit të Prishtinës, ku i incizonin këngët në atë kohë. Prishtina është vendi prej nga këngët e tyre merrnin jetë dhe e mblidhnin publikun. Për Maculën, që krijoi në të dyja kohët, Prishtinën e sheh si një vend rezistence dhe triumfues karshi sfidave. "Prishtina për mua ka marrë profil të metropolit dhe është qytet i rinisë, i cili tejkaloi shumë sfida dhe nuk u dorëzua. Këtë qytet e ndiej si simotër të Mitrovicës ku e gjeta veten në koncerte të shpeshta dhe më i rëndësishmi ishte incizimi në studiot e RTP-së", ka thënë ai. Në vitin 1990, Macula publikoi albumin instrumental "Kosovës", një vepër që shfaqte mjeshtërinë e tij në kitarë dhe ndjeshmërinë artistike. Ky album përmban kompozime si "Prej një shpati", "Lulija" dhe "Be-lu", të cilat janë vlerësuar për cilësinë e tyre muzikore dhe emocionin që transmetojnë. Ky album konsiderohet si një testament i ndjenjave dhe lutje pa fjalë – një himnizim i vendlindjes duke ndërthurur tingujt e kitarës me tinguj tradicionalë. Macula e interpretoi veprën "Kosovës" mbi tri dekada pas në koncertin "Rrno për më tregue" në përvjetorin e 15-të të Pavarësisë së Kosovës. Interpretimi i Macula-s, i shoqëruar nga orkestra e Filharmonisë së Kosovës e me tinguj fyelli, shërbeu si lidhje e dekadave, si lutje dhe si festë. Me një lojë me finesë në kitarë. Ndonëse fjalëpakë, ai është këtu për të dhuruar akoma emocion e tinguj. Mbetet nga ata që flet më së miri nëpërmjet kitarës.

audience to dance—a true feast for love and memory. Over the decades, TNT grew alongside its fans.

"I am wholeheartedly grateful to TNT's fans, who have supported us for decades and continue to do so because TNT is still alive," says Macula. He is so fond recalling his affection for the song "Lumi që na ndan", written by Hivzi Krasniqi and orchestrated by Riza Dolaku, both now de-parted.

"They were giants of art and culture," he reminisces.

Prishtina Got the Profile of a Metropolis

Macula's memories of Prishtina chiefly revolve around its performance stages and the studios of Radio Television of Prishtina (RTP), where many of their songs got recorded. It was the center where their songs were brought into life and reached the public. With his creative activity ex-tended across two periods, Macula sees Prishtina as a place of resistance that triumphed over various challenges.

"For me, Prishtina got the profile of a metropolis—the city of my youth that withstood numer-ous challenges and never gave in. I feel it as a twin city of Mitrovica where I had numerous con-certs—thus, most of my most lovable memories are those of recording in the RTP studios," says Macula.

In 1990, Macula released his instrumental album "Kosovës" (To Kosovo), conveying his mastery on the guitar and his artistic subtlety. The album encapsulates compositions such as "Prej një shpati", "Lulija", and "Be-lu", acclaimed for their musical quality and emotional resonance. It stands as a testament of feelings and a wordless prayer—a hymn to the homeland intertwining the sound of the guitar with traditional motives.

Three decades later, Macula performed pieces from "Kosovës" at the concert "Rrno për me tregue" (Live to Tell the Tale) on the occasion of the 15th anniversary of Kosova's independence. With his elegant posture, Macula—accompanied by the Kosova Philarmonic's Orchestra and traditional pipe sounds—bridged two eras in a concert that felt like both a prayer and a feast. A superb display of guitar brilliance. Though he speaks little, he conveys so much emotions and sounds. They are best communicated through his guitar.

"Defy Them" Një mikrokozmos rezistence artistike

DEFY THEM STAFF
Disa nga anëtarët e stafit të Defy Them. (Nga e majta) Ylber Havolli, Ilir Berisha, Kombëtar Uskana dhe Galdon Reçica.

ELVIRA BERISHA

Në zemrën e një kryeqyteti ku arti alternativ shpesh mbetet në hije dhe skena dominohet nga muzika komerciale, "Defy Them" ia ka dalë të krijojë një mikrokozmos të rezistencës artistike. Themeluar në vitin 2018 nga Art Lokaj dhe Ilir Berisha, në një garazh të vogël, kjo platformë ka lindur si përgjigje ndaj nevojës për infrastrukturë dhe kushte teknike për muzikantët e rinj të Prishtinës.

Fillimi ishte goxha sfidues, duke nisur nga mungesa e fondeve, blerja e pajisjeve muzikore, por mbi të gjitha edhe ndërtimin e një komuniteti të tërë. Por vullneti për t'i sfiduar këto rrethana ka qenë po aq i madh sa edhe vizioni për të ndërtuar një skenë të qëndrueshme alternative. Sot, "Defy Them" është një platformë e konsoliduar, me projekte të suksesshme, bashkëpunime e përkrahje që u jep grupeve të muzikës rok. Përtej kësaj, është shndërruar në një strukturë që po e riformëson skenën muzikore të Prishtinës.

Rrënjët e "Defy Them"

Ideja për "Defy Them" – si label incizimesh dhe qendër e muzikës alternative, punk, rok dhe metal – ka ekzistuar që në fillim të viteve 2000, si përgjigje ndaj mungesës së hapësirave dhe kushteve teknike për ushtrime të bendeve në Prishtinë.

"Që atëherë kemi organizuar disa aktivitete dhe kemi krijuar hapësira më të vogla apo improvizuese, por për shkak të rrethanave të vështira ato nuk kanë arritur të zhvillohen apo të jenë të qëndrueshme", thotë Kombëtar Uskana, bashkëthemelues i "Defy Them".

Fiks 18 vite më vonë, bashkë me Ilir Berishën, hodhën hapin konkret dhe e themeluan "Defy Them" në një garazh të vjetër brenda kompleksit Kosova Tex.

"Sfidat fillestare kishin të bënin me sigurimin e mjeteve për rinovimin dhe trajtimin akustik të hapësirës, si dhe blerjen e pajisjeve dhe instrumenteve muzikore. Pas kësaj, fokusi u zhvendos në konsolidimin e komunitetit. Më tej, sfidat përfshinë ngritjen e cilësisë së shërbimeve profesionale për muzikantët (si miksimi live dhe incizimi në studio), si dhe edukimin e gjeneratave të reja përmes shkollës së muzikës 'Prishtina Rock School'", thotë Uskana.

E gjithë kjo kërkoi një menaxhim dhe organizim kompleks për të funksionuar si platformë dhe për të ndjekur një vizion afatgjatë.

"Për fat të mirë, komuniteti gjithmonë na ka përkrahur dhe ka qenë pranë nesh gjatë sfidave më të mëdha", shton ai.

Shumëçka mund të ketë ndryshuar me kalimin e kohës, por jo edhe misioni që ka qenë gjithmonë i qartë dhe i thjeshtë nga

"Defy Them" A Micro-Cosmos of Artistic Resistance

In the heart of a capital where alternative art often lingers in the shadows and the commercial music is prevailing, 'Defy Them' has succeeded in creating a micro-cosmos of artistic resistance. Founded in 2018 by Art Lokaj and Ilir Berisha in a small garage, this platform emerged as response to a lack of infrastructure and technical conditions for young musicians in Prishtina

The beginnings were quite challenging, marked by a lack of funding, acquiring musical equipment, and, above all, the effort to build an entire community. Yet the will to defy these circumstances was as strong as the vision to establish a sustainable alternative scene.

Today, 'Defy Them' stands as a consolidated platform, known for its successful projects, collaborations, and the support it offers to rock music bands. Beyond this, it has grown into a structure that is reshaping the very landscape of Prishtina's music scene.

Roots of 'Defy Them'

The idea for 'Defy Them' – as a recording label and a center for alternative, punk, rock, and metal music – stretches back in time to the early 2000s, born as a response to the lack of rehearsal spaces and technical infrastructure for bands in Prishtina.

"Even back then, we organized several activities and created small, often improvised spaces, but due to difficult circumstances, they couldn't develop further or become sustainable," says Kombëtar Uskana, co-founder of 'Defy Them.'

Eighteen years later, together with Ilir Berisha, they took a concrete step and founded 'Defy Them' in an old garage within the Kosova Tex complex.

"The initial challenges involved securing funds for renovation and acoustic treatment of the space, as well as purchasing

fillimi.

"Ajo që ka evoluuar është mënyra e veprimit dhe aktivitetet që realizojmë. Me kalimin e viteve jemi përballur me sfida të reja dhe të panjohura, prej të cilave kemi mësuar dhe krijuar një përvojë të veçantë. Për të ndjekur misionin tonë, kemi qenë të detyruar të jemi fleksibilë në organizim dhe shpesh kemi punuar me metodën 'trial and error' – një qasje edhe pse konsumon energji, na ka ndihmuar të gjejmë rrugën më të përshtatshme," thotë Uskana.

Hapi i parë ka qenë konsolidimi i skenës alternative – jo vetëm për kultivimin e muzikës, por edhe për ndërtimin e një imazhi të fuqishëm dhe të organizuar në vend. Kjo gjë është arritur përmes projekteve, si "Reset the World", kompilacionit "Rilindje", "Smash Metal Tour", emisionit në radio "DTX – Defy Them Experience" dhe shumë të tjera.

"Po ashtu kemi bashkëpunuar me institucione dhe organizata për të përkrahur grupet përmes koncerteve dhe projekteve të ndryshme. Vlen të theksohet edhe prania e shumë muzikantëve të huaj gjatë vitit 2024, e cila ka ndikuar në promovimin ndërkombëtar të skenës së Prishtinës", thotë Uskana.

E pavarësisht mbështetjes nga televizionet që e promovuan qendrën përmes storjeve dhe intervistave, muzika rok, beson ai, transmetohet ende shumë pak.

"Kjo kërkon diskutim më të gjerë ndërmjet aktorëve të fushës dhe vetë muzikantëve, të cilët duhet të reflektojnë nëse janë të gatshëm dhe nëse mund të ofrojnë materiale të përshtatshme për transmetim televiziv," thotë Uskana.

Që kur filloi së funksionuari në vitin 2018, për themeluesit ishte e qartë se për zhvillimin e muzikës alternative mungonte infrastruktura dhe qasja në pajisje. Për ta adresuar këtë, u themelua Qendra e Kulturës Alternative (QKA), ku ofrohen kushte profesionale për shkollim, ushtrime, incizime, performanca live dhe të gjitha pajisjet e nevojshme.

"Përmes programit 'Music Incubator', u ofrojmë bendeve të reja hapësira falas për ushtrime, mentorim dhe mbështetje profesionale. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e numrit të bendeve dhe përfshirjen më të gjerë të të rinjve në muzikë", thotë Uskana.

Në një mjedis ku dominojnë zhanret komerciale, muzika alternative e ka të vështirë të jetë konkurruese, por kjo gjë nuk është e pamundshme.

"Mungesa e ambicies në disa pjesë të komunitetit tonë është reale, por ne besojmë se është e nevojshme të vazhdojmë. Skena underground që kemi sot është një bazë

DIE AUSREDEN
Bendi nga Gjermania 'Die Ausreden' duke incizuar albumin e tyre të parë në studion e Defy Them bashkë me audio inxhinierin Galdon Reçica.

instruments and sound equipment. After that, our focus shifted to consolidating the community. Later, the challenges expanded to improving the quality of professional services for musicians, such as live mixing and studio recording, and educating new generations through the music school 'Prishtina Rock School,'" explains Uskana.

All of that required complex management and organization to function as a platform and to pursue a long-term vision.

"Fortunately, the community has always supported us and stood by our side during the greatest challenges," he adds.

Many things may have changed over time, but not the mission, which has always been clear and simple from the beginning.

"What has evolved the most is the way we operate and the activities we carry out. Over the years, we've faced new and unknown challenges, from which we've learned and gained a unique experience. In order to pursue our mission, we've had to remain flexible in our organization, often relying on the 'trial and error' method – an approach that, although energy-consuming, has helped us find the most effective path," says Uskana.

The first step to be taken was consolidating the alternative scene not just for promoting music, but also for building a strong and well-organized image. This was achieved through projects like Reset the World, the Rilindje compilation, the SmashMetal Tour, the radio show DTX – Defy Them Experience, and many others.

"Furthermore, we have collaborated with both institutions and organizations to support bands through various concerts and projects. It is worth mentioning the presence of several international musicians in 2024, which contributed to the international promotion of Prishtina's scene," says Uskana.

Despite the support from TV channels that promoted the center through stories and interviews, he believes that rock music is still rarely broadcasted.

"This requires a broader discussion between the key players in the field and the musicians themselves, who need to reflect on whether they are ready and able to provide suitable material for television broadcasting," says Uskana.

Since its establishment in 2018, the founders were aware that there was a lack of infrastructure and access to equipment for the development of alternative music. To cope with this problem, the Alternative Culture Center was founded, offering professional facilities for training, rehearsals, recording, live performances, and all the necessary equipment.

"Through the 'Music Incubator' program, we offer new bands free rehearsal space, mentoring, and professional support. This has directly contributed to the growth in the number of bands and the broader inclusion of young people in music," says Uskana.

In an environment dominated by commercial genres, alternative

solide, dhe nga ajo mund të dalin këngë apo albume që mund të konkurrojnë denjësisht me muzikën komerciale në aspektin e arritjes deri te masat. Kjo do të ndikonte pozitivisht në përhapjen e kulturës alternative", thotë Uskana.

E sukseset dhe statistikat e vitit që lamë pas janë dëshmi se "Defy Them" po e përmbush suksesshëm misionin e vet, me gjithë sfidat e mëdha rrugës.

Ritmet e Skenës Alternative në 2024

Statistikat e vitit 2024 janë mbresëlënëse - në studion e labelit kanë incizuar 10 bende të ndryshme, janë realizuar 42 këngë si dhe janë organizuar 49 koncerte me muzikantë vendorë e ndërkombëtarë. Kjo pasi "Defy Them" e lë gjithmonë derën hapur për të gjithë.

"Përveç organizimeve tona të planifikuara, kemi pasur edhe shumë kërkesa nga artistë për koncerte dhe aktivitete tjera, gjë që tregon zhvillimin e kulturës në vend. Ne e mbajmë gjithmonë derën hapur për komunitetin, dhe si rezultat, kemi organizuar një numër të madh eventesh në 2024.

Kjo ka sjellë shumë të mira, por njëkohësisht edhe ngarkesë të madhe mbi stafin. Për vitin 2025 po përpiqemi ta planifikojmë më mirë numrin e aktiviteteve dhe të kemi më shumë kontroll," thotë Uskana. Synim i radhës është që fokusi të zgjerohet edhe te zhanret alternative që nuk janë trajtuar sa duhet deri më tani.

"Do të punojmë edhe për edukimin dhe profilizimin e profesionistëve të rinj në menaxhim, booking dhe PR, për të përkrahur bendet me programe specifike. Dokumentimi dhe hulumtimi në muzikë do të jenë gjithashtu prioritete. Skena alternative po zgjerohet me ritme të shpejta, falë punës së organizatave si 'Defy Them', muzikantëve, individëve dhe mbështetjes institucionale," thotë Uskana, duke shprehur bindje që kjo rritje pritet të vazhdojë dhe të arrijë një nivel të qëndrueshëm.

Duke qenë të përfshirë çdo ditë në punën e përditshme të "Defy Them", ai thotë se nganjëherë është vështirë të kuptohet plotësisht ndikimi që po ndodh në komunitet.

"Megjithatë, reagimet pozitive që marrim na ndihmojnë ta kuptojmë më mirë rëndësinë e asaj që bëjmë," thotë ai.

Prishtina si arenë e rritjes

Në vitin 2025, ky label incizimesh dhe qendër e muzikës alternative do të fokusohet në punën me bendet tashmë

music struggles to remain competitive. Nonetheless, it is by no means impossible.

"There is indeed a lack of ambition in some parts of our community, but we believe it is essential to keep going. Today's underground scene offers a solid foundation, and from it, songs and albums can emerge that can proudly compete with commercial music in terms of reaching the masses. That, in turn, would contribute positively to the spread of alternative culture," says Uskana.

The successes achieved so far, and last year's statistics, stand as proof that Defy Them is successfully fulfilling its mission despite the significant challenges along the way.

Alternative Scene's Rhythms in 2024

Last year's statistics are impressive: ten bands recorded in the label's studio, 42 songs were released, and 49 concerts were held, featuring both local and international musicians. All of this was made possible because 'Defy Them' keeps its doors open to anyone interested.

"In addition to our scheduled events, we received numerous requests from artists to organize concerts and other activities, which speaks to the development of our cultural scene. We keep our doors open to the community, and as a result, we hosted a large number of events throughout the past year. This was very rewarding, but it also became a burden for our staff. That's why, this year, we're working to plan activities more efficiently and maintain better control," says Uskana.

Their next goal is to broaden their focus to include alternative genres that have so far received little attention.

"We'll also work on educating and developing new professionals in areas like management, booking, and PR, so we can support bands through targeted programs. Documenting and researching music will remain key priorities," he adds.

Deeply involved in the daily work of 'Defy Them,' Uskana admits that at times it's difficult to fully grasp the impact they are having on the community.

"Still, the positive feedback we receive helps us better understand the importance of what we're doing," he concludes.

Prishtina as a Ground for Growth

In 2025, this record label and alternative music center will focus on well-established bands, music projects, and collaborations with organizations both in Kosovo and abroad.

PRISHTINA JAZZ CATZ - JAM SESSION
Jam session me muzikantë pas koncerti tradicional mujor 'Prishtina Jazz Catz'.

NUCLEAR DOOM
Bendi 'Nuclear Doom' është një nga shumë grupet e reja që është themeluar në Defy Them.

NEVER COME DOWN
Grupi i njohur nga Amerika "Never Come Down" duke performuar në Defy Them.

të konsoliduara, projektet muzikore dhe bashkëpunimet me organizata në Kosovë e jashtë saj.

"Objektivat kryesorë janë: prodhimi, menaxhimi dhe promovimi i muzikës, me një fokus të veçantë edhe jashtë Kosovës," thotë Uskana, duke shtuar se arritja deri këtu ka qenë një rrugë e vështirë e përbashkët me ekipin tonë të palodhur: Ilir Berisha, Ylber Havolli, Galdon Recica, Teoman Ukqa, Erza Morina, Liburn Jupolli dhe shumë të tjerë që punojnë, përkrahin dhe e duan Defy Them. Ndër aktivitetet e shumta me të cilat po dëshmohet suksesi i "Defy Them" është "Music Incubator", e ideuar si platformë që synon zhvillimin e muzikantëve të rinj të zhanrit rok – nxënës dhe studentë deri në moshën 23-vjeçare. Programi është i hapur për të gjithë të rinjtë që kanë njohuri bazike mbi instrumentet dhe kanë nisur formimin e një grupi muzikor.

"Mentorimi bëhet nga profesionistë ndërkombëtarë si Philipp Konrad Labhart nga NGO Better Together dhe profesionistë vendorë. Programi përshtatet sipas nevojave të pjesëmarrësve, duke synuar rritje artistike dhe zhvillim të aftësive praktike. Të interesuarit mund të aplikojnë duke na kontaktuar në: info@defythemcommunity.com," thotë Uskana.

Një risi interesante që solli organizata është edhe "Prishtina Jazz Catz", një seri koncertesh jazz që u mirëprit nga audienca, shpeshherë duke tejkaluar edhe kapacitetet e sallave të improvizuara koncertale në kryeqytet.

"'Prishtina Jazz Catz' është realizuar në bashkëpunim me Visar Kuçin dhe synon të ofrojë koncerte jazz në formën më të pastër të mundshme, të dashur për vetë muzikantët. Publiku e ka pritur me entuziazëm, shpesh duke tejkaluar kapacitetin e sallës. Ngjarja ka krijuar mundësi edhe për muzikantët e rinj që të performojnë në Jam Session me emra të njohur vendorë dhe ndërkombëtarë," shpjegon Uskana.

Me mbi 11,000 vizitorë të regjistruar në aktivitetet e organizuara, duket se "Defy Them" po krijon

një komunitet gjithnjë e më të gjallë.

"Publiku është pjesë përbërëse e çdo eventi dhe pjesë e performancës. Ne mundohemi gjithmonë të ofrojmë një eksperiencë unike dhe sa më cilësore. Zgjerimi i komunitetit po dëshmohet nga rritja e numrit të bendeve, ngjarjeve dhe pjesëmarrësve në Prishtinë dhe qytete të tjera. Sfida jonë është të mbajmë lidhjen mes audiencës dhe artistëve, duke adresuar pritjet gjithnjë në rritje," thotë ai. Mbi këtë premisë, ajo që "Defy Them" merr nga Prishtina dhe jep nga Prishtina është jetike. "Prishtina na ka ofruar një histori të pasur kulturore dhe muzikore, si dhe mundësinë për të vepruar në një nivel të lartë. Si kryeqytet, ajo na ka mundësuar të formësohemi dhe të kontribuojmë në formësimin e saj. Detyra jonë është t'ia kthejmë këtë mundësi me përkushtim, sidomos në edukimin e të rinjve që do të jenë vendimmarrësit e së ardhmes," thotë ai.

"Our main objectives are the production, management, and promotion of music, with a particular focus beyond Kosovo," says Uskana.

He adds that reaching this point has been a difficult journey, shared with his tireless team: Ilir Berisha, Ylber Havolli, Galdon Recica, Teoman Ukqa, Erza Morina, Liburn Jupolli, and many others who work for, support, and believe in 'Defy Them.'

Among the many activities that reflect the success of Defy Them is the Music Incubator, a platform designed to support the development of young rock musicians, including students and youth up to the age of 23. The program is open to anyone with basic knowledge of instruments who has started forming a music group. "Mentoring is provided by international professionals such as Philipp Konrad Labhart from the NGO Better Together, as well as by local experts. The program is adapted to the participants' needs and aims to support artistic growth and practical skill development," says Uskana, adding that those interested can apply by contacting info@defythemcommunity.com.

One notable recent initiative from the organization is Prishtina Jazz Catz, a series of jazz concerts that were warmly received by the public, often exceeding the capacity of Prishtina's improvised concert spaces.

"Prishtina Jazz Catz was organized in cooperation with Visar Kuçi and aims to offer jazz concerts in the purest form, appreciated even by the musicians themselves. The public embraced it enthusiastically, often surpassing the venue's capacity. It also gave young musicians the opportunity to perform in jam sessions alongside well-known local and international artists," Uskana explains.

With over 11,000 registered visitors at its events, Defy Them is clearly building an increasingly vibrant community.

"The audience is an essential part of every event and of the performance itself. We always aim to provide a unique and high-quality experience. The growth of the community is evident in the increasing number of bands, events, and participants in Prishtina and other cities. Our challenge is to maintain the connection between artists and audiences while meeting rising expectations," he notes.

According to him, what Defy Them receives from Prishtina and gives back to it is vital.

"Prishtina has given us a rich cultural and musical history, along with the opportunity to operate on a high level. As the capital, it has helped shape us, and we, in return, are contributing to its shaping. Our responsibility is to give back with dedication, especially through the education of young people who will become tomorrow's decision-makers," he concludes.

Një rrugë e re për "Dodonën": vizioni i Arta Muçaj

A New Path for "Dodona": The Vision of Arta Muçaj

ALBERINA **HAXHIJAJ**

Aktorja që ka shkelur në dërrasat e zeza të skenave me nam, tashmë drejton një teatër. Arta Muçaj, tanimë, ditët i kalon në zyrën e saj në Prishtinë. Mbi supe ka detyrën e udhëheqjes së njërit prej institucioneve më të çmuara të artit në Kosovë, teatrit "Dodona".

The actress who has stepped on the blackboards of famous stages, now runs a theater. Arta Muçaj now spends her days in her office in Pristina. She has the task of leading one of the most valuable art institutions in Kosovo, the "Dodona" theater.

I pozicionuar në zemër të Prishtinës, teatri "Dodona" zë një vend të veçantë në kujtesën kulturore të Kosovës.

Për dekada, skena e tij modeste ka jehuar nga zërat e gjeneratave të ndryshme, prej të qeshurave të fëmijëve gjatë shfaqjeve me kukulla, deri te performancat e shfaqjet e guximshme që nxisnin mendim kritik e tek artistët që nisën karrierën në dërrasat e këtij teatri. "Dodona" u themelua më 12 nëntor 1986, e punën e nisi në vitin pasues, saktësisht më 16 maj, me premierën e parë "Pylli është i të gjithëve". Sot, gjersa objekti po i nënshtrohet rinovimit, me disa ndërhyrje emergjente në infrastrukturë, teatri po rindërton edhe të ardhmen e vet artistike nën udhëheqjen e një artisteje me nam në vend, Arta Muçaj.

An actress who once graced the floorboards of distinguished stages now runs a theater. These days, Arta Muçaj spends her time in her office in Prishtina, bearing the responsibility of leading one of Kosova's most treasured cultural institutions: the Dodona Theater.

Situated in the heart of Prishtina, Dodona holds a special place in the cultural memory of Kosova. For decades, its modest stage has echoed with the voices of many generations – from the laughter of children during puppet shows to daring performances that sparked critical thought. Many artists who began their journeys on this stage have gone on to make lasting contributions to the arts.

FOTO: ARTAN KORENICA

Dodona was founded on November 12, 1986, and began operating the following year, on May 16, with its debut performance The Forest Belongs to Everyone. Today, as the building undergoes renovations and urgent infrastructure repairs, the theater is also shaping its artistic future under the guidance of a nationally acclaimed artist, Arta Muçaj.

With more than thirty years of experience across the Balkans, Europe, and Australia, Muçaj now steps into a new role: director of Dodona Theater. But what does it truly mean for an artist whose life has been shaped by the stage to lead such an institution?

To understand the weight of this responsibility, one must first explore the world of Arta Muçaj, to gain a fuller picture of her journey and vision, as it is through the lens of her experiences that she now steers Dodona forward.

Me më shumë se tri dekada karrierë në Ballkan, përgjithësisht Evropë, si dhe Australi, ajo tashmë ka marrë një rol të ri, atë të drejtoreshës së teatrit "Dodona". Por çfarë do të thotë për një artiste, që gjithë jetën e vet e ka kaluar nëpër skenat teatrore, të drejtojë një institucion të tillë? Për të kuptuar vërtet peshën e këtij roli, duhet fillimisht të eksplorojmë botën e Arta Muçajt. Të kemi një pasqyrë me të plotë të udhëtimit dhe të vizionit të saj, pasi, në bazë të përvojave të saj, ajo po udhëheq teatrin në rrugën e duhur.

Karrierë e ndërtuar në teatër e me pasion

Rruga e Arta Muçaj në botën e teatrit zë fill qysh në fëmijëri. Natyrshëm i erdhi përfshirja në botën e artit. Nuk kishte si të ishte ndryshe. E rrethuar nga prindër aktorë e nga një familje e lidhur me botën televizive, ajo nisi të recitonte e të prezantonte nëpër shfaqje teatrale. Nga këto paraqitje të hershme në Radio Televizionin e Prishtinës, shumë shpejt e gjeti veten duke recituar e duke u bërë pjesë e dramave që ishin radiodrama, e më pas duke udhëhequr emisionin e saj që jepej çdo të diel, me mysafirë shkrimtarë, të cilin e drejtonte bashkë me shkrimtarin Hajro Ulqinakun, duke vendosur kështu bazat e një karrierë që do e dërgonte edhe jashtë vendit e nëpër skena teatrale të vogla e të mëdha.

Koha që kaloi në Tiranë, duke studiuar për aktrimin, ishte vendimtare. Pikë kthese në karrierën e saj ishte shfaqja "Vdekja e Dantonit" (1995-1996) e Georg Büchner në Teatrin Kombëtar të Shqipërisë, ku pati rolin e Lucile Duplessis. Ishte akoma në studime por iu dha mundësia të punonte përkrah disa prej aktorëve më të respektuar të vendit, si: Tinka Kurti, Bujar Lako e Ndriçim Xhepa. Pikërisht në këtë rol, ajo e kuptoi thellësinë e artit, nën udhëheqjen e Vladimir Milchinit, një nga regjisorët më të njohur në ish-Jugosllavi. Të pandalshme ishin më pas ftesat për shfaqje në teatrin e Tiranës.

Në moshë të re e mori çmimin e parë si aktorja më e mirë për rol kryesor. Ishte roli i Laurës, te "Babai" (2003) të Aungust Strindberg-ut, nën regjinë e Slobodan Unkovskit, në Teatrin Shqiptar në Shkup që i solli çmimin për aktoren më të mirë në Festivalin Kombëtar të Maqedonisë së Veriut. Me këtë rol, çmimin si aktorja me të mirë e rrëmbeu edhe në "Kosova InFest". Para këtij, kishte fituar çmimin si aktorja më e mirë joprotagoniste për rolin Zonja Bergman te "Zgjimi i pranverës" nga F.Vedeking, nën regji të Zana Hoxhës. Për këtë shfaqje të Teatrit Kombëtar të Kosovës u shpërblye nga Festivali Mbarëkombëtar "Moisiu" në Tiranë. Të gjitha çmimet më pas i mori për aktoren më të mirë në rol kryesor. Nga Festivali Kombëtar i Teatrove - Ferizaj u shpërblye për rolin Radka në shfaqjen "Guximi për vrasje" të Lars Norén, nën regji të Arta Kallabës. Ndërsa në Festivali Kombëtar i Filmit për rolin Bukuria në "Gomarët e kufirit" nën regji të Jeton Ahmetaj.

"Pata fatin të punoj krah regjisorëve të njohur dhe të aktorëve me përvojë, duke performuar në disa nga festivalet më të mëdha të botës", thotë Muçaj.

Arta Muçajn, udhëtimi artistik e çoi nëpër skena prestigjioze, nga Evropa në

A Career Built Passionately on Theater

Arta's journey toward theater began in childhood. She felt a natural inclination to embrace the world of art. Growing up in a family already immersed in television – both of her parents being actors – her earliest steps were in reciting and presenting theatrical shows. From these early appearances on Radio Television of Prishtina, she soon found herself reciting and taking part in radio dramas. Later, she co-hosted a weekly Sunday program alongside writer Hajro Ulqinaku, featuring guest writers. These experiences laid the foundation for a career that would eventually take her abroad, onto both small and large theater stages.

Her time in Tirana, where she studied acting, was formative. A turning point in her career came with the play Danton's Death (1995–1996) by Georg Büchner, staged at the National Theatre of Albania, where she played the role of Lucile. Still a student at the time, she was given the opportunity to perform alongside some of the country's most respected actors, including Tinka Kurti, Bujar Lako, and Ndriçim Xhepa. It was through this role, under the direction of Vladimir Mil in – one of the most renowned directors in the former Yugoslavia – that she first grasped the true depth of theatrical art. From there, invitations to perform in Tirana's theater came steadily.

At a young age, she was awarded Best Actress for a leading role. That recognition came for her portrayal of Laura in The Father (2003) by August Strindberg, directed by Slobodan Unkovski at the Albanian Theatre in Shkup. For this role, she was awarded Best Actress at North Macedonia's National Theater Festival, as well as at Kosova InFest.

Before that, she had received Best Supporting Actress for the role of Mrs. Bergman in Spring Awakening by Frank Wedekind, directed by Zana Hoxha. That production, staged by the National Theatre of Kosovo, was honored at the national Moisiu Festival in Tirana. All the awards that followed celebrated her performances as Best Actress in a

Australi, ku jetoi deri para pesë vjetësh. Edhe aty nuk iu nda teatrit.

Pati mundësi të performonte nëpër projekte të ndryshme teatrale, ndër të cilat veçon "Shekspiri dhe Zonja e errët e Sonatave" me dramaturg Enzo Condello dhe me regjisor Christopher Hosking. Aty pati rolin kryesor atë të Zonjës së Errët, muzës së Shekspirit, Emilia Basano, një rol që ajo e kujton me dashuri dhe e veçon si një nga sukseset e saj. Për t'u veçuar është edhe roli i saj në "Nesër nisemi në parajsë" (viti 2000), nën regji të Dritëro Kasapit e tekst të Teki Dervishit. Në shfaqjen që u shfaq në Stokholm të Suedisë e vende të tjera të botës, luajti krah Yllka Mujos, Ndriçim Xhepës e Bajrush Mjakut. Një vit më vonë, po ashtu, me regji të Dritëro Kasapit, u bë pjesë e prodhimit suedez "Hotel Europa" që pati premierën në Vjenë e u shfaq në festivale të ndryshme evropiane.

Ndër vite, në karrierën e saj zënë vend edhe paraqitjet në filmat, si: "Adnan Kafazi" (2023), "Toka brenda meje" (2022), "Qiej të trazuar" (2020), "Home Sweet Home", seriali "Rrushe" (2021) e shumë të tjerë si dëshmi e talentit të saj, por edhe të lidhjes së fuqishme me aktrimin. Kontributi i saj në teatër nuk qëndron te fama, por te dedikimi dhe autenticiteti që ka sjellë me çdo karakter që ka luajtur.

Teatri si proces shpirtëror: ringjallja e identitetit dhe e vlerave

Kur Arta Muçaj flet për teatrin, ajo nuk flet vetëm për role dhe skripta. Ajo flet për frymën. Për prezencën. Për të vërtetën.

"Skena është e shenjtë, aty je në një frymë me publikun dhe aty ndodh magjia e vërtetë", thotë ajo.

E trajnuar për teatër me sistemin e Stanislavski, me pjesë të Chekhovit e Shekspirit, ajo nuk e shikon aktrimin si një performancë, por si një transformim personal e kolektiv. Duke u mishëruar me karaktere të ndryshme, thotë se është bërë personi që është sot dhe është rritur si artiste. Në shtator, ajo mori nën udhëheqje "Dodonën", siç potencon ajo: "Me shumë kënaqësi dhe përkushtim".

E di se ka shumë punë. I thekson ndryshimet e vazhdueshme në skenën

leading role. From the National Theater Festival in Ferizaj, she was honored for her portrayal of Radka in Courage to Kill by Lars Norén, directed by Arta Kallaba. She also received the Best Actress award at the National Film Festival for her role as Bukuria in The Border Donkeys, directed by Jeton Ahmetaj.

"I had the fortune to work alongside well-known directors and seasoned actors, performing in some of the world's major theater festivals," says Muçaj.

Her artistic journey brought her to prestigious stages across Europe and Australia, where she lived until five years ago. Even there, she remained close to theater, performing in various projects – most notably Shakespeare and the Dark Lady of the Sonnets, a play written by Enzo Condello and directed by Christopher Hosking. She played the lead role of the Dark Lady –Shakespeare's muse – portraying Emilia Bassano, a role she recalls with deep fondness and considers one of her most cherished.

Another remarkable role was in Tomorrow We Leave for Paradise (2000), directed by Dritëro Kasapi and written by Teki Dervishi. This play, which was performed in Stockholm and other parts of the world, featured her alongside Yllka Mujo, Ndriçim Xhepa, and Bajrush Mjaku. One year later, again under Kasapi's direction, she joined the Swedish production Hotel Europa, which premiered in Vienna and was shown in several European festivals.

Over the years, her career has also included appearances in films such as Adnan Kafazi (2023), The Earth Inside Me (2022), Restless Skies (2020), Home Sweet Home, and the series Rrushe (2021), among many others. These works not only reflect her talent but also her unwavering connection to the art of acting.

Muçaj's contribution to theater is not about fame, but about the dedication and authenticity she brings to every role she plays.

Theater as a Spiritual Process: Reviving Identity and Values

When Arta Muçaj speaks of theater, she speaks beyond roles and scripts. She speaks of spirit, of presence, of truth.

"The stage is sacred. It is where you breathe in sync with the audience, and where true magic happens," she says.

Trained in theater through the Stanislavski system, performing pieces by Chekhov and Shakespeare, she doesn't see acting as mere performance. For her, it is a personal and collective transformation. By endorsing different characters, she says, she has become who she is today and grown as an artist.

In September, she took over the leadership of Dodona, as she puts it, "with great joy and dedication."

She knows there is much work to do. She acknowledges the constant changes in the cultural landscape and

"Dodona" mbetet zemra e vogël e një kulture të madhe.
Dodona remains the small heart of a great culture.

kulturore, dhe nuk e fsheh se idealizmi i viteve 2000 – kur ajo u rikthye, pas luftës, në Prishtinë nga Tirana, dhe u bë pjesë e atyre që energjinë e tyre e drejtuan kah rindërtimi i skenës artistike – është zbehur nën peshën e pasigurisë, neglizhencës institucionale dhe vështirësive ekonomike.

"E kujtoj që kishim shumë pasion, ishim të palodhshëm, kishte dashuri për njëri-tjetrin e respekti ishte më i madh. Teatri ishte shtëpia, familja jonë e dytë", thotë ajo. Pra, e ka fjalën për kohën kur ishte pjesë e Teatrit Kombëtar të Kosovës, gjatë viteve 1999-2010. Por sot, e pranon, se shpesh e gjen veten duke menduar: "Çfarë po bëj këtu?".

Megjithatë, Arta Muçaj nuk është person që heq dorë lehtë. Në të, teatri gjen edhe një luftarake, edhe një ëndërrimtare. Prandaj, vizioni i saj për "Dodonën" është i guximshëm, gjithëpërfshirës dhe i rrënjosur në bindjen se arti duhet ta pasqyrojë të tashmen dhe ta tejkalojë atë.

"Teatri "Dodona", më shumë se kurrë në histori, ka nevojë të vishet me petkun e teatrit të vërtetë përmbajtjesor, me identitetin fillestar, të shndërrohet në udhërrëfyes të artit teatror në shoqërinë kosovare", thotë ajo. Sipas saj, tani është koha të merret rruga e re: "e ringjalljes shpirtërore, para së gjithash".

Ajo synon një teatër që i hap dyert e tij drejt regjionit dhe Evropës, si dhe që është krahas tyre, që guxon të sjellë një repertor jokonvencional dhe që është shtëpia e një trupe teatrale që krijohet në bazë të talentit dhe diversitetit në moshë, gjini dhe karaktere.

"Trupa e teatrit "Dodona" duhet të kompozohet nga personalitete kreative, të cilat do të krijojnë identitetin estetik të teatrit", insiston ajo.

Megjithatë, sfidat janë të shumta. Ndonëse gjendet mes tyre, gjithsesi misioni i saj është i qartë:

"Teatri duhet të vishet me përmbajtje esenciale, me vlerë. Duhet t`i krijojë identitetin dhe estetikën e vet. Teatri duhet të hapet karshi botës dhe të jetë konkurrent në arenën e madhe ku maten vlerat", thotë ajo.

Së bashku me ekipin artistik dhe Këshillin Drejtues, ajo planifikon ta strukturojë çdo sezon rreth tri segmenteve tematike - secili prej tyre në rezonancë me pulsin social dhe politik të kohës. Qëllimi i saj nuk është vetëm argëtimi. Teksa ka marrë drejtimin e teatrit "Dodona", Arta Muçaj nuk vjen vetëm me një CV të pasur profesionale, por ka sjellë me vete një respekt të thellë për artin, një qëllim dhe një ëndërr për "Dodonën" - të rifitojë vendin e vet si një hapësirë me rëndësi për reflektim kulturor.

doesn't hide the fact that the idealism of the early 2000s, when she returned to Prishtina from Tirana after the war and became part of the effort to rebuild the artistic scene, has faded under the weight of uncertainty, institutional neglect, and economic hardship.

"I remember we had so much passion. We were tireless. The love for one another and the respect were greater. Theater was our home, our second family," she recalls. She is referring to the years she spent with the National Theatre of Kosova, from 1999 to 2010. But today, she admits, she often finds herself wondering, "What am I doing here?" Still, Arta Muçaj is not someone who gives up easily. Within her, theater finds both a fighter and a dreamer. That is why her vision for Dodona is bold, inclusive, and rooted in the conviction that art must reflect the present and also reach beyond it.

"Now more than ever, Dodona needs to be clothed in the essence of true, meaningful theater. It must return to its original identity and become a guiding light for theatrical art in Kosovar society," she says. In her view, the time has come to take a new path, first and foremost, a spiritual revival.

Her aim is for Dodon
a to open its doors toward Europe and the region and stand alongside its counterparts. She envisions a theater that dares to offer an unconventional repertoire and becomes home to a company built on talent and diversity in age, gender, and character. "The Dodona ensemble must be composed of creative individuals who will shape the theater's aesthetic identity," she insists.

The challenges remain present. But in the midst of them, her mission is clear.

"Theater must be filled with essential meaning, with value. It must build its own identity and aesthetic. Theater must open up to the world and be competitive in the greater arena where values are measured," she states.

Together with her artistic team and the Board of Directors, she plans to structure each season around three thematic segments, each in tune with the social and political pulse of the time.

Her goal is not merely entertainment. As she takes on the leadership of Dodona, Arta Muçaj brings not only a rich professional background but also a deep respect for art, a clear purpose, and a dream: for Dodona to reclaim its place as a vital space for cultural reflection.

Prishtina bëhet një me artin e Armendit

Më 19 korrik 2025, Prishtina përjetoi një nga netët më emocionuese. Në një rikthim të shumëpritur, Armend Rexhepagiqi u ngjit në skenë për të na dhuruar një koncert që nuk ishte thjesht ngjarje muzikore, por përjetim i thellë shpirtëror dhe bashkim i rrallë mes njerëzve, kujtesës dhe shpresës.

Prishtina u bë një zë i vetëm me këngët e tij. Kjo mbrëmje ishte rikujtim, por edhe shenjë e gjallë e forcës që muzika ka për të mbledhur njerëzit rreth vlerave që e bëjnë një shoqëri më të mirë.

Armend Rexhepagiqi nuk është thjesht një kantautor. Ai është zë që duke mos bërë kompromis me vlerat artistike, i ka qëndruar të gjitha kohëve, e ka mbledhur rreth vetes shijet muzikore të të gjitha moshave. Ai na jep dëshminë më të fortë se kur arti buron nga thellësia e shpirtit ka fuqinë të tejkalojë dallime dhe të krijojë një ndjesi kolektive që rrallë përjetohet në jetën publike.

Prishtina rrahu me një zemër të vetme, e frymëzuar nga muzika e Armendit.

Prishtina Becomes One with Armend's Art

On July 19, 2025, Prishtina experienced one of its most emotionally charged nights. In a long-awaited return, Armend Rexhepagiqi once again took the stage to give us a concert that was far more than just a musical event – it was a deeply felt spiritual experience and a rare unification of people, memory, and hope. Prishtina became a single voice through his songs. That event was both a remembrance and a living testament to the power of music to bring people together around the values that make a society better. Armend Rexhepagiqi is not merely a singer-songwriter.

> **He is a voice that refuses to compromise artistic integrity, one that has endured through the years and brought together the musical tastes of all generations.**

He offers us the clearest proof that when art springs from the depths of the soul, it holds the power to overcome differences and create a collective feeling rarely experienced in public life. On that night, Prishtina beat with a single heart, inspired by Armend's music.

Kultura në fokus

Baleti Kombëtar i Kosovës në Berlin me "Rebounds: A BasketBallet"

Baleti Kombëtar i Kosovës e nisi vitin 2025 me një performancë të suksesshme në Berlin, duke prezantuar shfaqjen "Rebounds: A BasketBallet" në teatrin historik "HAU – Hebbel am Ufer". Shfaqja me koreografi të Friederike Lampert dhe Jochen Roller, u prit me entuziazëm nga publiku gjerman. Ndërkaq në prill, trupa e Baletit Kombëtar të Kosovës, u rikthye në New-York në prill. Dha shfaqjen "Tango Nights" me koreografi të Chiara Ajkun, bashkëprodhim me "Ajkun Ballet Theatre". Shfaqja fillimisht u dha premierë pikërisht në New-York në qershor të vitit të kaluar. Në fillimshtator u pat dhënë edhe në Prishtinë, në Amfiteatrin e Pallatit të Rinisë dhe Sporteve. ndërkombëtare.

"Mua besoj më shpëtoi portreti" me premierë në Berlinale

Regjisori Alban Muja prezantoi në Berlinale filmin e tij të shkurtër "Mua besoj më shpëtoi portreti", i cili rrëfen historinë e babait të tij, piktorit Skënder Muja, i cili gjatë luftës në Kosovë u detyrua të pikturonte portretin e një komandanti serb për të shpëtuar jetën. Filmi ishte pjesë e programit "Forum Expanded" të festivalit. Filmi do të shfaqej në maj edhe në "Vienna Shorts" dhe në Festivalin e Filmit të Shkurtër në Hamburg, si dhe në festivalin ndërkombëtar të filmave të shkurtër "Go Short", në Holandë.

Culture in Focus

The National Ballet of Kosova in Berlin with "Rebounds: A BasketBallet"

The National Ballet of Kosova began 2025 with a successful performance in Berlin, presenting the show Rebounds: A BasketBallet at the historic HAU – Hebbel am Ufer theater. The performance, choreographed by Friederike Lampert and Jochen Roller, was warmly received by the German audience. In April, the company returned to New York to perform Tango Nights, choreographed by Chiara Ajkun and co-produced with the Ajkun Ballet Theatre. The show had its premiere in New York in June of the previous year, and was also staged in Pristina at the Amphitheater of the Palace of Youth and Sports in early September.

'I Believe My Portrait Was Spared' Premieres at Berlinale

Director Alban Muja presented his short film I Believe My Portrait Was Spared' at the Berlinale, telling the story of his father, the painter Skënder Muja, who during the Kosova war was forced to paint a portrait of a Serbian commander in order to save his life. The film was part of the festival's 'Forum Expanded' program and is set to be screened in May at Vienna Shorts, the Hamburg Short Film Festival, and the international short film festival 'Go Short' in the Netherlands. for the 25 anniversary of Kosova's liberation. After successful performances in New York and Paris, the troupe is set to perform in Lisbon, Portugal, on July 27 at the Cine Teatro D. João V in Amadora. In September, The National Ballet of Kosova will partake in the Cheonan World Dance Festival in South Korea, continuing its tradition of international performances.

“Një fije shprese, një fije shkrepëse” tani edhe në rumanisht

Romani i shkrimtarit Ag Apolloni, që trajton fatin tragjik të dy nënave shqiptare gjatë luftës në Kosovë, është përkthyer në gjuhën rumune nga Marius Dobrescu. Vepra, e cila më parë është botuar në disa gjuhë të tjera, vazhdon të zgjojë interes ndërkombëtar përmes tematikës së saj të dhimbshme dhe universale.

Katër filma të nominuar për Oscar kaluan nëpër DokuFest

Festivali ndërkombëtar i filmit dokumentar dhe të shkurtër “DokuFest” në edicionin e tij të kaluar ka shfaqur katër filma që sivjet ishin pjesë “Oscar-it”. Përfshirja e titujve si “No Other Land”, “Soundtrack to a Coup D'etat”, “Sugarcane” dhe “Incident”, dëshmoi edhe një herë rëndësinë e festivalit në promovimin e kinemasë cilësore.

Kosova kumbon në Paris me ekspozitë

Veprat e 15 artistëve ishin pjesë e ekspozitës “Fijet e heshtuna, Kosova kumbon” në galerinë “Continua” në Paris. Me kurator Sislej Xhafën, ekspozita bashkoi jehonën e krijuesve të shtetit më të ri në Evropë. Ekspozita u hap më 24 janar dhe u mbyll më 19 mars.

Dy filma nga Kosova pjesë e “Tampere Film Festival” në Finlandë

Filmat e shkurtër “Pesë stinët e fëmijërisë sime” nga Besim Ugzmajli dhe “Rrugës” nga Samir Karahoda ishin pjesë e “Tampere Film Festival” në Finlandë, një nga festivalet më të rëndësishme për filmin e shkurtër në Evropë. Të dy filmat trajtojnë tema personale dhe janë të bazuar në përvojat e vetë autorëve. Edicioni i 55-të i festivalit u mbajt nga data 5 deri më 9 mars.

‘A Thread of Hope, a Matchstick of Light’ Now in Romanian

The novel by writer Ag Apolloni, which portrays the tragic fate of two Albanian mothers during the Kosova war, has been translated into Romanian by Marius Dobrescu. The work, which has already been published in several other languages, continues to attract international attention for its painful yet universal themes.

Four Oscar-Nominated Films Previously Featured at DokuFest

The international documentary and short film festival DokuFest, in its last edition, screened four films that were later nominated for an Oscar. Titles such as No Other Land, Soundtrack to a Coup D’état, Sugarcane, and Incident underscore the festival’s growing importance in showcasing high-quality cinema.

Kosova Resounds in Paris with an Exhibition

Works by 15 artists were featured in the exhibition ‘Silent Threads, Kosova Resounds’ at the Continua Gallery in Paris. Curated by Sislej Xhafa, the show brought together the voices of creators from Europe’s youngest state. The exhibition opened on January 24 and closed on March 19.

Two Kosovar Films Featured at Finnish Festival

The short films The Five Seasons of My Childhood by Besim Ugzmajli and On the Road by Samir Karahoda were part of the Tampere Film Festival in Finland, one of Europe’s most prestigious short film festivals. Both films explore personal themes and are based on the directors’ own experiences. The 55th edition of the festival was held from March 5 to 9.

“Libërthi i dashurisë” përkthehet në bullgarisht

Libri “Libërthi i dashurisë” i autorit Shpëtim Selmani është përkthyer në gjuhën bullgare dhe është botuar nga shtëpia botuese “Perseus” në Sofje. Libri përmban tregime të shkurtra që pasqyrojnë jetën në Kosovën e pasluftës.

Petrit Halilaj në Paris si krijues i hapësirave për liri

Artisti kosovar Petrit Halilaj gjatë muajit shkurt ishte pjesë e rezidencës njëmujore në Operën e Parisit. Në kuadër të saj krijoi vepër të frymëzuar nga përvoja e tij dhe atmosfera unike e Pallatit Garnier. Kjo iniciativë është pjesë e programit “Projekti 12”, që synon të lidhë të kaluarën me të tashmen përmes artit bashkëkohor. E në mars, Halilaj prezantoi veprat e tij në një ekspozitë në Paris, ku ato u vendosën në dialog me veprat e skulptorit të njohur Alberto Giacometti. Ekspozita theksoi ngjashmëritë dhe dallimet mes dy artistëve, duke ofruar një perspektivë të re mbi krijimtarinë e tyre dhe duke nxitur diskutime mbi identitetin dhe përvojën njerëzore. Ekspozita ishte e hapur deri në fillim të qershorit.

“Krahët e punëtorëve” në festivalin prestigjioz gjerman

“Krahët e punëtorëve” me skenar dhe regji të Ilir Hasanajt, ishte pjesë e edicionit të 37-të të Festivalit të Filmit në Dresden. Dokumentari ka për protagonistë personazhe që kanë të kaluar të dhimbshme në vendet e tyre të punës. Në film ata tregojnë se kanë punuar shumë lloje punësh për mbijetesë. Plagët e tyre janë ende të hapura.

Norvegjia mirëpriti “The Handke Project”

Në mars, në qytetin Frederikstad të Norvegjisë u dha premiera e dramës “The Handke Project”, me tekst të Jeton Nezirajt dhe regji të Blerta Nezirajt. Shfaqja, që u dha më 15, 16 dhe 17 mars në Akademinë e Teatrit Norvegjez, goditi nobelistin austriak Peter Handke – mik i Sllobodan Millosheviqit dhe mohues i gjenocidit në Kosovë. Përveç temës qendrore, ajo i është referuar edhe krizës së kulturës në Norvegji, për shkak të buxhetit të zvogëluar për artin dhe teatrin.

“Breaking Borders” lidh kinematografinë e Kosovës me atë të Britanisë

Projekti “Breaking Borders”, një bashkëpunim mes



“DokuFest” dhe Institutit Skocez të Dokumentarit, bashkoi katër filmbërës nga Kosova dhe katër nga Britania e Madhe për të krijuar katër filma të shkurtër. Rezidenca artistike me kinematografë të rinj u mbajt në Prizren nga 21 prill deri më 9 maj, ndërsa filmat e realizuar do të kenë premierën në edicionin e sivjetmë të “DokuFest”-it që mbahet nga 1 deri më 9 gusht.

“The River” ndez ekranet e kinemave në Athinë

Filmi “The River”, një bashkëprodhim midis Kosovës dhe Greqisë, u shfaq në kinematë e Athinës, duke sjellë një histori që eksploron marrëdhëniet njerëzore dhe sfidat e jetës. Filmi u prit pozitivisht nga publiku dhe kritika, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e kinematografisë. Në këtë projekt nën regji të Haris Raftogiannisit, aktore në rol kryesor është Ilire Vinca e bashkëproducent është Eshref Durmishi.

The Booklet of Love" Now in Bulgarian

The book The Booklet of Love by author Shpëtim Selmani has been translated into Bulgarian and published by the 'Perseus' publishing house in Sofia. The book contains short stories that reflect life in postwar Kosova.

Petrit Halilaj in Paris as a Creator of Spaces for Freedom

Kosovar artist Petrit Halilaj spent February in a one-month residency at the Paris Opera. During his stay, he created a piece inspired by his personal experience and the unique atmosphere of the Palais Garnier. This initiative is part of the 'Project 12' program, which seeks to bridge past and present through contemporary art. In March, Halilaj also presented his works in an exhibition in Paris, placing them in dialogue with those of renowned sculptor Alberto Giacometti. The show highlighted both similarities and contrasts between the two artists, offering a fresh perspective on their practices and sparking discussions on identity and the human condition. The exhibition remained open through early June.

'The Workers' Wings' at Prestigious German Festival

The Workers' Wings, written and directed by Ilir Hasanaj, was part of the 37th edition of the Dresden Film Festival. The documentary focuses on individuals who have endured hardship in their workplaces. In the film, they recount doing all kinds of jobs to survive. Their wounds are still raw.

Norway Welcomes 'The Handke Project'

In March, the premiere of the play The Handke Project, written by Jeton Neziraj and directed by Blerta Neziraj, was held in the city of Fredrikstad, Norway. The play, staged on March 15, 16, and 17 at the Norwegian Theatre Academy, takes aim at Austrian Nobel laureate Peter Handke, a known friend of Slobodan Miloševi and a denier of the genocide in Kosova. Beyond its central theme, the play also touched on the cultural crisis in Norway, driven by a shrinking budget for the arts and theatre.

'Breaking Borders' Links Kosovar and British Cinema

The Breaking Borders project, a collaboration between DokuFest and the Scottish Documentary Institute, brought together four filmmakers from Kosova and four from the United Kingdom to create four short films. The artistic residency for these young filmmakers was held in Prizren from April 21 to May 9. The resulting films will premiere at this year's edition of DokuFest, scheduled for August 1–9.

'The River' Lights Up Screens in Athens

The film The River, a co-production between Kosova and Greece, was screened in Athens cinemas, telling a story that explores human relationships and life's challenges. It was well received by both audiences and critics, who praised the importance of international collaboration in cinema. Directed by Haris Raftogiannis, the film stars Ilire Vinca and was co-produced by Eshref Durmishi.

Flaka Goranci debuton në Spanjë me "La Femme"

Mezzosopranoja Flaka Goranci debutoi në Spanjë me programin "La Femme", një udhëtim muzikor që nderon veprat e kompozitoreve gra. Pas performancave në Vjenë, Luksemburg dhe Tiranë, ajo prezantoi këtë program në qytetet Alicante dhe Valencia më 9 mars, duke interpretuar me ansamblin "Casa Mediterráneo".

Flaka Goranci Debuts in Spain with 'La Femme'

Mezzo-soprano Flaka Goranci made her debut in Spain with the program La Femme, a musical journey honoring the works of women composers. Following performances in Vienna, Luxembourg, and Tirana, she brought the program to Alicante and Valencia on March 9, performing with the 'Casa Mediterráneo' ensemble.

Driton Selmani me "Only Time Will Tell" në Vjenë

Artisti kosovar Driton Selmani prezantoi instalacionin "Only Time Will Tell" në oborrin kryesor të qendrës kulturore "MuseumsQuartier" në Vjenë, i cili ishte i hapur deri më 21 prill. Vepra shqyrton idenë se koha ekziston vetëm përmes perceptimit të mendjes njerëzore. Sipas Selmanit çdo moment është thjesht një fragment – i vërtetë vetëm derisa të kalojë, ndërsa e ardhmja ekziston vetëm në pritje.

Filharmonia me prezantim në Zvicër e Bullgari

Filharmonia e Kosovës në këtë sezon pati disa paraqitje jashtë vendi. E nisi vitin në mars me koncertin në Bernë, Zvicër, duke prezantuar një program të pasur muzikor që përfshinte vepra të kompozitorëve të njohur vendas e ndërkombëtarë. Performanca u prit me entuziazëm nga publiku zviceran, duke dëshmuar nivelin e lartë artistik të orkestrës dhe duke forcuar lidhjet kulturore mes Kosovës dhe Zvicrës. Të gjata ishin duartrokitjet edhe për "Bareshën" e Rexho Mulliqit. E më 17 maj, ka interpretuar për herë të parë në Sofje. Me repertorin e njëjtë si në Bernë, u paraqit në kompleksin koncertal "Bulgaria" nën dirigjimin e bullgarit Nayden Todorov, me soliste sopranon Besa Llugiqi dhe saksofonistin Vitaly Vitulya. Pjesë e programit ishin vepra që shfaqin traditën muzikore të Kosovës, por edhe të tilla ndërkombëtare të njohura tashmë në botën e muzikës klasike.

Visar Mulliqi ekspozon në Paris

Piktori Visar Mulliqi prezantoi ekspozitën e tij "Përtej ngjyrave" në "Babel Galerie". Bëhet fjalë për gjithsej 12 vepra, tetë prej tyre janë të reja dhe siç ka bërë të ditur autori i tyre, Visar Mulliqi, janë vepra të krijuara si vazhdimësi e cikleve të ndryshme të punimeve të tij. Ekspozita ishte e hapur prej 21 marsit deri më 4 prill.

Driton Selmani's 'Only Time Will Tell" in Vienna'

Kosovar artist Driton Selmani presented his installation Only Time Will Tell in the main courtyard of the MuseumsQuartier cultural complex in Vienna, where it remained on display until April 21. The work explores the idea that time exists only through human perception. According to Selmani, every moment is merely a fragment – real only until it passes, while the future exists only in waiting.

Kosova Philharmonic Performs in Switzerland and Bulgaria

This season, the Kosova Philharmonic gave several international performances. It opened the year in March with a concert in Bern, Switzerland, presenting a rich musical program that included works by well-known local and international composers. The Swiss audience received the concert enthusiastically, affirming the orchestra's high artistic caliber and strengthening cultural ties between Kosova and Switzerland. The piece 'Bareshë' by Rexho Mulliqi was met with long applause. On May 17, the Philharmonic performed for the first time in Sofia, Bulgaria, presenting the same program at the Bulgaria Concert Complex, conducted by Bulgarian maestro Nayden Todorov, with soprano Besa Llugiqi and saxophonist Vitaly Vitulya as soloists. The repertoire included pieces reflecting Kosova's musical heritage as well as internationally renowned works from the classical tradition.

Visar Mulliqi Exhibits in Paris

Painter Visar Mulliqi presented his exhibition Beyond Colors at the Babel Galerie in Paris. The show featured twelve works, eight of which were new. According to Mulliqi, the paintings continue themes from various earlier cycles of his work. The exhibition ran from March 21 to April 4.

“Shkodra Elektronike” shndrit në “Eurovizion”

Shqipëria me “Zjerm” të Shkodrës Elektronike mori 218 pikë dhe doli e teta. Votat në shumicë i mori nga publiku pasi pas votimit të jurisë ishte e 16-ta. Mirëpo me këngën që flet për një botë ideale, dyshja e “Shkodrës Elektronike” – Beatriçe Gjergji dhe Kolë Laca i dhanë zjarr skenës së “Eurovisionit”, dhe morën zemrat e miliona adhuruesve të muzikës. Austria me “Wasted Love” të JJ fitoi edicionin e 69-të të “Eurovisionit”. Ai mori 436 pikë nga juritë dhe nga publiku.

“Gipsy Kings” me performancë unike në Prishtinë

I larmishëm ka qenë publiku në koncertin e bendit të njohur “Gipsy King”. Bashkimi i gjeneratave të ndryshme nuk është aspak i lehtë. Por për ta duket diçka e zakonshme. Tri gjenerata e përbëjnë edhe vetë grupin. Bendi që është në prag të 5 dekadave të ekzistencës, ka ndërruar shumë anëtarë, por e ka ruajtur frymën origjinale. Këngët që njihen botërisht ndezin publikun pothuajse njëjtë sikurse kur ishin në krye të toplistave. Kështu ndodhi edhe në Prishtinë me koncertin që mblodhi rreth 2 mijë e 500 veta në sallën AMC.

Driton Selmanaj me “From here to anywhere” me thirrje për reflektim

Në Ditën e Evropës, te Parku i Shkallëve të Arbërisë, është promovuar instalacioni “From here to anywhere” i artistit të njohur Driton Selmani. Ai ka thënë se skulptura fton qytetarët për reflektim dhe lojë, duke e kthyer lëvizjen në një akt simbolik të bashkimit përtej dallimeve dhe diversitetin si lojë. “E vendosur në një mjedis urban, vepra bëhet pjesë e jetës së përditshme – duke i dhënë hapësirës publike si dritë, ashtu edhe thellësi”, ka theksuar Selmani.

“Princesha e jazz-it", Aziza Mustafa - Zadeh performon në Prishtinë

Këngëtarja dhe pianistja nga Azerbajxhani, Aziza Mustafa - Zadeh për herë të parë performoi në Prishtinë. Erdhi në kuadër të Ditëve Ndërkombëtare të Jazz-it në Mitrovicë, por koncertin e mbajti në Prishtinë në Amfiteatrin e Ri të Bibliotekës Universitare. Ajo njihet në mbarë botën si Princesha e jazz-it. Me muzikën e saj kapërcen kufijtë, e me një stil të jashtëzakonshëm duke ndërthur thellësinë shpirtërore të “mugamit” (v.j. formë e artit) azerbajxhan, lirisë së improvizimit që ofron xhazi, dhe muzikës klasike perëndimore, ajo dha një performancë krejtësisht të veçantë.

“Prishtina në vitet `90” dokumentuar nga artisti Afrim Hajrullahu

Brenda hapësirës së Komunën së Prishtinës është hapur ekspozita “Kronikë nga Prishtina e viteve 1990” e artistit Afrim Hajrullahu. Kështu, gjersa qytetarët presin për shërbime komunale mund të shijojnë edhe artin e kronistit të jetës së përditshme. Fotografitë pasqyrojnë përditshmërinë në kryeqytet që nga viti 1986 e deri në fund të viteve ’90. Fotografitë sjellin edhe pamje nga shumë pjesë të kryeqytetit që tashmë kanë pësuar transformime rrënjësore.

‘Shkodra Elektronike’ Lights Up Eurovision

With their song Zjerm (“Fire”), Albania’s Shkodra Elektronike placed eighth at Eurovision, earning 218 points. Most of the points came from the public, as the jury placed them sixteenth. However, with a song envisioning an ideal world, the duo – Beatriçe Gjergji and Kolë Laca – ignited the Eurovision stage and won the hearts of millions. Austria won the 69th Eurovision edition with Wasted Love by JJ, which garnered 436 combined points from the jury and public.

‘Gipsy Kings’ Deliver a Unique Performance in Prishtina

The audience at the concert of the renowned band Gipsy Kings was remarkably diverse. Uniting different generations is never easy – but for them, it seems to be a second nature. The group itself spans three generations. Nearing five decades of existence, the band has gone through many lineup changes, yet has preserved its original spirit. Their globally known songs still ignite audiences almost the same way they did when topping the charts. The same happened in Prishtina, where around 2,500 people gathered at the AMC hall for the concert.

Driton Selmani’s From here to anywhere: A Call for Reflection

On Europe Day, at the Arbëria Staircase Park, the installation From here to anywhere by renowned artist Driton Selmani was unveiled. Selmani stated that the sculpture invites citizens to reflect and play – turning movement into a symbolic act of unity across differences, and diversity into a game. “Placed in an urban setting, the work becomes part of everyday life, giving public space both light and depth,” Selmani emphasized.

‘The Princess of Jazz’, Aziza Mustafa Zadeh Performs in Prishtina

Azerbaijani singer and pianist Aziza Mustafa Zadeh performed for the first time in Prishtina. Although invited as part of the International Jazz Days in Mitrovica, she held her concert in the New Amphitheater of the National Library in Prishtina. She is widely known as the “Princess of Jazz.” Her music transcends borders, and with an extraordinary style – merging the spiritual depth of Azerbaijani mugham (a traditional art form), the freedom of jazz improvisation, and Western classical music, she delivered a truly unique performance.

‘Prishtina in the 1990s’ Documented by Artist Afrim Hajrullahu

Inside the Prishtina Municipality building, the exhibition Chronicle of Prishtina in the 1990s by artist Afrim Hajrullahu has opened. While waiting for municipal services, citizens can now also enjoy the artwork of a chronicler of everyday life. The photographs capture daily life in the capital from 1986 to the late 1990s. They also depict many parts of the city that have since undergone drastic transformation.

“Krejt e thirrin Rexhën” triumfon në Bari

“Krejt e thirrin Rexhën” me regji të Ibër Deari fitoi çmimin “Franco Cassano” për Filmin më të Mirë në kategorinë “Meridiana” në festivalin “Bif&st” në Bari të Italisë. “Për prerjen inteligjente, ashpërsinë e regjisë, kompleksin e aktorëve dhe për skenarin delikat dhe ironik që tregon me mjeshtëri një histori rezistence dhe shprese”, ishte vlerësimi i jurisë. Edicioni i 16-të i Festivalit u mbajt më 22-29 mars.

Marigona Qerkezi debuton si Norma në Operën e Frankfurtit

Sopranoja kosovare Marigona Qerkezi debutoi në Operën Shtetërore të Frankfurtit. Pati rolin e Normës në operën e Vincenzo Bellinit. Ky interpretim erdhi pas suksesit në “Palm Beach Opera” në Florida, pikërisht me rolin e Normës. Qerkezi pati gjithsej nëntë paraqitje në Frankfurt gjatë prillit dhe majit.

‘They All Call Him Rexha’ Triumphs in Bari

The film ‘They All Call Him Rexha’, directed by Ibër Deari, won the Franco Cas-sano award for Best Film in the Meridiana category at the Bif&st Festival in Ba-ri, Italy. “For the sharp editing, intense direction, the complexity of its charac-ters, and a delicate yet ironic screenplay that skillfully narrates a story of re-sistance and hope,” read the jury’s appraisal. The 16th edition of the festival was held from March 22 to 29.

Marigona Qerkezi Debuts as Norma in Frankfurt Opera

Kosovar soprano Marigona Qerkezi made her debut at the Frankfurt State Opera in the title role of Vincenzo Bellini’s Norma. This performance followed her earlier success in the same role at Palm Beach Opera in Florida. Qerkezi appeared in nine performances in Frankfurt during April and May.

Sopranoja Besa Llugiqi kthehet në Poloni me operën “Thaïs”

Besa Llugiqi është kthyer në brigjet e Baltikut me kryerolin e operës “Thaïs” të francezit Jules Massenet. Këtë vepër në Operën Baltike të Gdanskit në Poloni, produksioni tradicional i shtëpisë operistike e vuri në skenë dy herë gjatë prillit. Llugiqi në këtë skenë me po të njëjtin produksion pati debutuar në vitin 2019.

Besa Llugiqi Returns to Poland in ‘Thaïs’

Soprano Besa Llugiqi returned to the shores of the Baltic, starring in the title role of Jules Massenet’s Thaïs at the Baltic Opera in Gdansk, Poland. The opera house staged this traditional production twice during April. Llugiqi had first debuted in this same production in 2019 on the same stage.

“Siparantumi” rikthehet në Berlin, e pret edhe Tajlanda

Për të pestën herë kori “Siparantum” u ngjit në skenën e Filharmonisë së Berlinit. Ishte pjesë e festivalit “Walking in Beauty”, të organizuar nga “Choral Space”. Paraqitja ishe një bashkëpunim i veçantë me kompozitorin e pianistin Ola Gjeilo. Por janë edhe disa vende të tjera që e presin, së paku katër, deri fund të këtij viti. Mes tyre është Greqia, Danimarka madje edhe Tajlanda, për ta përmbyllur me një “tjetër vend pak më të largët” siç ka bërë të ditur kori nga Peja, pa e zbuluar lokacionin e fundit.

Tri festivale të Kosovës anëtare në Asociacionin e Festivaleve Evropiane

Festivali ndërkombëtar i filmit dokumentar “DokuFest”, festivali i animacionit “Anibar” dhe festivali i muzikës klasike “ReMusica” janë pranuar si anëtare të Asociacionit të Festivaleve Evropiane (EFA). Me këtë anëtarësim festivaleve u hapen dyer për bashkëpunime e shkëmbime artistike në organizatën prestigjioze në kontinent e më gjerë.

“Negotiating Peace” vazhdon rrugëtimin nëpër Evropë

Produksioni i qendrës “Mutimedia”, “Negotiating Peace”, (Të negociosh paqen) më 8 dhe 9 maj u dha në Firence. Teatri i Pergolas ishte nikoqiri i shfaqjes, që është një bashkëprodhim teatror ndërkombëtar me artistë dhe grupe teatrore nga shtete të ndryshme. Pos në Firence, në qershor, shfaqja do te shfaqet edhe në Milano.

Kosova në Venecia me “Lulebora nuk çel më...”

“Lulebora nuk çel më. Asamble në shpërfaqje” është tema e Pavionit të Kosovës në Bienalen Ndërkombëtare të Arkitekturës në Venecie. Projekti flet për lidhjen me tokën dhe ndryshimet klimatike. Në qendër është pikërisht shuarja e një luleje shkaku i ndryshimeve klimatike në Kosovë. Pavijoni i Kosovës, i përfaqësuar nga arkitektja Erzë Dinarama ka zënë vend në hapësirën ekspozuese Arsenale. Ky është edicioni i 19-të me radhë i Bienales së Arkitekturës dhe përfundon më 27 nëntor.

Karahoda e çon sërish Kosovën në Cannes

Pas sukseseve me filmat “Pa vend” (2021) dhe “Rrugës” (2024), me të cilët u përzgjodh dy herë në konkurrencën zyrtare të filmave të shkurtër në Festivalin e Filmit në Cannes – një arritje që e bën atë një nga regjisorët e paktë në botë me këtë sukses – regjisori Samir Karahoda tashmë nis rrugëtimin e tij të parë në metrazh të gjatë me projektin “Lost Frames”. Ky projekt është përzgjedhur për të marrë pjesë në “Focus COPRO” 2025, në kuadër të Marché du Film në Festivalin e Filmit në Cannes.

Shota dërgoi këngën e vallen shqipe në Gjermani

Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve “Shota” nga Kosova performoi në Gjermani. Prezantoi një program të pasur me këngë dhe valle tradicionale shqiptare. Ishte pjesë e Javës Kulturore nën titullin “Tingujt e Evropës – Muzika bashkon Evropën në Chemnitz” që u mbajt në Chemnitzi në shtetin federal të Saksonisë. Përveç Kosovës prej 7 deri më 9 maj interpretuan edhe përfaqësues të shteteve nga Rumania, Franca, Spanja (Andaluzia), Portugalia, Belgjika, Sllovenia dhe Armenia.

Dua Lipa ndalon në Prishtinë për turneun e saj botëror “Radical Optimism”

Dua Lipa, do të jetë një prej artistëve kryesorë në edicionin e pestë të festivalit “Sunny Hill” në Prishtinë. Në kuadër të turneut të saj botëror “Radical Optimism”, do të ndalet edhe në festivalin e themeluar nga babai i saj, Dukagjin Lipa. Prishtina është qyteti i vetëm i Evropës Juglindore ku Lipa do të performojë në kuadër të turneut të saj.

“Sunny Hill” zbulon emrat e artistëve të këtij edicioni

Festivali “Sunny Hill” ka publikuar emrat e që do të performojnë në edicionin e sivjetmë. Pak ditë pasi u bë e ditur se Dua Lipa do të jetë një nga yjet kryesore, janë konfirmuar edhe emrat e artistëve të tjerë fitues të çmimeve Grammy, MTV dhe Brit Awards. Lipa do të performojë në natën hapëse më 1 gusht. Pas saj do të performojë fituesi i 6 MTV VMA, Fatboy Slim, i njohur për muzikën elektronike. Më 2 gusht do të performojë ylli botëror Shawn Mendez, si një prej zërave më të njohur të popit në botë. Po atë natë, në C4, do të performojë Mochakk, DJ-i brazilian që po pushton botën me stilin funky e ekspresiv. Natën e fundit, skena kryesore i takon performancës audiovizuale nga Anyma – projekti solo i Matteo Milleri. Ndërsa në C4, festivali përmbyllet me Peggy Gou. Pos tyre, do të ketë edhe emra të tjerë si ndërkombëtarë, por edhe vendorë. Festivali do të mbahet nga 1 deri më 3 gusht në Parkun e Sunny Hill-it.

‘Siparantum’ Choir Returns to Berlin – and Heads to Thailand

For the fifth time, the Siparantum Choir took the stage at the Berlin Philhar-monie, as part of the ‘Walking in Beauty’ festival organized by ‘Choral Space.’ The performance was a special collaboration with composer and pianist Ola Gjeilo. The choir has additional engagements scheduled in at least four other countries before year’s end, including Greece, Denmark, and Thailand, with the final destination described only as “another, more distant place,” according to the choir from Peja.

Three Kosovar Festivals Join European Festivals Association

The international documentary film festival DokuFest, the animation festival Anibar, and the classical music festival ReMusica have been accepted as mem-bers of the European Festivals Association (EFA). This membership opens doors to collaborations and artistic exchanges within this prestigious continental network and beyond.

‘Negotiating Peace’ Continues Touring Europe

The production Negotiating Peace by the ‘Multimedia Center’ was staged in Florence on May 8 and 9. The Pergola Theatre hosted the play, an international co-production involving artists and theatre groups from various countries. In June, the performance is also scheduled to be staged in Milan.

Kosova at the Venice Architecture Biennale with ‘The Edelweiss No Longer Blooms...’

‘The Edelweiss No Longer Blooms: An Assembly in Unfolding’ is the theme of Kosova’s pavilion at the Venice International Architecture Biennale. The project explores the relationship with land and the effects of climate change, centering on the extinction of a flower species in Kosova due to environmental shifts. The pavilion, represented by architect Erzë Dinarama, is hosted in the Arsenale ex-hibition space. This is the 19th edition of the Architecture Biennale, and it runs through November 27.

Karahoda Brings Kosova to Cannes Once Again

After the success of his short films Displaced (2021) and Along the Road (2024), both selected in the official short film competition at the Cannes Film Festival – a rare distinction worldwide – director Samir Karahoda is now making his fea-ture-length debut with the project Lost Frames. This new work has been select-ed to participate in the ‘Focus COPRO’ 2025 program at the Cannes Film Mar-ket.

Shota Ensemble Brings Albanian Song and Dance to Germany

The National Ensemble of Songs and Dances ‘Shota’ from Kosova performed in Germany with a rich program of traditional Albanian songs and dances. It was part of the Cultural Week titled Sounds of Europe – Music Unites Europe in Chemnitz, held in the federal state of Saxony. Alongside Kosova, performers from Romania, France, Spain (Andalusia), Portugal, Belgium, Slovenia, and Armenia took part between May 7 and 9.
Dua Lipa to Perform in Pristina for Her ‘Radical Optimism’ World Tour

Dua Lipa will headline the fifth edition of the Sunny Hill festival in Pristina. As part of her global tour Radical Optimism, she will make a stop at the festival founded by her father, Dukagjin Lipa. Pristina is the only city in Southeast Eu-rope where Lipa will perform as part of this tour.

‘Sunny Hill’ Announces Lineup for This Year’s Edition

The Sunny Hill Festival has announced the lineup of performers for this year’s edition. Just days after Dua Lipa was confirmed as a headliner, several other Grammy, MTV, and Brit Award-winning artists were added. Lipa will open the festival on August 1. That night, Fatboy Slim – winner of six MTV VMAs and an icon of electronic music – will also perform. On August 2, global pop star Shawn Mendes will take the stage, followed by Brazilian DJ Mochakk at the C4 stage. The final night will feature an audiovisual performance by Anyma, the solo project of Matteo Milleri. Peggy Gou will close the C4 stage. The festival, which also includes both international and local acts, will be held from August 1 to 3 in Sunny Hill Park.

Fiona Llapashtica: Muzika gjithmonë më ka bërë të lumtur

"Thjesht, kurrë mos u dorëzoni. Gjithmonë shkoni më tutje, pavarësisht sfidave që ju dalin përpara"

ELVIRA **BERISHA**

Rrëfimet si ai i Fiona Llapashticës ndeshen rrallë në muzikën klasike. Por brenda botës ku zëri e emocioni bashkëveprojnë në harmoni të përkryer, sopranoja e re nga Kosova e ka gjetur vendin e vet. Madje në "kryeqytetin" e muzikës serioze, në Vjenë - shtëpinë e kompozitorëve e muzikantëve të pavdekshëm që jetojnë edhe sot nëpërmjet notave të tyre.

Fiona nuk është thjesht një artiste e re e talentuar, por shembull se me pasion, disiplinë dhe mbështetje, çdo ëndërr mund të realizohet. Ajo po shkruan një kapitull të ri të artit dhe të frymëzimit, duke u dalluar si një zë që ndriçon në errësirë dhe i jep shpresë çdo shpirti që dëgjon.

Vajzë pozitive, me talent të jashtëzakonshëm që premton shumë, model frymëzimi për shumë të rinj e të reja që duan të bëjnë karrierë artistike. Është dëshmi e vullnetit dhe e pasionit për artin, pavarësisht sfidave të mëdha që i ka sjellë jeta. E verbër që nga fëmijëria, ajo ka mësuar të dëgjojë më thellë me zemrën dhe të shprehë përmes zërit botën e saj të brendshme. Sot, në Vjenë, ajo po studion për ta përkryer rrugën e saj drejt një sopranoje të suksesshme, derisa Prishtinën e ndien si shtëpi të veten.

Zbulimi i talentit dhe pasioni për skenën

Në mëngjesin e një të diele, Fiona ndan kohën e saj të çmuar për të përshkruar shkurtimisht rrugëtimin e saj muzikor, duke nisur nga zbulimi i talentit në skenat e kryeqytetit austriak, ku në fëmijëri e sfidoi veten për herë të parë në skenë.

"Kam dalë në skenë që kur isha vetëm 6 vjeçe, në një rol në një mjuzikal të shkollës, dhe që atëherë kam vazhduar me koncerte klasike dhe korale," rrëfen ajo me emocion, duke treguar se ishin të tjerët që ia zbuluan talentin, e që i mundësuan të futet në botën e muzikës.

Në fillim ishte mësuesja e korit të shkollës që vuri re zërin e saj të veçantë, më pas mësuesja e muzikës dhe një fqinje që e inkurajoi për të

FOTO: FESTA KRASNIQI

Fiona Llapashtica: Music Always Made me Beautiful

"Simple as that – never give up. Always go further, regardless of the challenges that may arise."

A story like Fiona Llapashtica's is rarely met in classical music. Yet in a world where both voice and emotion interact in perfect harmony, the young soprano from Kosova has found her place. She did so in the 'capital' of serious music—Vienna—the home of everlasting composers and musicians who still live through their musical notes.

Fiona is not only a young, talented artist, but also an example of how every dream can come true through passion, discipline, and support. She is writing a new chapter of art and inspiration, distinguishing herself as a voice that shines through darkness and radiates hope for everyone who listens to her.

A likeable person with a remarkable talent that holds great promise, she is an inspiring model for young people who strive to pursue an artistic career. She stands as an example of will and passion for art, regardless of the major challenges life has brought her. Blind since childhood, she has learned to listen deeply through her heart and to reveal her inner world through her voice. Today, in Vienna, she is studying to pave the way toward becoming a successful soprano —while still perceiving Prishtina as her true home.

Discovering Talent and Passion for the Stage

On a Sunday morning, Fiona takes her precious time to briefly evoke her musical journey, starting from the discovery of her talent to the stages of Austrian capital, where she challenged herself at a very young age to step onto a musical stage for the first time.

"I made my appearance on stage when I was six, where I had a role in a school musical, and from then onwards I continued

mësuar flautin. Këta hapa të parë ishin baza për të ardhmen e saj artistike, një rrugë që gradualisht e çoi drejt koncerteve, interpretimeve nëpër kisha të ndryshme, masterklasave dhe drejt Fakultetit të Muzikës në Vjenë.

"Thënë të drejtën, nuk kam pasur vështirësi në muzikë, se gjithmonë më ka dhënë shumë muzika dhe më ka bërë të lumtur, por vështirësi ka qenë të mësoj teknikat e klasikes, sepse opera ka disa lloje teknikash që duhet të mësosh që të mos e mundosh veten, e kjo ka qenë pak e vështirë. Por jam në rrugë të mirë edhe në këtë drejtim," thotë ajo.

Në Vjenë, Fiona po zhvillohet e piqet artistikisht në një mjedis ku talenti dhe puna e palodhur shpërblehen me mundësi të shumta.

"Kam pasur mësues të mirë që më kanë mbështetur dhe përkrahur", tregon ajo, duke përmendur se Vjena, me pritshmëritë e saj të larta dhe konkurrencën e fortë, është vendi ideal për t'u rritur artistikisht.

Pavarësisht sfidave, sidomos në mësimin e teknikave të operës që kërkojnë disiplinë dhe aftësi të veçanta, Fiona është duke ecur me hapa të sigurt. Aktualisht, ajo po ndjek studimet në "Richard Wagner Konservatorium", një nga institucionet më të njohura të muzikës klasike në Austri. Për të verbrit që studiojnë muzikë në Austri, ekziston një sistem i avancuar për të mësuar partiturat në alfabetin e Braille-t. Ky sistem përkthen notat muzikore në forma të prekshme dhe të kuptueshme. Programi i studimit përfshin jo vetëm trajnim intensiv në këndim klasik me asistencë nga mësues të trajnuar, por edhe lëndë teorike dhe praktike. Të gjitha mësimet zhvillohen në gjuhën gjermane dhe ofrojnë përgatitje të gjithanshme për një karrierë profesionale. Tani në semestrin e tretë, ajo ndihet më e fortë dhe më e përgatitur për sfidat që vijnë.

Në koncertet ku ka marrë pjesë, publiku e ka vlerësuar me duartrokitje dhe lëvdata për zërin e saj.

"Publiku më ka pritur shumë mirë, pas koncerteve duartrokitje të pandalshme dhe njerëzit më janë afruar e më kanë thënë sa bukur po këndon, çfarë zëri magjik. Kam marrë komplimente të zemrës", thotë ajo.

Të veçanta për të janë sidomos paraqitjet në vendlindjen e prindërve.

Mes Vjenës dhe Prishtinës

Në udhëtimin artistik, ajo ka kaluar nga koncertet korale dhe ato në kishat e qytetit, drejt skenave profesionale dhe masterklasave ndërkombëtare. Gjatë këtyre viteve, ajo ka punuar me mësues të përkushtuar që kanë njohur dhe mbështetur

with classical and choral concerts," she recounts with emotion, emphasizing that her talent was discovered by others who made it possible for her to take the first step into the realm of music.

At the very beginning, it was the school choir teacher who noticed her distinctive voice, followed by her music teacher and a neighbor who encouraged her to take up the flute. These particular steps marked the starting point of her artistic future—a path that gradually led her to concerts, performances in several churches, masterclasses, and finally the Music Faculty in Vienna.

"Truth be told, I didn't have difficulties with music itself, as music always gave me so much and made me happy. But music techniques were hard, since opera has some technical aspects that must be acquired in order to avoid strain, and that part was sort of difficult. Nevertheless, I am on a good path to overcome these," she says.

In Vienna, Fiona is growing and maturing artistically in an environment where talent and tireless work are rewarded with many opportunities.

"I had good teachers who supported me," she asserts, underscoring that Vienna—with its high expectations and strong competition—is an ideal place for artistic growth.

Despite the difficulties, especially in acquiring operatic techniques which require discipline and special skills, Fiona is progressing at a commendable pace. She is currently studying at the Richard Wagner Konservatorium, one of the most renowned classical music institutions in Austria. For blind students studying music in Austria, there is an advanced system for acquiring scores using Braille. This system renders musical notes in tangible and understandable forms. The study program includes not only intensive training in classical singing with the aid of specialized teachers, but also practical and theoretical courses. All instruction is in German, and the institution offers a multifaceted education for a professional career. Now, in her third semester, she feels more confident about the challenges that lie ahead.

In past concerts, the public applauded her and praised her voice.

"The public reception was fairly good, there were laudable applauses and many comments about my singing and voice. Those were heartfelt compliments," she says.

The performances she gave in her parents' birthplace are dearest to her.

Between Vienna and Prishtina

In her artistic journey, she went from choral concerts and church performances all the way to professional stages and international masterclasses. During these years, she worked alongside dedicated teachers who recognized and supported her unusual potential. In her concerts in Vienna, she received enthusiasm and applauses. Her goal is to give a solo recital with classical arias from the greatest composers like Schubert – an experience she considers as a necessary step in her artistic growth.

"My greatest dream now is to give a solo concert in Vienna, with a pianist, where I would have the chance to perform my beloved arias, including some dramatic parts from Schubert," she says. She inherited this talent from her father, Agim Llapashtica, a famous rocker, and grew up surrounded by sound and genuine art. Her parents, who migrated in Austria during the wartime period, are her greatest supporters. This is why her bond with life feels so unbreakable. To Fiona, Prishtina always remains a special place – where she feels a deep connection with the people and their warm hospitality. "I have a connection and so many emotions for Prishtina, I like its people, their mentality, the way they treat others, and how they express their talent," says Fiona. "I feel like I am at home here," she adds.

One of the most important moments of her recent career was the masterclass with maestro Dario

potencialin e saj të jashtëzakonshëm. Në koncertet e saj në Vjenë, është pritur me entuziazëm dhe duartrokitje. Aty po synon ta realizojë një recital solo me arie klasike të kompozitorëve të mëdhenj si Schubert – një përvojë që e sheh si hap të natyrshëm në rritjen e saj artistike.

"Dëshira ime më e madhe tani është të realizoj një koncert solo në Vjenë, me pianiste, ku të performoj arie të zemrës, duke përfshirë edhe pjesë dramatike nga Schubert", thotë ajo.

Talentin e ka trashëguar nga babai i saj Agim Llapashtica, një roker i njohur, dhe është rritur mes tingujve dhe artit të mirëfilltë. Prindërit, që në kohë lufte ia mësynë Austrisë, janë mbështetja më e madhe që ka. Kjo bën që lidhja e saj me rrjedhat e jetës të jetë e pathyeshme. Për Fionën, Prishtina mbetet gjithmonë një vend i veçantë, ku ndien lidhje të thellë me njerëzit dhe mikpritjen e ngrohtë.

"Kam lidhje dhe shumë emocione të forta për Prishtinën, më pëlqejnë njerëzit shumë, më pëlqejnë se si e kanë mentalitetin, se si sillen me njerëz të tjerë, dhe se si e shfaqin talentin e tyre", thotë Fiona. "Këtu ndihem si në shtëpi", shton ajo.

Një nga momentet më të rëndësishme në karrierën e saj në vitet e fundit e cilëson masterklasën me mjeshtrin Dario Russo në edicionin e vitit 2024 të Festivalit Ndërkombëtar të Operas - Rame Lahaj. Masterklasa u kurorëzua me koncertin "New Generation", ku Fiona interpretoi arien "Erlkönig" të kompozitorit të saj të preferuar Franz Schubert.

"Publiku më ka pritur shumë mirë, pas performancës kanë ardhur dhe më kanë dhënë komplimente prej zemre. Gjatë masterklasës kam krijuar edhe miqësi dhe kam mësuar nga të tjerët. Jam e lumtur që do të kthehem edhe sivjet në masterklasën e festivalit", thotë ajo. Një ndër paraqitjet më të cilat u mishërua me publikun e Prishtinës ishte në vitin 2022, kur interpretoi në "KultPlus Caffe Gallery", duke shfaqur talentin e saj edhe në interpretimin e këngëve pop-jazz. Në një mbrëmje të ngrohtë të fillimgushtit, ajo mahniti audiencën me interpretimet në versionin e saj të këngëve ikonike, si: "Whatever Lola Wants" nga Jerry Ross, "Give me give me" nga ABBA, "Love on the Brain" nga Rihanna e shumë të tjera.

"Ende këndoj këngë pop-jazz, edhe muzikë klasike. Më pëlqen shumë të këndoj edhe pop-jazz", thotë ajo.

Shkak për t'u kthyer në Prishtinë përveç pushimeve verore, viteve të fundit, shpeshherë është bërë skena. Në Ngjarjen Kulturore në Mbështetje të Grupeve të Margjinalizuara në Kosovë "Ritmi i barazisë" që u mbajt në dhjetor të vitit 2024, Fiona interpretoi këngën "E kujtoj atë takim" të bilbilit të muzikës shqipe, Nexhmije Pagarusha. Në ngjarjen e organizuar nën patronatin e Ambasadores për Vullnetin e Mirë në Kosovë, Elvana Shala, ajo performoi duke mahnitur edhe një herë audiencën me talentin e saj. Kushdo që e dëgjon tek performon Fionën, do ta ruajë në kujtesë.

Fiona është e mbushur plot me energji pozitive, optimizëm dhe vetëbesim që buron nga përkushtimi i saj ndaj muzikës. Ka sfiduar barrierën më të madhe me të cilën e ka përballur jeta dhe nuk është ndalur. Prandaj edhe mesazhi i saj për të ecur përpara është më kuptimplotë:

"Thjesht, kurrë mos u dorëzoni. Gjithmonë shkoni më tutje, pavarësisht sfidave që ju dalin përpara", është mesazhi i saj për të gjithë ata që besojnë në art dhe në veten.

FOTO: FESTA KRASNIQI

Russo during the 2024 edition of the Opera's International Festival – Ramë Lahaj. This masterclass culminated in the concert "New Generation", where Fiona interpreted the aria 'Erlkönig' by the composer she adores, Franz Schubert.

"The public received me very well. When I finished my performance, they gave me heartfelt compliments. During this masterclass, I made new friends and learned a lot from others. I'm happy that I will participate in this year's festival as well," she says.

One of the performances where she won the hearts of Prishtina's public was in 2022, when she performed at the "KultPlus Caffe Gallery," showcasing her talent through pop-jazz songs. On a warm evening at the beginning of August, she impressed the audience with her versions of the iconic song "Whatever Lola Wants" by Jerry Ross, "Gimme! Gimme! Gimme!" by ABBA, "Love on the Brain" by Rihanna, and many others.

"I still sing pop-jazz songs, alongside classical music. I really enjoy singing pop-jazz", she says.

Besides summer vacations, another reason to be in Prishtina in recent years has been performing on stage. At the cultural event suporting marginalized groups in Kosova, "Ritmi i barazisë", held in December 2024, Fiona performed "E kujtoj atë takim" by the icon of Albanian music, Nexhmije Pagarusha. At the event organized by the Ambassador of Good Will, Elvana Shala, she performed and once again impressed the audience. She remains in the memory of everyone who hears her during performances.

Fiona is filled with positive energy, optimism, and self-confidence that springs from her dedication to music. She has faced great obstacles and never let them restrain her. This makes her message to move forward all the more meaningful. "Simple as that – never give up. Always go further, regardless of the challenges that may arise," is her message to all who believe in art and in themselves.

"Çast" kundër stigmës e nxitje për drejtësi

Muzeu "Çast" vjen si një thirrje për reflektim, edukim, thyerje të stigmës dhe nxitje të kurajës për të rrëfyer e kërkuar drejtësinë e merituar ndër vite.

Ihapur më 26 nëntor të vitit 2024 muzeu "Çast" vjen si iniciativë e Presidentes Jahjaga dhe si kurorë e tërë veprimtarisë së saj disavjeçare për kauzën e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Bashkideatore është edhe mikja e Presidentes, Diona Hoxha. Si tregon Bleona Hajdari, koordinatore e Muzeut, i gjithë projekti është implementuar nga Fondacioni Jahjaga në krye me drejtoreshën Egzona Bexheti dhe është financuar nga Ambasada Gjermane në Kosovë.

Për kurimin e hapësirës është përkujdesur Eliza Hoxha, ndërsa kontribut për pasurimin artistik të muzeut kanë dhënë edhe Zake Prelvukaj dhe Ylber Cervadiku. Medica Gjakova dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave - Drenas janë dy organizatat të cilat e kanë dëshmuar punën e tyre në mbështetje të të mbijetuarve dhe me të cilat është bashkëpunuar për hapjen e muezut. Muzeu përbëhet nga katër dhoma kryesore, ku secila ka rrëfimin e vet. Korridori është shtruar me gurë, me qëllimin që zhurma që krijohet nga shkelja mbi ta të shkaktojë përjetimin e traumave të rreth 20 mijë grave e burrave të dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë.

"Çast": A Stand Against Stigma, A Call for Justice

The "Çast" Museum stands as a call for reflection, education, breaking stigma, and gathering the courage to speak out and seek long-overdue justice.

Opened on November 26, 2024, the "Çast" Museum was founded as an initiative of President Atifete Jahjaga and as the culmination of her longstanding advocacy for survivors of sexual violence during the war in Kosovo. Co-creator of the initiative is President Jahjaga's close friend, Diona Hoxha. As Museum Coordinator Bleona Hajdari explains, the entire project was implemented by the Jahjaga Foundation, led by Director Egzona Bexheti, and financed by the German Embassy in Kosova. Further, the spatial design was curated by Eliza Hoxha, while Zake Prelvukaj and Ylber Çervadiku contributed artistically to the museum's enrichment. Two organizations that have long proven their dedication to supporting survivors – Medica Gjakova and the Center for the Promotion of Women's Rights in Drenas – were also partners in opening the museum.

The museum is comprised of four main rooms, each telling its own story. The corridor is purposefully paved with stones, so that the sound of footsteps across them evokes the trauma endured by around 20,000 women and men

Një çast në jetën time: Paraqet artefakte të të mbijetuarve, duke përfshirë, gra, burra dhe fëmijë. Një ndërthurje mes shtëpisë dhe pyllit, kjo dhomë paraqet dhimbjen e të mbijetuarve, braktisjen e shtëpisë, momentin e dhunimit dhe të sfidave të cilat ende vazhdojnë.

Një çast me mua: Vjen si ftesë e të mbijetuarve për ne, për të kaluar një moment në dhimbjen e tyre të pafundme dhe në zbrazëtinë e tyre emocionale.

Një çast të mendosh për mua: Në këtë dhomë janë ekspozuar dy funde të dy zonjave të mbijetuara, identiteti i të cilave ende është i panjohur, mirëpo jo edhe historitë e tyre që i kanë ndarë me Muzeun përmes mbishkrimeve të lëna vetë mbi fundet që i kanë pasur veshur gjatë momentit të dhunimit.

Një çast të inkurajosh: Vjen si një thirrje për të gjithë vizitorët që pas leximit të rrëfimeve, të reflektojnë dhe të lënë një mesazh inkurajues për të gjithë të



who were subjected to sexual violence during the last war in Kosovo.

A Moment in My Life: This room displays artifacts of survivors, women, men, and children. Designed as a fusion between home and forest, it represents the survivors' pain, the abandonment of home, the moment of violation, and the ongoing challenges they continue to face.

A Moment with Me: This room is an invitation from survivors to all of us to spend a moment inside their endless pain and emotional emptiness.

A Moment to Think of Me: Here, two skirts are displayed, once worn by two survivors whose identities remain unknown, but whose stories are not such. They shared their testimonies with the museum through handwritten messages inscribed directly onto the skirts they wore during the moment of their assault.

A Moment to Encourage: This room is a call to all visitors: after reading the testimonies, to reflect and leave

mbijetuarit, gjegjësisht për heroizmin e sakrificën e tyre të pastër.

Në fund do përmendur edhe fletorja e kuqe, që është dedikim për të mbijetuarit, në të cilën mund ta shkruajnë rrëfimin e tyre apo thjesht të lënë një shenjë për veten a historinë e tyre - falë së cilës ne sot frymojmë lirshëm në tokën tonë.

a message of encouragement – for all survivors and for the heroism and purity of their sacrifice. A special space has also been dedicated to survivors who have not yet spoken: a red notebook in which they can choose to share their story or simply leave a trace of themselves and their history – a history without which we would not breathe freely today on our own land.

Muzeu "Çast" vjen si fryt i përkushtimit tim të palëkundur dhe rrugëtimit shumëvjeçar për të sjellë në dritë të vërtetën e heshtur të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ky muze nuk është thjesht një hapësirë fizike, është një strehë shpirtërore, një dëshmi e qëndresës dhe e dinjitetit të atyre që mbijetuan plagë të pashërueshme, por jo të paemërta. Me themelimin e tij, "Çast" bëhet shtëpia e përhershme e secilit zë që është mohuar, e secilës dhimbje që është fshirë nga kujtesa kolektive. Kjo është hapësira ku heshtja thyhet dhe e vërteta flet, për drejtësi, për kujtim për brezat e rinj, për shërim dhe dritë mbi të vërtetën që nuk guxon të fshihet.

The "Çast" Museum is the fruit of my unwavering commitment and long journey to bring to light the silenced truth of survivors of wartime sexual violence in Kosova. This museum is not merely a physical space – it is a spiritual refuge, a testament to the resilience and dignity of those who endured unhealable wounds, but not nameless ones. With its founding, "Çast" becomes an everlasting home for every voice that has been denied, for every pain perished from collective memory. It is a space where silence is broken and truth speaks – of justice, of remembrance for future generations, of healing, and of the light that must never again be hidden.

ATIFETE JAHJAGA

"FemArt" Arti si protestë e skena si fuqi

Lindur nga heshtja e rritur pavarësisht vështirësive, "FemArt" është shkëndijë e artit feminist në Kosovë. Festivali vazhdon të sfidojë normat përmes artit dhe aktivizmit. Ajo që nisi si hapësirë për shprehje, sot po ndërton brezin e ardhshëm të rezistencës.

ALBERINA **HAXHIJAJ**

Para trembëdhjetë vjetësh, kur edicioni i parë i festivalit "FemArt" nisi në Prishtinë, trasoi rrugën për një hapësirë që do të guxonte ta përdorte artin për ta sfiduar patriarkatin.

Sot, "FemArt" nuk është vetëm një festival, por edhe një lëvizje. Themeluesja e përshkruan si një vajzë 13-vjeçare - adoleshente, e guximshme, shpeshherë e pakuptuar, por gjithmonë me zërin e saj të qartë dhe shpirtin plot zjarr. Lindur nga dëshira për art, aktivizëm dhe drejtësi, "FemArt" është kthyer në një hapësirë kulturore që bashkon më shumë se 2 mijë artistë dhe aktivistë nga 40 vende të ndryshme të botës. Çdo vit, ata sjellin rrëfime që janë fshehur, harruar ose censuruar – deri më tani.

"FemArt" lindi nga një nevojë e brendshme – për të ndërtuar hapësirën që mungonte, për të treguar se gratë artiste në Kosovë dhe në rajon janë të zëshme, të fuqishme, dhe kanë me shumë për

FOTO: ELMEDINA ARAPI

"FemArt" Art as Protest, Stage as Power

Born out of silence and grown despite adversity, "FemArt" is a spark of feminist art in Kosova. The festival challenges norms through art and activism. What began as a space for expression has become a platform shaping a new genera-tion of resistance.

Thirteen years ago, when the first edition of "FemArt" festival was launched in Prishtina, it paved the way toward a space that dared to use art to challenge pa-triarchy. Today, "FemArt" is not just a festival—it is a movement. It is, as its founder fondly describes, a 13-year-old girl: adolescent, courageous, often mis-understood, but always clear in voice and burning with spirit. Born from a de-sire for art, activism, and justice, "FemArt" has become into a cultural hub making together over 2,000 artists and activists from more than 40 countries all over the world. Every year, they bring forward stories that have been hidden, forgotten, or censored so far.

"FemArt" was born from an inner need—to create a space that was

të thënë", thekson Zana Hoxha, e cila po ashtu është në krye të organizatës "Artpolis" që e organizon Festivalin.

Një festival, një lëvizje, një shtëpi për rrëfimet e guximshme

Edicioni i sivjetmë vjen me temën: Çliroje mendjen. Më shumë se një slogan, është një ftesë për t'u përballur me të vërtetën brenda nesh, për të biseduar haptas për dhimbjen, shërimin dhe shëndetin mendor. "Shëndetin mendor si një akt çlirimin politik dhe personal", tregon ajo. Thekson se në këtë edicion nuk do ikin prej dhimbjes.

Mes shumë aktiviteteve që do të organizohen është edhe koncerti hapës i festivalit nga "Shkodra Elektronike". Shfaqje që eksplorojnë traumën kolektive përmes formave eksperimentale, rezistenca artistike ndërkombëtare dhe krijime të artistëve të rinj që për herë të parë do të ndajnë rrëfime shumë personale pikërisht përmes artit, janë veç disa prej pikave të programit. Prapa realizmit të tyre qëndron ekipi i "Artpolis-it". Energjia dhe përkushtimi i tyre bënë që festivali të jetë më shumë se një ngjarje, të kthehet në një përvojë.

Por çfarë ka ndryshuar "FemArt" për 13 vjet?

Sipas Zana Hoxhës, Festivali ka hapur një derë që për shumë kohë ishte e mbyllur për gratë.

"Ka sjellë në skenë çështje të harruara, është bërë zë për të heshturit dhe ka krijuar një gjuhë të re për të folur për dhimbjen dhe guximin. Ka ndikuar në mënyrën se si flasim për barazi gjinore, për artin si mjet rezistence, për rëndësinë e komunitetit artistik që nuk ka frikë të jetë politik", thotë ajo për festivalin që nisi në vitin 2013.

Thekson se në një shoqëri ku kultura shpesh është e depolitizuar me

FOTO: ARBEN LLAPASHTICA

missing, to show that women artists in Kosova and the region are vocal, powerful, and have much to say," says Zana Hoxha, who also leads "Artpolis", the organiza-tion that hosts the festival.

A Festival, a Movement, a Home for Courageous Stories

This year's edition carries the theme "Liberate the Mind." Rather than a slogan, it is an invitation to face our internal truths, to openly talk about pain, healing, and mental health. "Mental health as an act of political and personal libera-tion," Zana adds. According to her, this year's edition will not eschew from pain.

Among the many planned events is the opening concert by "Shkodra Elektroni-ke." The program will feature performances that explore collective trauma through experimental forms, international artistic resistance, and deeply per-sonal stories shared for the first time by young artists. All of this is made possi-ble by the "Artpolis" team, whose energy and commitment turn the festival into something more than an event—it has become an experience.

But what has changed in "FemArt" during these 13 years?

> According to Zana, the festival opened a door that had long been closed to women.

"It brought into limelight forgotten topics, it has been a voice to the silenced, and created a new language to express pain and courage. It affected the way how we speak about gender equality, about art as a form of resistance, about the importance of an artistic community unafraid to be political," she says of the festival that began in 2013.

Zana asserts that in a society where culture has often been intentionally depo-liticized, "FemArt" has refused to be neutral.

To Build a Space Is Not Enough—You Have to Defend It

For independent artists and

qëllim, "FemArt" që nga fillimi ka refuzuar të jetë neutral.

Të ndërtosh një hapësirë nuk mjafton, duhet edhe ta mbrosh

Për artistët e pavarur dhe zërat feministë, sfidat nuk janë vetëm financiare, mes tyre janë edhe ato emocionale.

"Vetmia. Rreziku i izolimit. Mungesa e mbështetjes së qëndrueshme dhe stigmatizimi i vazhdueshëm që i ndjek ata që guxojnë të thonë të vërtetën. Për gratë artiste kjo është dyfish më e rëndë – sepse nuk përballen vetëm me mungesë fondesh apo hapësirash, por edhe me gjykimin social, me paragjykimin gjinor, me dyshimin konstant që u bëhet. Dhe megjithatë, kjo e bën artin e tyre edhe më të fuqishëm. Sepse nuk është vetëm art – është dëshmi", thotë ajo.

Dhe pikërisht këtu lulëzon FemArt – në pikëtakimin mes personales dhe politikes, aty ku dhimbja shndërrohet në performancë dhe heshtja bëhet zë. Po çfarë e mban FemArt-in gjallë pas gjithë kësaj kohe?

Zana Hoxha tregon se është komuniteti që vazhdimisht rritet, transformohet e shërohet. Por përtej këtyre janë edhe ato momentet e vogla, po që të japin kurajë, që shpesh të shtyjnë pikërisht atëherë kur mendon se nuk ke forcë. Pasi për të Festivali është më shumë se një ngjarje e përvitshme.

> **"'FemArt' është pjesë e shpirtit tim – është zëri im kur nuk më dëgjuan, është shërimi im kur isha e thyer, është fuqia ime kur më thanë se nuk do mundesha. Dhe për sa kohë kam frymë, do ta mbaj gjallë", thotë ajo duke reflektuar mbi rrugëtimin e Festivalit.**

Përgjatë viteve, "FemArt" si festivali i vetëm feminist në rajon, është kthyer në një platformë të rëndësishme feministe, duke kombinuar artin dhe aktivizmin për të kthyer rrëfimet personale

feminist voices, the challenges are not only finan-cial—they are emotional likewise.

"Solitude. The danger of isolation. The lack of sustainable support and the on-going stigma that follows those who dare to speak the truth. For women artists, it's even harder—they face not only a lack of funding and space, but also social judgment, gender bias, and constant suspicion. Nonetheless, that makes their art even more powerful. Because it is not just art—it is evidence," she says.

That is precisely where "FemArt" thrives—in the space where the personal and the political encounter, in that moment when pain transforms into performance and silence becomes voice. So what keeps "FemArt" alive after all these years?

Zana tells that the community constantly grows, transforms, and heals. And then there are those small moments that give you courage, often prompting to go further when you feel powerless. For her, the festival is far more than a past event.

"'FemArt' is part of my soul—it was my voice when I wasn't heard, my healing when I was tormented, and my strength when I was told I couldn't make it. As long as I live, I'll keep it alive," Zana reflects on the festival's journey.

Over the years, "FemArt", as the only feminist festival in the region, has become an essential feminist platform, intertwining art and activism to turn personal stories into powerful performances. In a society where injustices often go unno-ticed and pain is rarely discussed, art becomes the vehicle for truth. As Zana puts it, "Feminism is not just a theory—it's an experience, a feeling, a collective revolt that can no longer be ignored."

Important truths can be discussed—even shouted—from the

në performanca të fuqishme. Në një vend ku padrejtësitë shpesh kalojnë pa u vërejtur e për dhimbjen nuk flitet, arti kthehet në një mjet për t'u shprehur e për ta thënë të vërtetën. Kështu, siç thotë edhe Hoxha, "Feminizmi nuk është vetëm teori – bëhet përvojë, bëhet ndjesi, bëhet revoltë kolektive që nuk mund të injorohet". Për gjërat e rëndësishme flitet e bërtitet edhe nga skena.

Por të ndërtosh e të mbash diçka kaq domethënëse nuk është e lehtë.

"Më sfiduesja ka qenë të jem e qëndrueshme edhe kur jeta më rrëzonte", tregon Hoxha. "Kam kaluar periudha kur ndihesha e boshatisur, e vetme, por nuk lejoja që dhimbja ime personale të ndikonte në misionin tim". Për të nuk ka trofe me të vlefshëm sesa të dihet se është arritur të krijohet një hapësirë ku njerëzit mund të ndihen e të shprehen lirshëm.

"Më motivon vajza ime kur më thotë: 'Jam krenare për ty'. Më motivon çdo mesazh nga gratë që më thonë: Falë 'FemArt-it', e gjeta zërin tim". Vizioni i saj për të ardhmen e "FemArt-it" është i guximshëm dhe i qartë. Dëshirën e ka që të jetojë përtej saj, e të jetë më shumë se një festival - një institut që do të jetë shtëpi për artin feminist, për kërkimin artistik, për trajnimin e brezave të rinj të aktivistëve dhe artistëve.

"Dua që kjo vajzë 13-vjeçare (v.j. "FemArt-i") të rritet e të bëhet një grua e fortë që nuk ndalet. Një platformë që jo vetëm reagon ndaj botës, por e ndërton atë nga e para. Një 'queendom' e vërtetë, ku arti dhe drejtësia ecin dorë për dore".

E gjersa festivali "FemArt" rritet për vete, na fton edhe ne, jo vetëm për të ndjekur aktivitetet, por për t'u rritur bashkë me të e për t'u bërë pjesë e ndryshimit. Sepse e ardhmja duhet ndërtuar së bashku.

stage. But creating and sustaining something so meaningful isn't that easy.

"The hardest part was to stay resilient when life pulled me down," Zana says. "I went through times when I felt empty, alone, but I still didn't allow my person-al pain overshadow my mission."

For her, there is no greater trophy than knowing a space has been created where people where people can feel safe and free to express themselves.

"My daughter inspires me when she says, 'I am proud of you.' Every message from a woman saying 'Thanks to FemArt, I found my voice,' inspires me."

> **Zana's vision for the future of "FemArt" is bold and clear. She longs that the "FemArt" becomes more than a festival—indeed an institute that houses femi-nist art, a space for artistic quest, and a training center for new gener-ation of activists and artists.**

"I want this 13-year-old girl to grow into a strong woman who never stops—a platform that not only reacts to the world, but builds anew. A true 'queendom' where art and justice walk side by side."

As the "FemArt" Festival continue to grow, it invites all of us not just to follow its activities, but to grow with it, to become part of the change. Because the fu-ture is something we build together.

FOTO: RILIND BEQA

“Shliroj Cicat” kundër kancerit të gjirit

“Free the Boobs” Against Breast Cancer

ALBERINA **HAXHIJAJ**

“Shliroj Cicat” është festivali që përdor artin, aktivizmin dhe feminizmin për të ndryshuar mënyrën se si shoqëria bisedon për kancerin e gjirit.

“Free the Boobs” is a festival that relies on art, activism, and feminism to re-shape the way society discusses breast cancer.

Ka një rol të madh në rritjen e vetëdijes për këtë temë që njëherë konsiderohej tabu, e që gjithmonë kërkon kujdes dhe reagim të shpejtë për të shpëtuar jetë.

Emër provokues që nxit diskutim

Diskutimet në lidhje me shëndetin e grave, shpesh, në shumë shoqëri ishin tabu, ose nuk bëheshin në atë mënyrë që të ndikonin pozitivisht në informimin dhe mbrojtjen e grave ndaj sëmundjeve të caktuara. Kështu ishte edhe në Kosovë. Në një hapësirë të tillë ku mungesa e informacioneve ishte e dukshme zë vend edhe nisja e festivalit “Shliroj Cicat”. Ideja, siç tregon Ermira Murati, drejtoresha ekzekutive e Festivalit, lindi nga nevoja për të folur ndryshe në publik për kancerin e gjirit,

It plays a significant role in raising awareness of a subject once considered taboo, as it demands vigilance and a swift response to save lives.

A Provocative Name That Stirs Debate

The discussion surrounding women’s health has often been cloaked in taboos – in other words, it has not been addressed in a way that positively informs and protects women against certain diseases. The same was true in Kosova. In such an environment, where a lack of information was noticeable, the festival “Shliroj Cicat” (Free the Boobs) took place. As the festival’s executive director Ermira Murati explains, the idea sprung from the need to discuss about breast cancer differently, outside the boundaries of fear and taboo, and from the ab-sence of an approach that treats this topic with courage and creativity.

“Another strong drive was the will to directly communicate with youth, as car-riers of change, who could easily spread the message within families, communi-ties, and on social media,” she emphasizes.

From the very name – which is provocative, direct, and impossible to ignore – it is both a call for caution and a form of resistance. It is a notable cultural event that uses both art and activism to influence society. For Murati, this is a direct, uncomfortable yet necessary call.

“‘Free the Boobs’ is a revolt and a liberation at the same time – a liberation from shame, stigma, and the pressure to stay silent and invisible. The title is not on-ly provocative, but also emancipating. It can’t be overlooked, because the theme itself can no longer be

jashtë kornizave të frikës e të tabusë, si dhe nga mungesa e një qasjeje që kjo temë të trajtohej me guxim dhe kreativitet.

"Një shtytje tjetër e fortë ka qenë edhe dëshira për të komunikuar drejtpërdrejt me të rinjtë – si bartës të ndryshimit dhe si ata që mund ta shpërndajnë mesazhin më gjerësisht në familje, komunitet dhe rrjete sociale", thekson ajo.

Vetë emri i festivalit – provokativ, i drejtpërdrejtë, i pamundshëm për t'u injoruar – është thirrje për kujdes, por edhe formë rezistence. Një ngjarje me rëndësi kulturore e që bën bashkë artin dhe aktivizmin me synim që të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në shoqëri. Për Muratin, një thirrje direkte, e parehatshme, por e nevojshme.

"'Shliroj Cicat' është revoltë dhe çlirim në të njëjtën kohë – çlirim nga turpi, stigma, presioni për të qenë të heshtura e të padukshme. Ky titull nuk është vetëm provokues, por emancipues. Është një titull që nuk lejon të anashkalohet, sepse edhe tema nuk duhet të anashkalohet më", thotë ajo.

Kujton fillimin e vështirë. Edicionet e para të Festivalit që u themelua në tetor të vitit 2021, u dalluan për mungesë të mbështetjes financiare, për mosbesim institucional dhe paragjykime ndaj temës "për një festival me titull jo të zakontë".

"Kemi punuar me zero buxhet, me pak ndihmë vullnetare dhe me bindjen se kjo është më shumë se një ngjarje – është një nevojë".

ignored," she says.

Recalling the difficult beginning, she mentioned that the first edition of the fes-tival, launched in October 2021, faced a lack of financial support, institutional distrust, and prejudice toward a festival with such an unusual name.

"We worked with zero budget, with a bit of volunteer help, but always with the strong belief that this was more than an event – it was a necessity."

Art as a Vehicle of Change, Feminism as Its Foundation

As Ermira Murati recounts, the Festival has grown steadily – from an initiative driven by passion with a small budget into a platform that is now recognized for combing art, activism, and courage. She emphasizes that every edition pushed the boundaries of what it means to talk publicly about breast cancer – they succeeded in raising awareness not only among women but also among men, as breast cancer affects both genders alike.

"This inclusive approach is embodied in creative forms of communication and has helped expand the festival from a symbolic event into a movement with real impact," she says.

She considers the festival's major achievement to be the creation of the NGO "CICAT" (Creative Information, Care and Artivism for Tomorrow). It provides a hub for year-round work on their projects and as a support center for the community. Its results and influence are evident. They succeeded in creating a fund that directly helps women affected by breast cancer.

As a result of the Festival's most recent activity, an auction of artworks, they are now purchasing four blood transfusion devices and launching a project for the production of prostheses. According to Murati, this will ease the financial burden many women face due to the high cost of

Arti si mjet për ndryshim, feminizmi si bazë

Festivali, thotë Ermira Murati, ka pasur një rritje graduale – nga një nismë me shumë pasion e pak mjete, në një platformë që sot njihet për kombinimin e veçantë të artit, aktivizmit dhe të guximit. E thekson se me çdo edicion, kanë shtyrë kufijtë e asaj që do të thotë të flasësh për kancerin e gjirit publikisht, dhe kanë rritur ndjeshëm ndërgjegjësimin, sipas saj jo vetëm të grave, por edhe të burrave, meqë kanceri i gjirit nuk njeh gjini.

"Kjo qasje e barabartë është mishëruar në format kreative të komunikimit dhe ka ndihmuar në shtrirjen e festivalit përtej një ngjarjeje simbolike – në një lëvizje me ndikim konkret", thotë ajo.

Si arritjen me të madhe të Festivalit e konsideron krijimin e organizatës joqeveritare "CICAT" (Creative Information, Care and Artivism for Tomorrow). Një hapësirë ku mund të punojnë gjatë gjithë vitit në projektet e tyre dhe mund të jenë të qasshëm për të ndihmuar komunitetin. Rezultati e ndikimi janë të qartë. Kanë arritur të kenë një fond që drejtpërdrejt ndihmon gratë e prekura nga kanceri i gjirit.

Si rezultat i aktivitetit më të fundit të Festivalit, ankandit me vepra artistike, tani janë në proces të blerjes së katër aparaturave për transfuzionin e gjakut, e po ashtu janë në nisje të projekti për prodhimin e protezave. Kjo, sipas Muratit, do të lehtësojë barrën financiare që sot rëndon mbi gratë, për shkak të çmimeve të larta të protezave në treg.

"Edicioni i katërt i Festivalit ishte veçanërisht i suksesshëm dhe ka hapur rrugën për këto investime konkrete, si dhe për tërheqjen e donacioneve të reja nga akterë të ndryshëm. Me këtë ritëm të rritjes dhe me mbështetjen e fuqishme të qytetarëve – sidomos të diasporës – besojmë se kapaciteti ynë për të

prostheses. "The fourth edition of the festival was particularly successful – it paved the way for concrete investments and attracted new donations from various contribu-tors. With the current momentum and strong support from citizens – especially those living abroad – we believe our capacity to directly impact people's lives will continue to grow," she says.

According to Murati, the Festival is built on three main pillars, with the prima-ry goal of ensuring that women have autonomy over their bodies, information, choices, and lives. Every activity that takes place within the Festival is an act of resistance. "Art is our way to express the untold. Activism is our political voice. Feminism is the very foundation – it sees the woman's body as political, protected, and free at the same time," says Murati, who also goes by the artistic name "Orange Girl."

Beyond Awareness: A New Form of Caution

Ermira Murati shares her belief

ndikuar drejtpërdrejt në jetën e njerëzve do të vazhdojë të zgjerohet", thekson ajo. Tregon se Festivali ka tri shtylla kryesore, e qëllim e kanë që gratë të kenë autonomi mbi trupin e tyre, informimin, zgjedhjen dhe jetën. Thekson se çdo aktivitet që bëhet gjatë Festivalit është një akt rezistence. "Arti është mënyra jonë për të shprehur të pathënën. Aktivizmi është zëri ynë politik. Feminizmi është baza – ai që e sheh trupin e gruas si politik, si të mbrojtur dhe të lirë në të njëjtën kohë", thotë Murati që ndryshe në botën e artit njihet edhe si "Orange Girl".

Përtej vetëdijesimit: Një formë e re e kujdesit

Ermira Murati është e bindur që arti ka ndikim në shoqëri. Tregon se përmes festivalit "Shliroj Cicat" u kanë mundësuar grave dhe burrave të flasin për përvojat e tyre pa ndjenjën e fajit ose të turpit e që sipas saj kjo nuk do të ishte e mundshme përmes një raporti institucional.

"Ka ndikuar në mënyrën se si publiku e sheh të mbijetuarën, apo edhe vetë fjalën 'cicë'. Ndryshimi fillon kur njeriu e sheh veten të përfaqësuar – dhe këtë ia mundëson arti", thekson ajo. Festivalin e sheh më shumë se një festival, e konsideron një lëvizje pikërisht për shkak të ndikimit që ka. E këtë të fundit e masin përmes historive të grave që vijnë e tregojnë përjetimet e tyre, përmes numrit të ndjekësve të Festivalit që rritet çdo vit, përmes interesimit të burrave e të djemve për të mësuar më shumë, por mbi të gjitha, e masin ndikimin nga mënyra si ka ndryshuar diskursi publik. "Sot flitet më lirshëm për trupin, për kancerin, për kujdesin", thekson ajo.

Synimet e planet për Festivalin i kanë të qarta. Duan të dalin jashtë Prishtinës, në rajon e përtej, si dhe të kenë një qendër të vetën ku gratë do të mund të marrin mbështetje gjatë gjithë vitit. Por edhe të rinjtë i kanë target. Dëshirojnë të zhvillojmë materiale edukative për fëmijë, të shtypura dhe on-line, që të mësojnë të kujdesën për trupin e tyre që në moshë të hershme.

"Gjithashtu, përmes artit synojmë të vazhdojmë të mbështesim prodhimin dhe shpërndarjen e ndihmave konkrete për gratë dhe burrat, duke vazhduar njëkohësisht edhe me ndërgjegjësimin rreth kësaj çështjeje", thotë ajo.

Në një vend ku të flasësh për sëmundje apo të eksplorosh trupin tënd shpesh konsiderohet si e pahijshme, Festivali "Shliroj Cicat" zgjedh të bëjë pikërisht këtë. Vjen si një thirrje për informim, ndjeshmëri, kujdes dhe çlirim.

that art has the power to influence society. Ac-cording to her, the "Shliroj Cicat" Festival enabled women and men alike to speak freely, without shame or guilt, something that would not have been pos-sible if it had followed a strictly institutional format.

"It has changed the way the public perceives survivors, and even the word 'cicë' (tit). Change begins when people see themselves represented – and this is made possible through art," she emphasizes. Murati sees the festival as more than a festival, indeed a movement because of its growing influence. This can be measured through women's stories of their experiences, the steadily growing number of followers, the interest shown by men to learn more, and, above all, by how public discourse has shifted.

"Now, people talk more freely about the body, cancer, and self-care," she says.

The organization has clear plans and goals. They aim to expand beyond Prisht-ina, reaching adjacent countries and even further, and to establish their own center that will be supported all year long. Their focus is on youth as well. They want to develop educational materials for children, both printed and online, to help them care for their bodies from an early age.

"Likewise, our goal is to use art to continue producing and delivering tangible support for both women and men, while also raising greater awareness on this subject," she adds.

In a culture where talking about disease or exploring one's body is often con-sidered improper, the "Shliroj Cicat" Festival chooses to do exactly that. It serves as a call for informing, sensitivity, care, and liberation.

Ms. Indefinite

Artistja që thyen heshtjen

Saranda Sadikaj e cila njihet në botën e artit si Ms. Indefinite e përdor trupin e saj si një formë protestë, zërin e saj si formë rezistence dhe artin si mjet për thirrje për drejtësi.

ALBERINA HAXHIJAJ

An Artist Who Breaks the Silence

Saranda Sadikaj, known by his artistic name as Ms. Indefinite, uses her body as a protest, her voice as a resistance and art as a voice for justice.

Koncepti i artit në ditët e sotme del përtej galerive, pasi ka artistë puna e të cilëve zë vend në hapësira publike, madje edhe në institucione si gjykatat, të tillë që përdorin trupin e tyre për të shprehur mesazhe të forta. Të gjitha këto i gjen të Ms. Indefinite. Vetë emri siç tregon ajo sfidon definimin.

“

The concept of contemporary art extends far beyond galleries. Today, there are artists whose works take place in public spaces, even in public institutions like courts. There are artists who uses their own body to disseminate powerful messages. All of these are to be found in Ms. Indefinite. Her very name shows how she defies any definition.

"Artistikisht, Ms. Indefinite është mishërim i potencialit të pakufishëm. Ms. Indefinite na fton të ekzistojmë artistikisht jo për të përkufizuar, por për të zbuluar; jo për të zgjidhur, por për të provokuar; jo për të përfunduar, por për të riimagjinuar vazhdimisht", shprehet ajo.

Mënyrat e shfaqjes së artit nga ana e saj kanë evoluuar përgjatë viteve. Fillimisht në vitin 2019 kishte filluar me videoperformanca që publikoheshin në rrjete sociale. Më pas, nisi t'i shfaqte videoperformancat si premiera në evente publike gjersa tani realizon edhe videoinstalacione dhe performanca live, derisa kështu publiku është prezent fizikisht dhe mund ta përjetojë artin në kohë reale. Por kjo nuk është e gjitha. Ajo gjithashtu ka organizuar edhe ekspozita duke gërshetuar së bashku videoperformancat me instalacione e performanca live. Një përzgjedhje e tillë e bërë me qëllim që të tërheqë vëmendjen e publikut, jo vetëm ndaj temave që i shtjellon, por edhe ndaj urgjencës për veprim që vjen bashkë me to.

Arti i saj, siç ajo e përshkruan është "një shpërthim i heshtjes", që merr formë përmes trupit, fjalëve, tingujve dhe lëvizjeve. Një bashkëdyzim i aktrimit, koreografisë, poezisë dhe kompozimit muzikor në një shprehje të vetme e unifikuese. Kështu arti i saj merr epitetin edhe të aktivizmit feminist.

"Krijimi për mua fillon aty ku heshtja bëhet e padurueshme", thotë ajo duke theksuar se arti i saj është një luftë artistike kundër patriarkatit, mizogjinisë dhe femicidit.

Trupi si protestë, arti si akt politik

Zgjedhja e lokacioneve të performancave asnjëherë nuk është rastësore. Vepra e saj "Marigona nuk e qëndis më flamurin" – që i kushtohet Marigona Osmanit, 18-vjeçares nga Ferizaj, e cila u vra nga partneri i saj, Dardan Krivaqa – është performuar para Gjykatës Themelore në Ferizaj. Duke qëndisur flamurin kombëtar e duke ndryshuar tekstin e himnit, Ms. Indefinite vajton gratë e vrara në Kosovë dhe konfrontohet me institucionet.

"Për mua, arti nuk i përket vetëm galerisë, i përket rrugës, përballë institucioneve, aty ku ndodhin padrejtësitë", thekson ajo. Ms. Indefinite veçohet edhe për përdorimin e trupit të saj për t'u shprehur artistikisht. Vetë trupi është epiqendër e veprave të saj. Për të përdorimi i trupit në performanca nuk është thjesht zgjedhje artistike, por një akt politik.

"Arstisically speaking, Ms. Indefinite embodies boundless potential. She invites us to exist artistically not to be defined, but to explore; not to yield answers, but to provoke; not to reach an end, but to inccessantly reimagine," she says.

Over time, the way how she displays her art has changed. In 2019, she introduced video-performances that were shared in social media. Then, she began displaying them as premieres at public events. Today, she releases video installations and live performances. By so doing, she ensures that public is physically present and able to experience the art in real-time.

But that's not all. She has also hosted exhibitions, intertwining video, installation, and live perfornance. These selected array of artworks are shown not only to draw attention to the themes she delves, but also to urge the public into action. She describes her art as "an eruption of silence" that takes its shape through the body, words, sounds, and movement. It is a combination of acting, choreography, poetry, and musical composition that are woven into a single, unified expression. Thus, her work acquires the outlook of feminist activism.

"For me, creation emerges in the vert moment when silence becomes unbearable," she says, emphasizing that her art is an artistic struggle against patriarchy, misogeny, and femicide.

Body as Protest, Art as Political Act

When the performance location is chosen, nothing is left to coincidence. Her artwork 'Marigona No Longer Tailors the Flag', dedicated to Marigona Osmani, an 18-year-old girl from Ferizaj who was killed by her partner Dardan Krivaqa, was performed in front of the Basic Court in Ferizaj. By tailoring the national flag and altering the anthem's lyrics, Ms. Indefinite bewails the murdered women of Kosova and confronts public institutions.

"For me, art does not belong solely to galleries. It also belong to the streets, in front of institutions, where injustices take

"Kur flas për dhunën apo padrejtësinë përmes trupit tim, unë nuk e imagjinoj atë, por e kritikoj, e luftoj dhe e refuzoj dhe në të njëjtën kohë shndërrohem në subjekt proteste. Trupi si subjekt për mua, përbën një arkiv të zemërimit të heshtur dhe kujtesës kolektive të plagëve, nga e cila edhe buron një fuqi gati se e frikshme për sistemin patriarkal", thotë ajo.

E gjithë kjo dëshmohet më së miri përmes veprave artistike si: "Vitruvian Woman", "Kryqëzatë e kryqëzuar", "Gërshet'im" dhe "∞ZI". Në fakt secila nga veprat e saj trajton një çështje specifike dhe i jep zë kauzës për barazi gjinore a kundër dhunës ndaj grave. Mes tyre edhe projekti artistik feminist "Motrat Tona" – që përbëhet nga pesë videoinstalcione dhe dy instalacione reflektuese - inspiruar nga vepra "Motra Tone" e artistit shqiptar Kol Idromeno. Aty Ms. Indefinite imiton dukjen e personazhit të kryeveprës shqiptare. Por portreti i vetë artistes, shfaqet me fytyrë të gjakosur, e te njëra ngadalë bëhet skelet duke shprehur kështu fatin e vajzave dhe të grave në Kosovë.

"Deri më sot qëndron si një ndër veprat që e komunikon realitetin aktual, ku arti, historia, politika dhe dhimbja kolektive e grave bashkëjetojnë mes së kaluarës dhe së tashmes, duke u bërë një. Prandaj, kjo vepër përfaqëson artin tim jo vetëm në përmbajtje, por edhe në formë dhe qasje, si një shprehje e plotë e identitetit tim artistik dhe aktivist", thotë ajo për këtë vepër.

Megjithatë rrugëtimi i saj artistik tejkalon shprehjen individuale pasi ajo si përgjigje ndaj mungesës së platformave për art feminist në Kosovë, ka themeluar në vitin 2024, Institutin Indefinite, një hapësirë place," she emphasizes. Ms. Indefinite is known for using her body as a means of artistic expression. Her artworks are centered on the body itself. She states that the use of the body in performance is not merely an artistic choise, but a political act.

"When I speak of violence or injustice through my own body, I do not imagine it. I criticize it, combat it, and refuse it, and at the same time, I become a subject of protest. For me, the body constitutes an archive of hidden indignation and collective memories of wounds that produce a nearly-frightening power in the face of the patriarchal system," she says.

This is best exemplified by her works like 'Vitruvian Women', 'Kryqëzatë e kryqëzuar', 'Gërshet'im', and '∞ZI'. Each piece dwells on a particular issue and raises its voice for gender euqality or against the violence toward women. Among them is her feminist art project 'Motrat Tona', which consists of five video installations and two reflective ones. Her inspiration was drawn from Kolë Idromeno's masterpiece 'Motra Tone.' Ms. Indefinite imitates the appearance of the central figure from that painting. Her own portrait appears with a bloody face, while in another one, she becomes a skeleton, thus showcasing the fate of girls and women in Kosova.

"So far, it stands as one of the artworks that conveys current reality, where art, history, politics, and the collective pain of women coexist between past and present, becoming one. Therefore, this work represents my art not only in terms of content, but also in form and approach. It is a full expression of my identity as both artist and activist," she says in reflection.

Yet her artistic journey goes beyond personal expression. In 2024, driven by the absence of a platform for feminist art in Kosova, she founded the Indefinite Institute, a multidisiplinary hub for women, girls, and young artists to develop their creativity and begin their activism.

"In spite of my own creative activity, the lack of advocacy through feminist art, and the lack of support for young feminist artists in Kosova, was very noticeable. That's why I founded the Indefinite Institute," she adds.

When Art Becomes a Call for Justice

Each performance by Ms. Indefinite is more than an artistic piece as it emanates an urgent call to action. 'GËRSHETË' (2024) is an exhibition that uses the symbolism of braids to display feminist resistance and the power of collective struggle across centuries. 'A Bite That Won't Go Down' (2024) is a performance that reflects the daily confrontation with violence.

'SHOTE – G-ËRSHETË' (2024) embodies the historical figure of Shote Galica as a symbol of resistance and struggle against oppression. 'I counted 16 braids' (2024) highlights the need for unity among feminist voices across all cities of Kosovo. 'Property–Ownership' (2024) addresses women's property rights in Kosova and the inequality.

'1/6' (2022) is a protest performance that mention the names of victims and their murderers, demanding justice for the women who were killed. 'Our blood, your tax' (2022) is a protest against period poverty and the taxation of women's hygiene products.

multidisiplinare për gratë, vajzat e artistët e rinj që të zhvillojnë shprehjet e tyre artistike dhe të nisin të shfaqin aktivizmin brenda tyre.

"Pavarësisht krijimtarisë sime individuale, mungesa e avokimit përmes artit feminist dhe mbështetja për artistet e reja feministe në Kosovë ishte mjaft e dukshme, andaj dhe kam themeluar Indefinite Institute", tregon tutje ajo.

Kur arti bëhet thirrje për drejtësi

Çdo performancë e Ms. Indefinite është më shumë se një vepër artistike, vjen si një thirrje urgjente për veprim. "GËRSHETË" (2024) është një ekspozitë që përdor simbolikën e gërshetit për të paraqitur rezistencën feministe dhe fuqinë kolektive ndër shekuj. "Një kafshatë që nuk gëlltitet" (2024) është një performancë që paraqet përballjen e përditshme me dhunën. "SHOTE – G-ËRSHETË" (2024) mishëron figurën historike të Shote Galicës si simbol i qëndresës dhe i luftës kundër shtypjes. "16 gërsheta i numërova" (2024) nënvizon nevojën për unitet të zërave feministë në të gjitha qytetet e Kosovës. "Prona-Pronësia" (2024) trajton të drejtat pronësore të grave në Kosovë dhe pabarazinë.

"1/6"(2022) është performancë proteste që i përmend emrat e viktimave dhe vrasësve të tyre, duke kërkuar drejtësi për gratë e vrara. "Gjaku ynë, taksa juaj" (2022) është një protestë kundër varfërisë menstruale dhe tatimit ndaj produkteve higjienike për gratë. "Trëndafili yt ende vret" (2020) përdor simbolin e trëndafilit për të paraqitur dashurinë e shoqëruar me dhimbje e gjak. "Çohu" (2019) është një seri që përfaqëson qëndrimin feminist përballë shtypjes. "Përdhunuesit në burg" është protestë kundër dhunës seksuale dhe institucioneve që e mbulojnë atë. Pastaj, "Trupi im, zgjedhja ime, shteti im, zëri im" (2019) është një thirrje feministe në marshime paqësore për të drejtat e grave.

"Procesi artistik është i ndërlikuar", pohon ajo. "Jo vetëm konceptualisht. Teknikisht rrjedh nga mllefi, revolta, protesta dhe mbi të gjitha nga nevoja dhe detyra për reagim dhe kundërshtim artistik feminist - rrjedhimisht e tejkalon inspirimin dhe frymëzimin krijues", vazhdon tutje.

Në thelb të krijimtarisë së saj është bindja që arti ka rol transformues në shoqëri.

"Roli i artit në shoqëri ka qenë gjithmonë të sfidojë, dhe të thyejë kufijtë, qofshin ata estetikë, etikë, apo shoqërorë", thotë ajo. "Çështja kryesore nuk është nëse roli i artit duhet të njohë kufij, por nëse këta kufij kontribuojnë apo pengojnë transformimin shoqëror dhe fuqizimin e zërave të heshtur", vazhdon tutje ajo.

Ms. Indefinite nuk ofron zgjidhje. Ajo të përball me realitetin, dhe në këtë përballje, na kujton se ndonjëherë rezistenca më e fortë nis nga refuzimi për të pranuar një përkufizim.



'Your rose still kills' (2020) uses the rose as a symbol to depict love accompanied by pain and blood. 'Raise' (2019) is a series that represents the feminist stance in the face of oppression. 'Rapists to prison' is a protest against sexual violence and the institutions that condone it. Then, 'My body, my choice, my state, my voice' (2019) is a feminist call expressed through peaceful marches for women's rights.

"The artistic process is complex," she states. "Not only conceptually. Technically, it springs from anger, revolt, protest, and above all, from the necessity and duty to react and to resist through feminist artistic expression. Hence, it goes beyond mere inspiration or creative motivation," she continues.

At the core of her artistic practice lies the belief that art holds a transformative role in society.

"The role of art has always been to challenge and to break boundaries, whether aesthetic, ethical, or social," she says. "The key question is not whether art should recognize boundaries, but whether those boundaries contribute to or hinder social transformation and the empowerment of silenced voices," she adds.

Ms. Indefinite does not provide solutions. She confronts you with reality, and in that confrontation, reminds us that sometimes the strongest form of resistance begins with the refusal to accept a definition.

Zërat e "Zanave"

Një lidhje moderne me trashëgiminë muzikore

ALBERINA **HAXHIJAJ**

Janë mikesha që shumë vjet. Muzikën e kanë fijen me të fuqishme të lidhjes së tyre. Me ansamblin që i bashkon sjellin në jetë këngë të vjetra shqiptare. Rikthejnë melodi që thuajse kanë humbur, duke i transformuar e ringjallur. Zanat e respektojnë të shkuarën, e s'i druhen eksperimentimit.

Këngët që presin të këndohen

Rrëfimi për "Zanat" zë fill shumë vite para daljes së tyre të parë në skenë. Anëtaret e grupit njihen që nga shkolla e mesme dhe takohen pothuajse çdo ditë, duke ndarë ide, këngë dhe të qeshura. Ajo që i lidh nuk është vetëm muzika, por edhe miqësia e vjetër, kujtimet e përbashkëta dhe dashuria për këngët me të cilat janë rritur. Natyrshëm u kishte ardhur çdo herë të këndonin së bashku. Por e veçantë ishte dita, kur në vitin 2017, vendosën ta themelojnë ansamblin: në një dhomë të mbushur me zëra, instrumente dhe ëndrra të përbashkëta, duke kënduar këngë të vjetra shqipe.

Të gjitha anëtaret janë pjesë e Filarmonisë së Kosovës - një hapësirë ku ndërthuren përkushtimi artistik dhe madhështia. Mirëpo te "Zanat", ato gjetën diçka më afër zemrës së tyre. Diçka më personale dhe më afër motërzimit. Thonë se ishte momenti kur muzika nuk ishte vetëm tingull, por gjuha që i bashkoi. Ky bashkim – i qetë, i natyrshëm, por edhe i shenjtë për to – do të ishte themeli i asaj që erdhi më pas.

Sopranot Adelina Thaçi (e cila ka një vit që e ka lënë grupin) e Elida Kryeziu, bashkë me mexosopranot Arstina Kadiu e Diellza Sylejmani dhe alton Albana Piperku, janë më shumë se performuese. Ato janë ruajtëse të kujtimeve, kuratore të melodive që kanë humbur në botën muzikore. Botë kjo që ndryshon vazhdimit me shpejtësi. Në intervistën për PrishtinArt ato vendosën që të

The Voices of 'Zanat'

A Modern Bond with Musical Heritage

They have been friends for years. Music is the strongest thread that connects them. Through the ensemble that unites them, they bring old Albanian songs back to life. They revive melodies that were nearly lost by transforming and renewing them. 'Zanat' respects the past but does not fear experimentation.

Songs Waiting to Be Sung

The story of 'Zanat' began long before their first appearance on stage. The group's members have known each other since high school and still meet almost daily to share ideas, songs, and laughter. What binds them is not only music but also old friendship, shared memories, and a love for the songs they grew up with. Singing together always came naturally. But the day they decided to found the ensemble was special: in 2017, in a room filled with voices, instruments, and shared dreams, they started singing old Albanian songs.

All the members are part of the Kosova Philharmonic, a place where artistic dedication and grandeur meet. Yet with 'Zanat' they found something closer to their hearts, something more personal and sisterly. They say it was a moment when music was not just sound but a language that united

përgjigjeshin së bashku, me një zë.

"Na bashkoi pasioni i përbashkët për muzikën e vendit tonë, për tingujt që na rriten dhe historitë që ende jehonin brenda nesh. Por më shumë se kaq, ishte një thirrje e brendshme për ta ruajtur dhe për ta rishkruar historinë tonë përmes zërit të gruas".

Edhe emrin e kanë përzgjedhur me dashuri dhe kujdes. Në mitologji, Zanat janë krijesa legjendare, e për vajzat e grupit ato përfaqësojnë fuqinë e butë dhe të lashtë të gruas shqiptare. Si figura mitologjike që mishërojnë mençurinë, bukurinë dhe shpirtin e lirë, emërtimi i grupit sipas tyre ishte edhe një nderim, por edhe një deklaratë. Ndërsa zërat e tyre së bashku janë fuqia e grupit, njëlloj si zanat që janë më të fuqishme kur janë bashkë. Por është e vështirë t'i definosh brenda një zhanri.

Nuk janë as folklorike, as klasike. Një gërshetim i melodive të vjetra me vite, duke i aranzhuar e sjell në mënyrë moderne.

"Është si të dëgjosh jehonën e një kënge të harruar në mal, por që papritur shndërrohet në melodi të sotme. Një përzierje e shpirtit të vjetër me frymëmarrjen e kohës moderne", është përgjigjja poetike e tyre.

I qartë është fakti se rrënjët i kanë në traditë, gjersa bashkëkohorja lulëzon te degët. Një tandem i përkryer. Ato lehtësisht kapërcejnë nga një zhanër në një tjetër.

"E respektojmë të kaluarën, por s'i kemi frikë eksperimentet", thonë ato.

Repertori i tyre është i mbushur me këngë që janë më shumë si kujtime: ninulla të kënduara nga nënat, këngë dasmash, këngë lamtumirëse, festuese, por edhe të tilla që të kujtojnë humbjen. Disa prej tyre janë pasuar nga mentorët si them. This calm and natural but sacred bond became the foundation of what came next.

Sopranos Adelina Thaçi, who left the group a year ago, and Elida Kryeziu, together with mezzo-sopranos Arstina Kadiu and Diellza Sylejmani, and alto Albana Piperku, are more than performers. They are keepers of memories, curators of melodies lost in the fast-changing music world.

In their interview for PrishtinArt they speak with one voice:

"What united us was a shared passion for the music of our country, the sounds that raised us, and stories that still echo inside us. More than that, it was an inner call to preserve and rewrite our history through the voice of women."

Even their name was chosen with love and care. In mythology, 'Zanat' are legendary creatures, and for the girls in the group they represent the gentle and ancient strength of Albanian women. Like the mythological figures that embody wisdom, beauty, and a free spirit, the group's name was both an honor and a statement. Their voices combined are the strength of the group, just like the 'Zanat' who are stronger together.

Yet it is difficult to define them within a single genre. They are neither folkloric nor classical. Their sound is a blend of old melodies spanning years, arranged and presented in a modern way.

"It is like hearing the echo of a forgotten song in the mountains that suddenly transforms into a melody of today. A mix of old soul with the breath of modern times," they say poetically.

Their roots clearly lie in tradition while the contemporary element blooms on its branches. It is a perfect tandem. They easily move from one genre to another.

Musa Piperku, babai i Albanës, njohës i mirë i muzikës shqiptare e që vazhdon të jetë udhërrëfyes për vajzat.

Të tjerat janë zbuluar gjatë jetës së tyre, studimeve, nëpër incizime të vjetra që i kanë gjetur a përmes miqve që ua kanë prezantuar ato. "Frymëzimi vjen nga këngët që nuk këndohen më. Zgjedhim ato këngë që ndihen si të jenë duke pritur të ringjallen". Drejtohen nga ndjesia që e kanë nga brenda, e jo nga rregulli që mund të imponohet nga jashtë.

Kur tradita këndon

Çdo performancë është një ritual në vete, një paraqitje emocionale, e menduar me kujdes dhe në detaje. Në repertorin e tyre mund të gjeni këngë, si: "Mirëmrama" të Lorenc Antonit, këngën popullore "Kurrë më s'do marrësh udhët e kurbeteve",

"We respect the past but are not afraid to experiment," they say.

A Repertoire Full of Memories

Their repertoire is filled with songs that are more like memories: lullabies sung by mothers, wedding songs, farewells, festive songs, and also songs that recall loss. Some have been passed down by mentors such as Musa Piperku, Albania's father and a connoisseur of Albanian music, who continues to guide the girls. Others they have discovered during their lives, through studies, old recordings they found, or friends who introduced them to these songs.

"Inspiration comes from songs no longer sung," they emphasize. "We choose songs that feel like they have been waiting to be revived."

They are guided by an inner feeling rather than any imposed rules.

When Tradition Sings

Every performance is a ritual in itself, an emotional presentation carefully thought out in detail. Their repertoire includes songs such as "Mirëmrama" by Lorenc Antoni, the folk song "Kurrë më s'do marrësh udhët e kurbeteve," "Trëndelinë" by Thomas Simaku, "Kaj moj çiko" and "Po vijn' krushqit" by Kushtrim Gashi, and "Sa bukur" by Memli Kelmendi.

"Each song has its own story, emotions, and energy that connect us to it, carrying different feelings every time we perform. All of these are part of our identity," they say.

This emotional connection distinguishes their music. Their stage appearances are more than concerts; they are a musical journey that carries the audience along. Since their first appearance in 2017 at the DAM festival, they captured the public's attention.

One performance stands out as especially memorable: a summer night in Prishtina. They will never forget it. It was their first show in the city's main square. As they sang "Këngë moj," not a single person in the audience remained

"Trëndelinë" të Thomas Simakut, "Kaj moj çiko" dhe "Po vijn' krushqit" të Kushtrim Gashit dhe "Sa bukur" të Memeli Kelmendit.

"Çdo këngë ka historinë e vet, emocionet dhe energjinë që na lidh me të, duke na përcjellë ndjenja të ndryshme çdo herë që e interpretojmë. Të gjitha janë pjesë e identitetit tonë", thonë ato.

Është pikërisht kjo lidhje emocionale që e dallon muzikën e tyre. Paraqitjet e tyre skenike nuk janë veç koncerte, por një rrugëtim muzikor që të rrëmben me vete. Që me paraqitjen e parë në vitin 2017, në festivalin "DAM", tërhoqën vëmendjen e publikut.

Mirëpo e veçantë si perfomancë është interpretimi gjatë një nate vere në Prishtinë. Nuk do e harrojnë asnjëherë. Ishte paraqitja e tyre e parë në sheshin kryesor të qytetit. Gjersa këndonin "Këngë moj", nuk mbeti njeri nga publiku që nuk iu bashkua interpretimit të tyre.

"Menduam se kënga ishte harruar nga brezat e rinj", thonë ato. Por u binden për të kundërtën.

Zërat e tyre u shumëfishuan nga dhjetëra të tjerë, si dëshmi që këto këngë akoma i kanë për zemër të gjithë.

> *"Prishtina, me gjithë bukurinë dhe pasurinë e saj kulturore, është gjithmonë burimi ynë i frymëzimit dhe vendi ku ndiejmë lidhjen më të thellë me muzikën dhe historinë tonë", theksojnë anëtaret që me zërat e tyre kanë tundur skena nëpër vende të ndryshme të botës e të shumta i kanë pasur edhe paraqitjet me "Zanat".*

Sigurisht, rrugëtimi nuk ka qenë i lehtë. Është sfidë në vete të ringjallësh traditën në një kohë kur industria muzikore dominohet nga pop-i komercial dhe fama e shpejtë.

"Të bësh diçka ndryshe nuk është gjithmonë e lehtë", potencojnë ato. Por qëllimi i tyre i mban me këmbë në tokë. "Çdo pengesë e kemi shikuar si një provë për të qëndruar besnike ndaj vetes".

Për to është një ndjenjë e veçantë kur kanë mundësi që të kontribuojnë në kulturën e vendit, por janë të vetëdijshme që kërkohet guxim për të risjellë një frymë të re. "Ekziston një dashuri të madhe për artin, por gjithashtu ka nevojë për më shumë hapësirë për ta shprehur krijimtarinë që sfidon normat", potencojnë ato.

"Zanat" mendojnë se po ndërtojnë një urë mes së kaluarës dhe së ardhmes. "Duke e sjellë të vjetrën në një dritë të re dhe duke e bërë pjesë të frymës së re muzikore".

Ato janë në kërkim të mënyrave të reja për të përcjellë tinguj që nuk duhen harruar, e që meritojnë të dëgjohen edhe nga brezat që vijnë. Aktualisht, janë duke përgatitur një koncert të veçantë. Me tinguj që kapërcejnë kohën dhe me përkushtim që buron nga dashuria për traditën, ato vazhdojnë të rikthejnë në skenë një trashëgimi që rrezikon të harrohet. Muzika e tyre nuk është vetëm interpretim. Ajo është një dëshmi se edhe e vjetra mund të tingëllojë ndryshe, kur i jepet mundësia të frymojë nën ritmin e sotëm.

silent; everyone joined in the singing.

"We thought the song was forgotten by younger generations," they say. But they were proven wrong.

Their voices were multiplied by dozens of others, a sign that these songs still live in everyone's heart.

> *"Prishtina, with all its beauty and cultural wealth, is always our source of inspiration and the place where we feel the deepest connection to our music and history," the members say. They have touched stages around the world and have had many appearances as 'Zanat.'*

The journey has not been easy. It is a challenge to revive tradition at a time when the music industry is dominated by commercial pop and quick fame.

"Doing something different is not always easy," they point out. Their goal keeps them grounded. "We have seen every obstacle as a test of our loyalty to ourselves."

For them, it is a special feeling to contribute to their country's culture. They are aware that bringing a fresh spirit back takes courage.

"There is a great love for art but also a need for more space to express creativity that challenges the norms," they emphasize.

'Zanat' believe they are building a bridge between past and future: bringing the old into a new light and making it part of the new musical spirit.

They are searching for new ways to carry sounds that must not be forgotten and deserve to be heard by coming generations. Currently, they are preparing a special concert.

With sounds that transcend time and a devotion born from love for tradition, they continue to bring to the stage a heritage that risks being forgotten. Their music is not just performance; it is proof that even the old can sound new when allowed to breathe in today's rhythm.

SHPËTIM SELMANI:

Prishtina më dha guximin dhe lirinë e ëndrrave

Prishtina Gave Me the Freedom and Courage to Dream

GILI **HOXHAJ**

Është një nga ato personazhe të veçanta që kur e sheh kalimthi rrugëve të kryeqytetit, nuk të duhet shumë për ta kuptuar se është artist. Shpëtim Selmanin e takon shpesh në kafenetë e Prishtinës me një libër në dorë. Kamerierët e respektojnë. Selmanit i pëlqen të lexojë në mes të gjallërisë njerëzore që dokumenton jetesën. Mes cakërrimës së gotave dhe tingëllimës së monedhave metalike shpesh edhe ka shkruar. Shkruan poezi, prozë, dramë dhe publicistikë dhe, po ashtu, luan në teatër. Në poezi jep shumë nga vetja, shkruan për të kuptuar veten dhe për t`u kuptuar nga të tjerët. Në këtë intervistë tregon se nevoja për të shkruar ishte e pashmangshme; për raportin e tij me letërsinë dhe me lexuesit e huaj që i shprehin atij mirënjohjen për artin që u ka dhënë. Ai do që t'u takojë të gjithë. Selmani ka botuar disa libra, ndër ta edhe librin "Libërthi i dashurisë", i cili është vlerësuar me Çmimin e BE-së për Letërsinë në vitin 2020 dhe është përkthyer në disa gjuhë. Është nga ata që e përjeton letërsinë si akt të sinqeritetit absolut. Si një mjet për ta mbrojtur të vërtetën.

Veten si fëmijë e përshkruani më të tërhequr



FOTO **HAZIR REKA**

He's one of those distinctive figures who, when you catch a glimpse of him passing by through the streets of the capital, it does not take long to realize he is an artist. You will often see Shpëtim Selmani in the cafés of Prishtina, carrying a book in his hands. The waiters greet him with respect. Selmani enjoys reading amid the bustle of everyday life that chronicles the way of life. Even among the clinking of glasses and the jangling of coins, he often writes. Selmani writes poetry, prose, drama, and essays, and he also performs on theater stages. Poetry is where he gives most of himself; he writes to understand himself and to be understood by others. In this interview, he reflects on how the urge to write was inevitable, for his relation to literature, and to foreign readers who now write to him in appreciation for the art he's shared. He wishes he could meet them all. Selmani has published several books, among them The Booklet of Love, which was awarded the EU Prize for Literature in 2020 and has since been translated into several languages. He experiences literature as an act of absolute sincerity. A means of defending truth.

Prishtina më ka dhënë e i kam dhënë shumë dashuri

Prishtina Gave Me Love and I Gave It Back

You describe yourself as a slightly introverted child and as someone drawn to learning. Not unlike many who find solace in books and writing. That world was enough for you. What was your childhood like, and how did the need to write first arise? I suppose for true artists, it comes more as a necessity than a choice...

I was the first child in my family. I loved my grandmother deeply. My father's sadness always troubled me. I used to quarrel with my second sister. I loved books immensely. I loved my aunts too. I couldn't fall asleep unless I saw my mother's eyes closed. I learned a lot, even those lessons that hadn't yet been

FOTO KUSHTRIM TERNAVA

dhe të dhënë pas mësimit. Pak a shumë si shumë prej atyre që prehjen e gjejnë te shkrimi dhe librat. Kjo botë edhe u mjafton.
Cila ishte fëmijëria juaj dhe si lindi nevoja për të shkruar? Tek artistët e vërtetë besoj vjen më shumë si një nevojë se si dëshirë...

Kam qenë fëmija i parë. E kam dashur shumë gjyshen. Më ka shqetësuar mërzia në fytyrën e babait. Jam përleshur me motrën e dytë. I kam dashur librat shumë. Kam dashur hallat. Nuk kam fjetur nëse nëna ime i kishte sytë e mbyllur. Kam mësuar shumë. Edhe mësime që nuk shpjegoheshin ende. Jam larë në lumë. Kam qenë peshkatar i dobët. Kam qenë i dobët në lojëra. Jam rritur në një mes idilik, natyrisht në kuadër të një atmosfere të zymtë sociale, ekonomike, politike e shpirtërore. Por një gjë. Fëmijëria në natyrën e saj ka diamante. Po, se harrova. E di se nevoja për të shkruar ishte e pashmangshme, por nuk i di burimet e nisjes së saj.

Prishtina është qyteti juaj i studimeve, i jetës që bëni sot, familjes dhe shumë miqve. Cili ishte interaksioni i parë me Prishtinën? Çfarë ju dha Prishtina si qytet nga ditët e para deri tash?

Në ditët e para më ka dhënë shumë dashuri. Ngase nuk njiheshim edhe aq. Kisha lindur në Prishtinë dhe nga aty më kishin transferuar në spitalin gjinekologjik të Shkupit ngase me gjasë ishte një lindje e komplikuar. Sot e kam të paqartë raportin me Prishtinën. Ose më duhet ta ridefinoj. Vetveten dhe vetë Prishtinën e brenda saj fashizmin e sofistikuar kulturor. Por që më ka dhënë dhe i kam dhënë shumë, sidomos i kam dhënë shumë, nuk ka asnjë diskutim. Më ka dhënë dashuri. Muzikë. Njohje me njerëz të mrekullueshëm dhe letërsi natyrisht. I kam dhënë periudhën më të mirë të jetës sime. Lirinë dhe guximin e ëndrrave për të shpresuar për një ndërrim radikal të botës, gjithnjë duke pretenduar paqen dhe një harmoni të paanë.

Ju takoj shpesh kalimthi rrugëve dhe kafeneve më urbane të kryeqytetit. Cilat janë vendet ku ju krijoni më shumë në Prishtinë? A është kryeqyteti vendi prej nga keni krijuar më shumë apo primatin e mban një qytet tjetër?

Kam lexuar shumë letërsi te Kafja e Vogël, po ashtu kam një cikël vjershash shkruar aty. Derisa jashtë binte shi. Dhe as nuk kisha ku të shkoja e as nuk kisha çfarë të bëja. Kam lexuar, po ashtu, shumë vjet në Strip Depot, në Tingle Tangle e në Dit' e Nat. Më pëlqen të lexoj derisa dëgjoj cakërrimën e gotave dhe tingëllimën e monedhave metalike. Më pëlqen të lexoj në mes të gjallërisë njerëzore që dokumenton jetesën. Tani fatkeqësisht, por gjithnjë nën rrjedhën e gjërave që nuk ndalen, Prishtina ka ndërruar edhe energji, edhe frymë. Gjithnjë sipas mendimit tim. Dhe nuk dua ta gjykoj këtë rrjedhshmëri. Natyrisht brenda krijimeve të mia Prishtina dhe fshati ku jam rritur janë pika që më

taught. I bathed in the river. I was a poor fisherman. I wasn't good at games either. I grew up in an idyllic setting though wrapped in a bleak social, economic, political, and spiritual atmosphere. But one thing: childhood, by its very nature, holds diamonds. Ah, I almost forgot. I know the need to write was inevitable. I just don't know where it began.

Prishtina is the city of your student years, where you live today, where your family is, and where many of your friends are. What was your first encounter with Prishtina? What has the city given you from those early days until now?

In the beginning, it gave me so much love. It is perhaps because we didn't know each other all that well. I was born in Prishtina, and from there I was transferred to the gynecological hospital in Shkup, as it must have been a complicated birth. Even today, my relationship with Prishtina feels unclear. Or maybe it needs to be redefined, both myself and the city, along with the subtle forms of cultural fascism that are embedded within it. But there is no arguing that Prishtina gave me a great deal, and I gave just as much. It gave me love. Music. Encounters with wonderful people, and, of course, literature. I gave it the best years of my life. The freedom and courage to dream, to yearn for a radical transformation of the world, always in the pursuit of peace and a boundless harmony.

I often spot you briefly along the busiest streets and cafés of Prishtina. Which places in the city do you find yourself creating in the most? Is Prishtina where you have done most of your writing, or does another city hold that distinction?

I've read a lot of literature at Kafja e Vogël, and I even wrote a cycle of poems there. Outside, it was raining. I had nowhere else to go and nothing else to do. For many years, I also spent time reading at Strip Depot, Tingle Tangle, and Dit' e Nat. I like reading

kanë formësuar dhe më kanë dhënë ndjeshmërinë, edukatën dhe rreptësinë e pikëpamjeve në kuadër të një bote që natyrisht është shtëpia jonë, e të gjithëve.

Shkruani prozë dhe poezi, si e ndani njërën prej tjetrës. Çfarë mundësie shprehjeje ju jep njëra e nuk iu jep tjetra?

Kohëve të fundit më vjen pak turp që ende shkruaj poezi. Kur rilexoj disa gjëra që i kam shkruar shumë vite më parë e pyes veten çfarë dreqin kam pasur? Është një proces gati i mistershëm, i pakuptueshëm dhe i pandalshëm që ndodh brenda trurit të një qenie njerëzore.

Kurrë nuk e kam shkruar poezinë, sepse kam dashur të arrij diçka më të. Kurrë nuk e kam aspiruar letërsinë për një gjë të caktuar. Ka qenë brenda meje. Është aty. Dhe ndonjëherë nuk më intereson fare prezenca e saj. Ndonjëherë kërkoj ta di kuptimin e kësaj pranie. Viteve të fundit më shumë përmes prozës.

Keni thënë që shkruani kur nuk keni shteg tjetër. Shkrimtarët e vërtetë shkruajnë pa sforcim. Si është procesi juaj i shkrimit? A jua garanton qetësia një proces më të mirë të shkrimit apo keni shkruar ngado?

Kam qenë pjesë e programeve të ndryshme letrare nëpër Evropë. Dhe më lejoni të ndaj diçka me ju. Në një kështjellë përrallore të një fshati zviceran Lavigny, ish-pronë e njërit nga botuesit më të mëdhenj gjermanë, qëndrova një muaj. Shkrova sall dy poezi. Njëra prej tyre tejet e dobët. Qetësia në vetvete ishte letërsi. Letërsia jashtë saj ishte kërcënuese. Ka kritikë që e shohin letërsinë time si letërsi të programeve letrare. Fare nuk më vjen keq. Në Prishtinë nuk ia dal të bëj asgjë. Mbijetesën e kam armik. Nuk e di se si është të jetosh nga letërsia, nga të zgjuarit në orën shtatë të mëngjesit, pranë një filxhani të madh kafeje dhe nën cicërimën e zogjve, pranë një kroasanti të mrekullueshëm, të nisësh e të shkruash sikurse shumë shkrimtarë while hearing the clinking of glasses and the jingle of metal coins. I enjoy reading amid the lively hum of everyday life that chronicles the rhythm of living. Unfortunately, now Prishtina, driven by the course of things that are incessant, has changed both its energy and spirit. At least, that's how I see it. I don't want to judge this ongoing change. Of course, in my works, both Prishtina and the village where I grew up are the places that shaped me, giving me sensitivity, upbringing, and firmness of perspective within a world that is, naturally, our home, all of us.

You write both prose and poetry. How do you distinguish between the two? What does one allow you to express that the other does not?

Lately, I've been feeling a bit embarrassed that I still write poetry. When I reread some things I wrote many years ago, I ask myself, what on earth was I thinking? It's an almost mysterious, incomprehensible, and unstoppable process that happens inside the mind of a human being. I've never written poetry because I wanted to achieve something greater. I never pursued literature with any particular goal in mind. It was just inside me. And sometimes, I don't care about its presence at all. Other times, I try to figure out the meaning of this presence. In recent years, I've explored this more through prose.

You said you write when you have no other way out. True writers write naturally, without forcing themselves. What is your writing process like? Does a quiet environment help you write better, or have you written anywhere and everywhere?

I have participated in several literary programs across Europe. Let me share something with you. I stayed for a whole month in a fairy-tale castle in a picturesque Swiss village called Lavigny, which once belonged to one of the biggest German publishers. During that time, I wrote only two poems, and one of them turned out quite poor. The quiet itself was literature. Literature outside of it felt menacing. Some critics view my work as literature of literary programs. I don't mind at all. In Prishtina, I can hardly get anything done. Survival is my enemy. I don't really know what it means to make a living from literature, to wake up at seven in the morning beside a big cup of coffee, with birds singing nearby and a wonderful croissant on the table – then start writing, as many writers who enjoy this privilege do. Of course, many others don't have such a seemingly carefree life.

The writing process reveals the secrets of oneself. It helps you understand them better. Sometimes, you even laugh at yourself when you read something you wrote a long time ago. Do you write more to understand yourself or to be understood by others?

Both.

Your book 'Booklet of Love' earned you the European Union Prize for Literature and has been published in several languages. What has been the journey of your books beyond Kosovo, and how have foreign readers received them?

The 'Booklet of Love' has been translated and published in German, French, Bulgarian, and Macedonian. The ensuing book, 'The Ant's Ballad', has been translated and published in Italian. So far, I've received the most feedback and appreciation from Italian readers, which makes me happy. I would love to meet them all. Some of them even think that I'm as famous as Salman Rushdie. They say, "If you pass through Rome, stop by for a beer." Meanwhile, I find myself

që e gëzojnë këtë privilegj. Natyrisht edhe shumë të tjerë nuk e kanë këtë jetë kaq të bukur në dukje.

Procesi i shkrimit t'i nxjerr edhe të fshehtat e vetes. I kupton më mirë ato. Ndonjëherë edhe të qeshet me veten kur i lexon pas shumë kohësh.
A shkruani më shumë për të kuptuar veten apo për t'u kuptuar nga të tjerët?

Të dyja palët.
Me "Libërthin e dashurisë" u shpërblyet si fitues i Çmimit Evropian për Letërsi, i cili është botuar dhe në disa gjuhë.
Cilat kanë qenë rrugëtimet e librave tuaj përtej Kosovës dhe si lexohen nga lexuesit e huaj?

"Libërthi i dashurisë" është përkthyer e botuar në gjermanisht, frëngjisht, bullgarisht dhe maqedonisht. Libri tjetër pasues "Balada e Buburrecit" është përkthyer e botuar në italisht. Deri tash më së shumti reagime dhe mirënjohje kam pasur nga lexuesit italianë. Më bëhet qejfi. Dua t'i takoj të gjithë. Disa nga ta mendojnë se jam i famshëm po aq sa le të themi Salman Rushdie. Më thonë: "po të kalosh këndej nga Roma, ndalu për një birrë".

Ndërkohë unë gjendem mes një kaosi makinash në përpjekje për të gjetur një parking. Apo në mes habish për çmimet e fryra të faturave.

Ndonjëherë të krijuarit konsiderohet edhe si luks i kohës dhe besoj ndodh edhe me ju. Cila është vlera më e madhe që duhet t'i japim letërsisë për t'i mbajtur krijuesit e lirë?

Mendoj se duhet të jemi të sinqertë në raport me të. Kaq. Çdo gjë tjetër është e diskutueshme.

E shoh figurën e babait tuaj në shumë krijime. Babai si njeriu që ju mundësoi kontaktin e parë me librat duket që ka pasur ndikim të madh te ju. E lexoj më shumë si një relacion me shumë peshë dhe babai ishte idealist dhe punëtor i madh. Në poezi e lexoj një peng që nuk e keni përqafuar në shumë momente së bashku. A është kjo, apo diçka përtej?

Po kjo është e vërtetë ne jetojmë të vetëdijshëm mbi fatet e prera, fatet e këputura njerëzore. E dimë se në çdo moment mund të ndodhë diçka. Jetojmë në një frikë të përhershme për humbjen e njëri-tjetrit. Për hiçësinë tonë. Dhe nuk përqafohemi. Por përkundrazi e luftojmë njëri-tjetrin. Është absurde. Por kështu është. Absurditeti është dominant.

Shoh ndonjëherë indinjatë në shkrimet tuaja. Por dhe humor të hollë. Si funksionojnë bashkë në shkrim?

Nuk më pëlqejnë librat që kanë tone të ashpra serioziteti. E kam thënë edhe më herët. Kam lexuar një libër të John Fantes, "Full of Life" (Mbushur me jetë). Është libër i hatashëm që i përgjigjet mrekullisht pyetjes suaj. Kam qenë i pikëlluar dhe kam qarë për shkak se e kreva librin. Kam qarë po ashtu ngase e kam të pamundur ta lexoj dy herë të njëjtin libër.

stuck in traffic chaos, struggling to find a parking spot or marveling at the inflated prices on bills.

Sometimes, creativity is seen as a luxury of time, and I guess you feel the same way. What do you think is the most important value we should ascribe to literature in order to keep creators free?

I believe we just need to be honest in our relationship with it. That's all. Everything else is open to debate.

I notice the figure of your father in many of your works. As the person who first introduced you to books, he seems to have had a profound influence on you. I read this relationship as a weighty one – your father was an idealist and a tireless worker. In your poetry, I sense a certain regret, as if you feel you didn't embrace him enough despite the many moments you shared. Is that accurate, or is there something deeper?

Yes, that's true, we live fully aware of shattered, broken fates. We know that at any moment something can happen. We live in a constant fear of losing one another, of our own insignificance. Yet, we do not embrace each other. On the contrary, we fight each other. It's absurd, but that is how it is. Absurdity prevails.

I sometimes sense indignation in your writings, but also a subtle, sharp humor. How do these two coexist and work together in your writing?

I don't like books that carry harsh tones of seriousness. I've said that before. I once read John Fante's Full of Life. It is a remarkable book that offers a wonderful answer to your question. I was deeply moved and even cried when I finished it. I also cried because I know I can never read the same book twice.

Në cep të qytetit **"Open Art"** dhe vizioni i një artisti

In a Corner of the City **"Open Art"** and the Vision of an Artist

ELVIRA BERISHA

Në cep të qytetit, rreth 3 kilometra larg zhurmës së qendrës, një shtëpi është shndërruar në galeri. Kjo qendër arti është bërë pikë referuese për lagjen e qetë të "Vneshtave", ku artdashësit kanë gjetur strehë, e ku arti nuk është vetëm ekspozim por përjetim i përbashkët. Galeria "Open Art" nuk është hapësirë e zakonshme; është produkt i një rruge të gjatë, shpesh të dhimbshme, por të ndërtuar me përkushtim dhe dashuri të palëkundshme ndaj artit.

Në qendër të këtij rrëfimi të sinqertë dhe me sfida është artisti dhe drejtuesi i galerisë, Naim Spahiu.

I udhëhequr nga modestia që e karakterizon, Spahiu shpalos rrugëtimin si krijues dhe themelues i një prej hapësirave më të veçanta të artit bashkëkohor në vend. I lindur në Mitrovicë më 1978, Spahiu diplomoi për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës në klasën e profesorit Esat Valla dhe më pas përfundoi magjistraturën në të njëjtën fushë. Që nga viti 2003 punon në Galerinë Kombëtare të Kosovës, ku ka shërbyer si koordinator për ekspozita e udhëheqës i institucionit. Veprat e tij gjenden në koleksione private e shtetërore brenda dhe jashtë Kosovës, përfshirë Muzeun e Glaisdorfit në Austri.

Krenaria e një lagjeje

Galeria "Open Art" ka nisur si një eksperiment, por shumë shpejt është shndërruar në nevojë të komunitetit artistik dhe edukativ.

"Kur e hapëm për herë të parë më 2011, ishim në një bodrum. E dimë që nuk ishte ideale, por kishim një vizion, të krijonim një hapësirë të hapur, të vërtetë, për artistët", nis rrëfimin Spahiu.

Ishte një përpjekje që kërkonte përkushtim të jashtëzakonshëm, e sfidat e asaj kohe ishin goxha të mëdha.

"Në një rast, për një ekspozitë të madhe, ma ndërprenë rrymën. E pagova

In a corner of the city, about 3 km away from the hum of the center, a house has been transformed into a gallery. This art center has become a reference point for the tranquil neighborhood of "Vneshtat" – a place where art lovers have found a shelter and where art is not just an exhibition, but a shared experience. The "Open Art" Gallery is not a typical space; it is the product of long journey– often painful one–built on commitment and unwavering love for art. At the heart of this sincere story is Naim Spahiu, artist and direc-tor of the gallery.

Guided by his distinctive modesty, Spahiu displays his journey as a creator and founder of one of the most distinc-tive contemporary art spaces in Kosova. Born in Mitrovica in 1978, Spahiu graduated in painting from the Faculty of Arts at the University of Prishtina, in the class of Professor Esat Valla. He later finished his master's studies in the same field. Since 2003, he has worked at the National Gallery of Kosova, where he has served as both exhibition coordinator and director of the institution. His works are held in private and public collections in Kosova and abroad, including the Museum of Glaisdorf in Austria.

The Pride of a Neighborhood

The "Open Art" Gallery begun as an experiment, but soon became

nga xhepi, 500 euro, borxhin e dikujt tjetër. Nuk doja ta anulonim ekspozitën".

Përvoja e rëndë financiare çoi në mbylljen e galerisë më 2014, pas vetëm tri vitesh funksionimi. Për Spahiun ajo qe periudha më e vështirë si artist. Zhgënjimi ishte i madh, por artisti nuk dorëzohet lehtë. Pas fiks një dekade, më 2024, vendosi ta ringjallë galerinë - këtë herë në një shtëpi të re, në lagjen "Vneshta" në periferi të Prishtinës.

"E mira është që aty pasioni im i kamotshëm është përmbushur. Mu krijuan mundësitë që sot të jem shumë i qetë dhe rehat me atë që ofroj për artistë me hapësirë komode. Edhe lagjja po mburret që ka galeri, qendër edukative dhe një pikë referuese", thotë ai. Një pjesë e shtëpisë së tij është kthyer në qendër ekspozimi, edukimi dhe bashkëbisedimi mes krijuesve. Në vitin e dytë të funksionimit, "Open Art Gallery" ka në planprogram 6 ekspozita. Së fundmi, galeria u bë nikoqire e veprave të artistit të njohur kosovar, Esat Valla, të përmbledhura nën ekspozitën "Arti pamor si rezistencë (1990–1999)". Janë gjithsej 17 vepra që janë ekspozuar nën kurimin e Zeni Ballazhit, në të cilat dominon koka e demit si një simbolikë e fuqishme për rezistencën e asaj periudhe kohore.

"E ka përshkruar komplet ngjarjen e vuajtjeve të shqiptarëve brenda asaj periudhe. Janë punime që s'janë parë në tërësi, ndoshta aty-këtu ndonjë, por jo si ekspozitë. Pati shumë jehonë, ekspozita është shumë e mirë dhe vlen të shihet", thotë Spahiu. Janë edhe 4 ekspozita të tjera me të cilat do t'i mbajë dyert e hapura galeria "Open Art".

"Notues i kohës"

Bagazhi artistik i Naim Spahiut peshon fiks 15 ekspozita personale, nga të cilat 8 ndërkombëtare, si dhe prezantim i veprës së tij në mbi 100 ekspozita kolektive në Kosovë dhe në vende të ndryshme të Evropës.

a necessity for the artistic and educational commu-nity.

"When we opened for the first time in 2011, it was a cellar. We knew it wasn't an ideal place to begin with, yet we had a vision to create an open space for artists", Spahiu begin his story.

It was an effort that required unusual dedication, and the challenges at that time were enormous.

"On one occasion, the electricity was cut. I paid around 500 euros to cover someone else's debt. I didn't want to cancel the exhibition."

The severe financial difficulties led to the gallery's closure in 2014, after three years of operation. For Spahiu, this was the most trying period as an artist. It was a bitter disap-pointment, yet an artist never gives up easily. A decade lat-er, in 2024, he managed to reopen the gallery – this time in a new house, located in the "Vneshta" neighborhood just on the outskirts of Prishtina.

"The good part is that my long-held passion has been ful-filled. I now have the opportunity to work quietly and confi-dently with what I offer artists. Even my neighborhood takes pride in having a gallery, an educational center, and a refer-ence point," he says.

A part of his house has been transformed into an exhibition and educational center – a space for dialogue between art-ists. In the second year of its operation, the "Open Art" Gal-lery is hosting six exhibitions. Recently, the gallery present-ed the works of the well-known artist, Esat Valla, featured in the exhibition "Visual Art as Resistance (1990-1999)." It has 17 works curated by Zeni Ballazhi, most of which prom-inently featured the head of a bull – a powerful symbolism of resistance of that time.

"It encapsulated events and suffering of Albanians back then. These are works that had not been fully exhibited be-fore, save for a few of them shown here and there, but never as a complete exhibition. It made some echo – it is a strong exhibition and well worth visiting", says Spahiu. There are four other exhibitions currently in the "Open Art" gallery.

"Time Swimmers"

The artistic oeuvre of Naim Spahiu consists of 15 solo exhi-bitions—8 of which are held internationally—as well as par-ticipation in over 100 group exhibitions in Kosova and abroad.

"An artist must find time regardless of daily obligations. We are not

"Artisti duhet ta gjejë kohën, pavarësisht obligimeve të përditshme. Ne nuk jemi mësuar të jetojmë si artistë të lirë, për këtë duhet komoditet financiar që shumica nuk e kanë. Prandaj duhet të punojmë, të japim mësim ose të mbajmë pozita të tjera. Por nëse ke një qëllim dhe ia ke dedikuar vetes, atëherë s'ka vend për lodhje. Duhet të ecësh përpara, mendja gjithmonë do të pyesë: çfarë do të krijosh tjetër, si do t'i afrohesh publikut?". Spahiu aktualisht është përgjegjës për ekspozita dhe koleksione në Galerinë Kombëtare të Kosovës, institucion ku ka shërbyer edhe si ushtrues detyre i drejtorit në vitet 2020–2021. Për të, roli i një artisti nuk është i ndarë nga përkushtimi profesional dhe as nga vetë jeta.

"Kam pasur një përparësi krahasuar me të tjerët, sepse punoj në një institucion ku kam qasje në vepra, informacione, kontakte e vlera. Kjo më ndihmon të ndërtoj një botëkuptim më të gjerë dhe të punoj me veten që të dal si vetja – jo si kopje e dikujt tjetër".

Pas studimeve, Spahiu nisi të ndërtojë një identitet të vetin krijues. Vepra e tij gjeti sukses në skenën vendore dhe ndërkombëtare, një nga muzetë në Austri përfshin punimet e tij në koleksion. Por për të, kjo s'mjafton.

"Artisti nuk duhet të vetëkënaqet. Arti është gjithëpërfshirës. Unë nuk dua të shpjegoj veprat e mia, dua të shkaktoj emocion. Nëse vepra shkakton ndjesi dhe dikush komunikon me të, qëllimi im është përmbushur. Unë jetoj edhe me emocionet e të tjerëve, jo vetëm me të miat."

Një nga temat që e shoqëron qëmoti në punën e tij është koha, ndryshimet e periudhave. Prandaj dhe ciklin e fundit e ka titulluar "Time Swimmers" (Notuesit e Kohës) si përgjigje ndaj dinamikës së madhe me të cilën sfidohet njeriu ditëve të sotme. "Në çdo vend, në çdo punë që e bën, dhe unë gjithë njerëzit që jetojnë

accustomed to living as free artists, because that re-quires financial stability— something most people can't af-ford. That's why we have to work, to teach, or to do other jobs. But if you have a goal and you strive toward it, there's no room for giving up. You have to keep going, always won-dering: What else can I create? How do I approach the pub-lic?"

Spahiu is currently responsible for exhibitions and collec-tions at the National Gallery of Kosova, where he also served as acting director during 2020-2021. For him, the role of the artist is inseparable from professional commitment—nor from life itself.

"I had an advantage compared to others, because I work in an institution that gave me access to artworks, information, contacts, and many other resources. That helped me build a broader perspective and work on being myself—not a copy of someone else."

After completing his studies, Spahiu began developing his own creative identity. His work has achieved success both locally and internationally, and was included in a collection by an Austrian museum. But for him, that is not enough.

"An artist shouldn't be self-satisfied. Art is all-encompassing. I don't want to explain my works—I rather want to trigger emotions. If my work stirs something in someone and they find a way to connect with it, then my goal is fulfilled. I live through the emotions of others, not only my own."

One of the most enduring theme in his work is time—its passage and the shifting of eras. That's why he titled his most recent cycle "Time Swimmers," as a response to the in-tense dynamics that modern humans are facing.

"In every place and every work, I call people on Earth as 'time swimmers,' because you need to be a good swimmer to succeed and reach your goals. A swimmer must find the perfect moment—otherwise, he will be drown. Everyone fol-lows their own course, a dynamic I relate to transition, war, past experiences, traumas—everything our people have faced. But in the end, you have to be a swimmer to reach your destination," he says.

All of Spahiu's creation are related to everyday life and carry the viewer into endless waters, where imagination grows constantly. His work unfolds in a style close resembling ab-stract impressionism, though figuration is also present. There are swimmers, nudes, mothers, bicycles.

"There's meaning in every detail. I truly love drawing, love color, and I attempt to instill drama, emotion—to reveal something rather than just play with colors," he says.

Two of his most recent exhibitions marked a conceptual shift in his artistic activity. "My latest exhibition was a pro-ject I kept secret for more than a year. I didn't want to share it with anyone—so I could stir some curiosity, not just sup-port." The exhibition, entitled "Behind the curtain there are other curtains", opened in June 2024.

For this installation, Spahiu

në rruzullin tokësor i quaj notues të kohës, se duhet me qenë notues i mirë me pas rezultat dhe me i mbërri qëllimet e tua. Notuesi duhet ta gjejë kohën, përndryshe fundoset, dhe të gjithë janë në drejtimet e veta, dinamikë që unë e lidh me tranzicionin, luftën, përjetimet, dhunimet e gjithçka që ka përjetuar ky popull. Por prapëseprapë, rezultati final patjetër duhet me qenë notues për me mbërri cakun që ia ke vënë vetes", thotë ai.

E gjithë krijimtaria e tij lidhet me përditshmërinë dhe çon në ujëra të ndryshme pa kufi, ku imagjinata sa shkon e zhvillohet. Veprat e Spahiut prezantohen në impresionizëm abstrakt, por brenda tyre ka figuracion. Shihen notues, nudo, figura të nënave e fëmijëve, biçikleta.

"Ka shpjegim që mund ta shohësh në çdo detaj, sepse e dua shumë vizatimin, koloritin dhe mundohem të ketë dramë, emocion, por edhe të shihet diçka e jo të luhet vetëm me koloritin", thotë ai.

Dy ekspozitat e fundit kanë shënuar një kthesë konceptuale në krijimtarinë e tij. "Ekspozita e fundit personale ishte një projekt që e kam mbajtur sekret për më shumë se një vit. Nuk kam dashur ta ndaj me askënd, që kur të hapej, të shkaktonte kureshtje e jo vetëm mbështetje". Ekspozitën e titulloi "Behind the curtain there are other curtains" dhe e hapi në qershor të vitit 2024. Në këtë instalacion, Spahiu mbuloi hapësirën para shtëpisë së tij me skelet metalik dhe tela, duke krijuar një "shtëpi-pikturë". Materiali kryesor ishte cerada, një element që lidhej me përjetimet e refugjatëve shqiptarë gjatë viteve të luftës. Cerada të mbledhura nga varrezat e kamionëve nëpër Kosovë, të gërvishtura, të baltosura, por të ngarkuara me histori.

"Përtej perdes ka perde të tjera. Ndonjëherë, pas një perdeje ka vetëm një fund, por ndonjëherë fshihet diçka tjetër. Çdo gërvishtje në ato cerada tregon një përjetim të së kaluarës, një emocion." Është i bindur se kjo ekspozitë vërtet ishte prezantim më ndryshe. "Janë kilometra të tërë që kanë bërë ato cerada të kamionëve, sepse kanë bartur refugjatë, kanë mbuluar refugjatë, kanë mbuluar shatorre. Secila gërvishtje ka emocionin e vet dhe tregon një përjetim të së kaluarës. Ka qenë e vështirë t'i gjej, sepse nuk kam dashur që cerada të ishte e pastër, por ta nxjerr nga balta dhe t'i lë gjurmët që kanë mbetur – gjurmët e kohës. Kjo më ka plotësuar idenë e komplet rrugëtimit, duke më dërguar në një dimension krejt tjetër, që të tejkalojë edhe vetveten," thotë ai. Në nëntor të vitit 2024, Spahiu u paraqit për herë të parë me ekspozitë personale në Tiranë, në galerinë "GOCAT – Center for Contemporary Art" në hapësirat e Piramidës, me instilacionin "Behind the walls there are other walls", që ishte vazhdimësi konceptuale e ekspozitës në Prishtinë, por i përshtatur me ambientin e ri, një hapësirë që i dha veprave një pamje si muze. E aktualisht, Spahiu është i përqendruar në përfundimin e doktoratës dhe në krijimin e hapësirave që u shërbejnë artistëve të rinj, duke i parë këto si mënyra për të kontribuuar më gjerësisht në skenën artistike. Nuk ka ndonjë plan të caktuar profesional për momentin, por i lë gjërat të vijnë natyrshëm. Ai është notues i kohës që nuk ndalet, që sfidon vetveten, dhe që e sheh artin si një udhëtim që nuk ka finish.

transformed the space in front of his house using a metal frame and wire, thus creating a "house-painting." The main material used was tent canvas—an element that relates to the experiences of Albanian refu-gees during the war. These were real tent covers taken from transport trucks—scratched, weathered, stained— yet heavy with history.

"Beyond the curtain there are other curtains. Sometimes, a curtain hides an end, but other times, it conceals something else. Every scratch speaks of a past experience, of an emo-tion." He believes this exhibition was truly a different presentation.

"These truck tents traveled for so many kilometers, carrying refugees. Every scratch has its own emotion and reveals a story from the past. It was hard to find them—I wanted tents that weren't clean, that had to be unearthed from the dirt, showing their scars—scars of time. That completed the journey of the idea, enabling me to shift into a different di-mension, to surpass myself," he says.

In November 2024, Spahiu held his first exhibition in Tira-në, at "GOCAT – Center for Contemporary Art", housed within the Pyramid. There, he showcased "Behind the walls there are other walls", a conceptual continuation of the Prishtina exhibition, adapted to a new setting—a space that gave his work a more museum-like appearance.

Currently, Spahiu is focused on completing his PhD and creating new spaces to support emerging artists, considering these efforts as ways to actively contribute to the art scene. He has no fixed professional plan at hand; instead, he let things come spontaneously. He is a swimmer through time—never still, always challenging himself—and sees art as a journey with no end.

Engji Jaha, zëri i veçantë i brezit të ri në artin kosovar

Engji Jaha, The Distinct Voice of Kosova's New Artistic Generation

ELVIRA BERISHA

Lidhja me artin për piktoren Engji Jaha ka qenë një proces i natyrshëm, thuajse i paracaktuar. Ajo e përshkruan si vazhdimësi të përditshmërisë në një familje ku arti nuk është vetëm aktivitet kreativ, por mënyrë jetese.

"Unë vij prej një familje artistësh dhe fatmirësisht gjyshen e kam piktore. Ka qenë shumë e lehtë futja në botën e artit, se gjithmonë pas ngrënies së mëngjesit e kemi rregulluar tavolinën dhe i kemi marrë në dorë brushat", thotë ajo. Gjyshja e saj, Luljeta Goranci, është një emër i njohur për veprat e saj të punuara mbi qeramikë, "portrete në pjatë" - një formë arti që Engji e kujton me një ndjenjë të përzier adhurimi dhe mirënjohjeje. E rritur në këtë frymë, Engji e ndien veten me fat për trashëgiminë shpirtërore që jo vetëm e ka frymëzuar, por e ka udhëhequr drejt formimit të saj si artiste. Për të, arti është udhëtim i brendshëm dhe reflektim i vetes përmes portreteve shumëngjyrëshe. Kjo lidhje e hershme me artin, e përforcuar nga kërkimi i vazhdueshëm stilistik dhe ideor, e ka shndërruar Engjin në një zë të veçantë të brezit të ri të artistëve vizualë në Kosovë. Në një bisedë të çiltër, si vetë natyra e saj, ajo rrëfen rrugëtimin e deritanishëm artistik dhe hap botën e brendshme krijuese, aty ku ka gjetur strehë dhe ku ndihet më së miri në botë.

Rrëfimi shumëngjyrësh: "Nga 'Selfi Mundi' te 'Ti si dikur'"

E lindur në Prishtinë, Engji Jaha përfundoi shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, periudhë gjatë së cilës

For the painter Engji Jaha, the bond with art has been a spontaneous, nearly preordained process. She calls it as a continuation of daily life in a family where art was not merely a creative activity, but a way of life. "I sprung from a family of artists, and fortunately, my grandmother is a painter. It was pretty easy to set foot into the world of art. Every day after we finished breakfast, we would arrange the table and pick up brushes," she says.

Her grandmother, Luljeta Goranci, gained recognition for her ceramic artworks, "portraits on plates", a form of art Engji recalls with feelings ranging from admi-ration to gratitude.

Raised in this spirit, Engji feels lucky for the spiritual legacy that not only was a source of inspiration, but also led her through her artistic development. For her, art is an inner journey and a reflection of the self through variegated por-traits. This early bond to art, bolstered further by her incessant stylistic and concep-tual quest, has made Engji a distinct voice in Kosova's new generation of visual artists.

In an honest conversation that unfolds as honestly as her nature, she evokes her artistic journey so far and unravels her inner creative world, the very place she has found shelter and where she feels so comfortable.

A Colorful Tale: From 'Selfi Mundi' to 'Ti si dikur'

Born in Prishtina, Engji Jaha

filloi të zhvillonte ndjeshmërinë ndaj krijimtarisë pamore. Në vitin 2016, nisi studimet në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, në degën e pikturës, ku më pas përfundoi edhe studimet master në vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe, Engji ka dhënë mësim në fushën e vizatimit dhe të pikturës, duke asistuar profesor Faton Kryeziun, përvojë që e thelloi më tej lidhjen e saj me artin.

Në qershor të vitit 2020, kur pandemia kishte mbyllur dyert e galerisë dhe kishte ngritur pragun e ankthit, Engji Jaha vendosi të hapë ekspozitën e parë personale. Titullohej "Selfi Mundi" dhe u mbajt në Galerinë e Ministrisë së Kulturës.

"Ka qenë shumë e mirë, besoj se kanë qenë rreth 25 autoportrete. Pata vendosur që ta pikturoj veten në dimensione të ndryshme, qysh njerëzit më kanë parë dhe qysh e kam parë unë veten", kujton ajo. Kur flet për këtë ekspozitë, sytë i ndriçojnë: e di që ishte e rëndësishme, jo vetëm si moment, por si provë para publikut. "Mendoj që ekspozita e parë është një lloj vule që e merr prej njerëzve, a po të pranojnë, apo jo", thotë ajo.

Edhe pse e mbajtur në mes të frikës nga virusi famëkeq, me maska dhe doreza, për Engjin kjo ishte një nga kujtimet më të bukura.

"Jam tip i dashur dhe ka qenë e dhimbshme se s'kam mundur t'i përqafoj apo t'ua jap dorën, por jam falënderuese që kanë ardhur. Edhe pse periudhë e keqe, për mua është kujtimi më i bukur", kujton Engji.

Ajo i përket një brezi të artistëve të rinj që nuk kanë frikë ta përballin realitetin përmes ironisë, lojës, humorit dhe ngjyrës, por edhe thellësisë filozofike që rrjedh nga vetë përjetimi personal. Në ekspozitën "Selfi Mundi" ajo shfaqet 25 herë në autoportrete por çdo herë ndryshe. Në një pikturë luan kazino me dy burra, një lloj thyerje e stereotipave gjinorë; në një tjetër është një engjëll gjysmë i zhveshur që pi cigare - një përplasje mes imagjinatës dhe tabuve. Në një tjetër, shtrihet në ajër të zbrazët me një jakë të madhe rreth qafës - një aludim për kompleksin e klasave dhe imazhin që përpiqemi të mbajmë.

"Kam dashur ta lëndoj në njëfarë mënyre veten para të tjerëve. Ka qenë një lloj parodie që e kam bazuar në realitet. Komplekset dhe pretendimet e njerëzve të jenë ata që s'janë, jam munduar t'i kthej në vepra, me kusht që të jenë atraktive, shumëngjyrëshe dhe të kapshme për publikun", shpjegon ajo.

Ekspozita e dytë erdhi në vitin 2023. U mbajt në çatinë e "Hotel

completed her primary and secondary education in her hometown. At that period, she began developing a sensitivity to visual creativity.

In 2016, she enrolled at the Faculty of Arts at the University of Prishtina, in painting, where she afterwards completed her Master's studies in 2023. During this particular period, Engji taught drawing and painting, assisting Professor Faton Kryeziu, an experience that further broadened her connection with art.

In June 2020, as the pandemic shuttered galleries and heightened anxiety, Engji Jaha decided to open her first solo exhibition.

Held at the Ministry of Culture Gallery, it carried the title 'Selfi Mundi.'

"It was very good, I believe there were around 25 self-portraits. I had decided to paint myself in various dimensions, how people saw me and how I saw myself," she recalls.

When she talks about this event, her eyes light up: she knows it was important, not only as a moment, but as a test before the public.

"I reckon the first exhibition is a kind of stamp you receive from the people, whether they accept you or not," she adds.

Although the exhibition was held amid the fear caused by the notorious virus, with masks and gloves, Engji still considers as one of her fondest memories.

"I am an affectionate person, and it was unbearable not to be able to hug or shake hands, yet I am thankful they came. Although it was a trying period, for me it's the most beautiful memory," Engji recalls.

She pertains to a generation of young artists who are fearless to confront reality through irony, play, humor, and color, but also through the philosophical depth that emerges from

Grandit" në Prishtinë, në katin 13, që dikur kishte qenë një nga vendet më të populluara të viteve '70-'80.

"Më pëlqeu shumë, sepse mundësia e ekspozimit ka qenë vetëm një mur diku 10 metra dhe përballë krejt xhama ku shihet krejt Prishtina. Doja që thjesht vizitorët të vinin dhe ta ndienin këtë lidhjen mes artistit, kryeqytetit, kaosit urban e gjithçka që ndodh", thotë Engji.

Ekspozita "Ti si dikur" ishte një vazhdimësi e punës së saj me 25 portrete në vaj mbi pëlhurë, të dimensioneve të mëdha. Por këtë herë, modelet nuk ishin më vetëm reflektime të saj, ishin figura historike e kulturore shqiptare që ajo nuk pati fatin t'i takojë, por që e frymëzuan: Nexhmije Pagarusha, Nënë Tereza, Bekim Fehmiu, Muslim Mulliqi, Çesk Zadeja, Kel Kodheli, Gjon Mili, Irena Papas, Aleksandër Moisiu, Fadil Berisha, Ismail Kadare, e të tjerë. Ky lloj përkushtimi për të ndërtuar lidhje emocionale me personazhe që nuk i njeh personalisht, por që ndikuan nëpërmjet figurës dhe artit të tyre, është ndoshta një nga dimensionet më të thella të punës së saj.

"Është një filozofi pas çdo vepre, që secilit i mungon diçka. Por edhe pse ata mungojnë në mesin tonë, me artin e tyre do të jenë gjithmonë pjesë e jetës sonë të përditshme", thotë ajo.

Veprat e falura nuk vlerësohen

"Është shumë sfiduese të mbijetosh me art sot", thotë Engji Jaha, duke reflektuar mbi rrugëtimin e saj artistik. Me një zë të qetë, por të vendosur, ajo shpalos një histori përkushtimi, vetëbesimi dhe lidhjeje të thellë me qytetin dhe gjuhën e saj.

Engji është nga ato artiste që ka zgjedhur të mos ndjekë rrugën e komercializmit. "Ndoshta kam qenë me fat që nuk kam hequr shumë si të tjerët, por kjo s'do të thotë se ka qenë e lehtë. Më kanë mbajtur dëshira dhe personal experience itself.

In the 'Self Mundi' exhibition, she appears 25 times in self-portraits, each time differently.

In one painting, she plays casino with two men, a sort of shattering gender ste-reotypes; in another one, she is half-naked angel smoking a cigarette – a clash between imagination and taboos.

Further, she lies in empty air with a large collar around her neck – it's an allu-sion to class complexes and the image we endeavor to uphold.

"In a way, I wanted to hurt myself in front of others. It was a sort of parody that drew from reality. I've sought to render people's complexes and pretensions to be what they are not into artworks – on the condition that they are attractive, colorful, and accessible to the public," she explains.

In 2023, her second exhibition was held on the rooftop of the Grand Hotel in Prishtina, on the 13th floor, which used to be one of the most frequented spots during the 1970-s-80s.

"I loved it very much since the space for exhibiting consisted of just one wall, about 10 meters, and right across – it was all glasses, where you could see all of Prishtina. I simply wanted visitors to come and feel this connection between the artist, Prishtina, urban chaos, and everything that's going on," says Engji.

Moreover, the exhibition "Ti si dikur" was a follow-up of her work consisting of 25 large-scale oil-on-canvas portraits. But this time, the models were not just her reflections, but historic and cultural Albanian figures she never had the chance to meet, but who inspired her: Nexhmije Pagarusha, Mother Teresa, Bekim Fehmiu, Muslim Mulliqi, Çesk Zadeja, Kel Kodheli, Gjon Mili, Irene Pa-pas, Aleksandër Moisiu, Fadil Berisha, Ismail Kadare, and others.

This kind of commitment to forging emotional bonds with characters she doesn't know personally, but who impact her through their image and art, is perhaps one of the most profound dimensions of her work.

"There is a philosophy behind every piece, namely that each one lacks some-thing. But even though they are no longer among us, they will always be part of our daily lives through their art," she says.

Gifted Works Are Not Valued

"Today, it's very challenging to make a living through art," says Engji Jaha, while reflecting on her artistic journey. With a calm but determined voice, she shares a story of dedication, self-confidence, and a deep connection with her city and her language.

puna", thotë ajo. Ajo rrëfen se një numër artdashësish që e vlerësojnë sinqerisht artin e saj e ka mbajtur të lidhur me krijimin. Për të, raporti me vlerën materiale të artit ka qenë shpesh i ndërlikuar.

"Kam falur shumë vepra, por me kohë e kuptova se ato që falen nuk e gjejnë vendin që meritojnë. Kur fillova të shes, njerëzit më deshën më shumë", thotë ajo.

Engji ka jetuar për një kohë në Vjenë, një qytet që për shumëkënd është ëndërr për të bërë art. Por, siç thotë ajo, "zemra më rrah ndryshe në Prishtinë, se flas shqip, pikturoj shqip".

"Kohët e fundit, në një cikël të ri që po e bëj, jam duke shkruar poezi shqip që nesër mendoj që do t'i ekspozoj në vende të tjera, e që do të ngjallë interesim se çka ka dashur të thotë artistja në gjuhën e saj. Kjo është sa e dua Prishtinën, por edhe Prishtina më ka dashur mua", thotë ajo.

Megjithatë, dashuria për Prishtinën nuk e zbeh zhgënjimin që ndien për mungesën e hapësirave ekspozuese: "Nuk do të duhej ta kemi problemin se ku të ekspozojmë. Është e dhimbshme të mos dish ku do ta prezantosh punën tënde". Për ekspozitën e re që po përgatit, ende nuk ka hapësirë të siguruar.

Ajo vëren me keqardhje edhe përçarjen brenda komunitetit artistik.

"Mungon një galeri e qytetit. Mbase edhe ne jemi fajtorë, se mungon uniteti dhe bashkëpunimi". E megjithatë, ka zgjedhur të mos mbetet në mëshirë të sistemit, por ka krijuar një studio në shtëpi, ku punon çdo ditë si në një zyrë të zakonshme: "Por s'do të thotë që nuk kam synime më të mëdha".

Roli i artistit, thotë ajo, është shumë më kompleks në Kosovë.

"Këtu artisti nuk është artist. Është punëtor fizik, menaxher, person për marrëdhënie me medie. E jashtë, artisti është artist. Artisti do të duhej ta ketë vetëm punën e vet, e të tjerët t'i ndihmojmë me organizim".

Ekspozita e radhës e Engjit do të ketë një qasje ndryshe. Ajo po ndërton një ditar vizual të jetës së përditshme përmes kombinimit të pikturës, fotografisë dhe poezisë. "Kohëve të fundit po implementoj gjëra në pikturë: po vendos fotografi, shkrime, poezi. Po ndërtoj jetën tonë të përditshme përmes pikturës. Ekspozita do të jetë ditar i njerëzve, album artistik i njerëzve që çdo njeri ta shohë vetveten. Poezitë janë të shkruara me brushë mbi pikturë. Disa i kam marrë, disa poezi i kam shkruar vetë. Po shpreh një dimension tjetër: por jam duke u munduar t'i qëndroj larg portretit", rrëfen Engji.

E larg apo afër portreteve, është e sigurt që arti i saj do të vazhdojë të jetojë si krijim i një artisteje të re, por me shumë pasion, përkushtim dhe ambicie.

Engji is among those artists who have chosen not to pursue the path of com-mercialization.

"I may have been fortunate not to endure as many hardships as others, but that doesn't mean it has been easy. What kept me going was desire and hard work," she says.

Engji recounts how a number of sincere art lovers who appreciate her work have kept her tied to creation. For her, the relationship with the materialistic aspect of art has often been complicated.

"I have gifted many works, but over time I realized that those which are gifted do not find the place they deserve. When I started selling, people appreciated me more," she says. For a time she lived in Vienna, a city that for many is a dream destination for making art.

But, as she puts it, "my heart beats differently in Prishtina, because I speak Al-banian, I paint in Albanian."

"Lately, in a new cycle I'm working on, I've been writing poetry in Albanian which I plan to exhibit abroad one day, and it will spark curiosity about what the artist intended in her own language. That's how much I love Prishtina, but Prishtina has also loved me," she says.

Nevertheless, her love for Prishtina doesn't conceal the disappointment she feels over the lack of exhibition spaces.

"We shouldn't have a problem with exhibition spaces. It's painful not to know where you will present your work."

For the new exhibition she is set to hold, she still does not have a confirmed space. Engji regrettably observes that there are rifts within the artistic commu-nity.

"There is no city gallery. Perhaps we, too, are to blame. There is a lack of unity and cooperation."

Still, she has chosen not to remain at the mercy of the system, but instead set up her own home studio, where she works daily like in a regular office. "That does not mean I don't have bigger ambitions."

According to her, the role of the artists is much more complex in Kosova.

'Here, the artist is not just an artist. They are compelled to be laborers, manag-ers, and media relations persons. But abroad, the artist is just that, an artist. An artist should be left to focus on their work, and others should help with organization."

Engji's next exhibition will take a different approach. She is creating a visual diary of daily life through a fusion of painting, photography, and poetry.

"Lately I've been accreting new elements into painting: photographs, texts, po-etry. I'm envisaging our everyday life through painting. The exhibition will be a people's diary, an artistic album in which everyone can see themselves. The paintings and poems are written by brush directly onto the canvas. Some po-ems I've borrowed, others I've written myself. I'm expressing a different dimen-sion, but I'm trying to stay away from portraiture," Engji shares.

Whether close to or far from portraiture, one thing is certain: her art will con-tinue to live as the creation of a young artist driven by passion, commitment, and purpose.

NGJYRA MBI BETON

Si u bënë muret e Prishtinës kanavacë e shpirtit të qytetit

ALBERINA **HAXHIJAJ**

Në fillimet e saj u konsiderua si një mënyrë e komunikimit, më vonë si një rebelim në skajet e harruara të qytetit, por tani arti në hapësirat publike po zë vendin e vet si shprehje artistike në skenën bashkëkohore.

Dhjetëra mijëra vjet më parë, njerëzit lanë gjurmë në muret prej guri të shpellave ku jetonin, duke pikturuar herë diellin, herë prenë e tyre, e herë diçka tjetër, nën dritën e zjarrit. Ata nuk ndiqnin famën. Mbase donin që të thoshin: "Ne ishim këtu. Këto shenja janë tonat".

Dikur të konsideruara si gërvishtje primitive, sot vlerësohen si dëshmitë më të hershme të njerëzimit. E në "xhunglën" e sotme moderne të betonit dhe të çelikut, i njëjti instinkt vjen në pah me spërkatjen e sprejit të një artisti.

Mirëpo edhe sot grafitet qëndrojnë mes dy vlerësimeve – të shikuarit

COLORS ON CONCRETE

How Prishtina's Walls Became the City's Soulful Canvas

At the very outset, it was considered a way of communicating, then a rebellion on the forgotten fringes of the city. Today, public art is taking root as an artistic expression on the contemporary stage.

Thousands of years ago, humans left their vestiges on the stone walls of caves where they lived, painting by the faint light of fire images of the sun, their pray, or perhaps something else. They were not driven by fame. Perhaps it was a way of saying: "We were here. These signs were ours."

Once considered as primitive scratches, these marks are now reckoned as some of the earliest evidence of mankind. In today's urban 'jungle' of concrete and steel, that same instinct resurfaces, this time, through the spray splatters of modern artists.

Graffiti art now is hedged between two opposing assessments – some see it as mere vandalism, others as visual poetry. In Prishtina, it's perceived as both beauty, challenge, and invitation. So next time you notice a mural in an underpass or on the wall of a building or elsewhere, stop there. You're not just seeing some colors applied on a cracked façade. You're witnessing evidence that art doesn't need frames or permits as sometimes all what is required is a wall and a will to express.

The most impressive initiative Prishtina has undertaken was that of 2014. When a

e tyre si vandalizëm dhe si një poezi vizuale. Në Prishtinë, shihen si bukuri, sfidë dhe ftesë. Prandaj herën tjetër kur shihni një mural, te një nënkalim, në muret e një ndërtese apo kudo tjetër, ndaluni. Nuk po shihni vetëm bojë mbi një fasadë të krisur. Po shihni një dëshmi se arti nuk ka nevojë për korniza apo leje, ndonjëherë mjafton një mur dhe vullneti për t'u shprehur.

Dekada transformuese e Prishtinës me ngjyra dhe kauza

Kryeqyteti nismën më gjurmëlënëse, e pati në vitin 2014. Kur një grup i artistëve dhe krijuesve, të disiplinave të ndryshme të artit, me fokus në artin në hapësira publike apo siç njihet si "street-art", themeluan Q'art, ata nuk po hapnin thjesht një organizatë të re artistike – por po vendosnin rrënjët e një hapësire krejtësisht të veçantë. Të njëjtin vit, prej tyre nisi edhe festivali "Guerilla Art".

Nuk erdhi qetë. Solli një shpërthim ngjyrash me insistimin që hapësirat publike nuk duheshin konsideruar "zona të vdekura", por kanavaca që frymojnë. Agon Xhelili, drejtori i organizatës Qendra për Zhvillimin e Artit - Q'art, thotë se edhe emri ishte një deklaratë.

"Duke e ditur qasjen e institucioneve ndaj artit në hapësirat publike dhe trajtimit që u kanë bërë institucionet hapësirave publike në përgjithësi 'Guerilla Art' filloi si revoltë dhe luftë për t'i rimarrë ato përmes angazhimit të komunitetit, të artit dhe të grafiteve".

Edicionet e para mbesin ato që nuk harrohen, sidomos për ekipin që ishte aty që në fillim, ndoshta edhe për shkak të sfidave. Akoma pa një mbështetje siç duhet, "Q'art", insiston të njihet për ndikimin në kultivimin e një kulture të re urbane në

group of several artists and creators, focusing mainly in art of the public spaces or street-art, founded Q'art, they were not just opening a new artistic organization – they were establishing an entirely new space. On the same year, they launched the "Guerilla Art" Festival.

A Transformative Decade with Colors and Causes

It did not come smoothly. It brought forth a sparkling of colors, insisting that public spaces should not be considered 'dead zones', but living canvases.

Agon Xhelili, director of the Center for Art Development – Q'art, states that the organization's name was a statement in itself.

"Aware of the institutions' attitude toward public space art, and the treatment public spaces have generally received, 'Guerilla Art' began as both revolt and struggle to reclaim them through community engagement, art and graffiti."

The first editions remain unforgettable – all the more so for the team that was there from the beginning – perhaps because of the challenges. Still without any proper support, Q'art insists on being recognized for its influence in instilling a new urban culture. "This is achieved by contributing substantially to the country's image as a destination for visits,"Xhelili says.

vend. "Duke kontribuuar dukshëm në imazhin e vendit si një destinacion për t'u vizituar", thotë Xhelili.

"Kjo krijon konfuzion dhe qasje jo të drejtë karshi artit në hapësirat që i përzgjedhim", thotë Xhelili.

Ai ka shpresë që së shpejti Komuna e Prishtinës të prijë në këtë aspekt. E sheh të parën në rajon që do të krijojë rregulloren që lehtëson punë, krijon mundësi e stimulon realizimin e artit në hapësira publike. Viti 2017, në kryeqytet solli një kapitull të ri - "Meeting of styles". Përmes tij, më shumë se 100 artisë nga 20 vende të botës u bënë bashkë për t'u dhënë ngjyrë hapësirave në Prishtinë. Edhe nisja e këtij festivali erdhi si një deklaratë. Kosova nuk do të priste për t'u ftuar në diskutime të tilla globale rreth artit – do ta mbante vetë një të tillë.

Që nga debutimi, janë transformuar më shumë se muret. Të ecësh përgjatë rrugëve të Prishtinës tani është ndryshe. Vendet si Rruga B, Arbëria dhe Ulpiana nuk janë të vrazhda, por u vërehet ashiqare gjallëria e tyre. Çdo njollë e brushës a e sprejit, pëshpërit një rrëfim të ri. Synimi është që Prishtina të hyjë në listën e qyteteve që njihen si parajsa për "Street-art". Puna ka kohë që ka nisur.

Përtej muraleve: Një ringjallje e kulturës dhe e vetëdijes

Çdo edicion i festivalit "Guerilla Art" është më shumë se një ngjarje. Është një dialog i kuruar me kujdes në mes të artit dhe të qytetit. Temat nuk janë vetëm ide abstrakte, ato burojnë nga vetë hapësira, të formësuara nga ndërtesat, rrugicat dhe lagjet që i rrethojnë. Këtë vit festivali vjen me temën "Monumental" dhe me një

> **Në Prishtinë, shihen si bukuri, sfidë dhe ftesë.**
>
> **In Prishtina, it's perceived as both beauty, challenge, and invitation.**

vepër arti si deklaratë për një dekadë me murale.

Në anën tjetër, "Meeting of Styles" në Kosovë - pjesë e një rrjeti global festivalesh që mbahen në më shumë se 30 vende të botës - sjell një narrativë tjetër. Tema e këtij viti është "Kauza e zgjedhur" (The Chosen Cause). Fton artistët të reagojnë në një botë të trazuar nga kriza klimatike, pasiguria ekonomike dhe tensionet sociale. Çdo mural bëhet pasqyrë e këtyre sfidave të përbashkëta dhe e nevojës për të zgjedhur një kauzë që vlen.

Por ndikimi i organizatës Q'art nuk ndalet vetëm te festivalet. Përmes nismave si "BONEveninTOND," janë rigjallëruar hapësira të ndryshme publike në qytet, nga hapësirat e ndryshme në shkolla, te fushat sportive, trafot elektrike e deri te muralet nëpër lagje e rrugica. Këto ndërhyrje nuk janë thjesht estetike. Ato krijojnë hapësira më funksionale, më përfshirëse dhe më frymëzuese për qytetarët. Janë gjeste kujdesi, të mbështetura në bindjen se çdo qytetar meriton të jetojë në një mjedis që reflekton krijimtari.

Sipas Xhelilit, duke qenë publik dhe i hapur për të gjithë, ky art shpesh trajton çështje sociale, provokon mendime dhe nxit debat. Sipas tij, ky lloj arti, është veçanërisht

Even after a decade, financial support remains problematic. Another challenge, according to him, is the lack of proper regulations regarding the treatment in public spaces.

"This creates confusion and an unjust attitude toward the art in the spaces we choose," Xhelili says.

He is optimistic that the municipality of Prishtina will take the lead in this respect. This would be the first time in the region that a city adopts a regulation that facilitates public art, creates opportunities, and encourages creativity in shared spaces.

In 2017, Prishtina introduced a new chapter: Meeting of Styles. Over 100 artists from 20 countries gathered to color the city's walls. Even the launch of this festival was a statement in itself. Kosova would no longer wait to be invited into the global discussion about art – it would host a similar discussion on its own terms.

Since its debut, the transformations have gone far beyond the walls. Now, it feels different walking through Prishtina. Places like Rruga B, Arbëria, and Ulpiana are no longer gloomy – a cheerful atmosphere is felt in the air. Every brushstroke and spray whispers a new story. The goal is to make Prishtina one of the cities known as a paradise for 'Street art'. Now, the work is well underway.

Beyond Murals: A Revival of Culture and Awareness

Each edition of the Festival is more than an event. It is a carefully curated dialogue between art and the city. The topics are not merely abstract ideas – they rather emerge from the space itself, shaped by the buildings, streets, and neighborhoods.

This year's festival revolves around the theme Monumental, with an artistic work as a statement marking a

i rëndësishëm për të rinjtë dhe artistët në zhvillim, pasi u ofron një platformë të drejtpërdrejtë për t'u shprehur dhe për të komunikuar me qytetin.

"Galeritë do të mbesin gjithmonë formë tradicionale e ekspozimit dhe e komunikimit përmes artit, mirëpo sot ka vepra të artistëve në hapësira publike që tërheqin vizitorë më shumë se galeritë", thekson ai.

Gjatë rrugëtimit të vet, organizata Q'art përmes festivaleve dhe projekteve që ka realizuar ka trajtuar tema të ndryshme dhe ka kontribuuar në sfidat e përbashkëta sociale, si: barazia gjinore, të drejtat e njeriut, mbrojtja e ambientit dhe aspekte të ndryshme kulturore. Reagimi i publikut ndaj këtyre mesazheve ka qenë i larmishëm, nganjëherë përkrahës e nganjëherë kritik, por gjithmonë audienca ka qenë aktive. Dhe, kjo është pikërisht ajo që synohet.

"Nganjëherë muralet tentojnë të jenë me provokative, ku si rrjedhojë mund të ketë polemika dhe reagime të ndryshme nga qytetarët, mirëpo edhe kjo kontribuon në një dialog që shpesh bëhen me po këtë qëllim", thotë Xhelili.

Pas një dekade, Prishtina nuk e sheh më artin e rrugës si diçka periferike. Ai është kthyer në pjesë të identitetit të saj. Një forcë që nuk tërheq vetëm turistë, por i fton të gjithë që ta ndiejnë ritmin e qytetit. Një lëvizje që i ka kthyer muret gri në pasqyra të preokupimeve dhe të mundësive.

Në një botë të sunduar nga algoritmet, ku gjithçka shihet me shpejtësi, kjo formë arti të bën të ndalosh. Të shfaqet në ndonjë qoshe dhe flet drejtpërdrejt me ty. Dhe ndoshta, kjo është forma më njerëzore e lidhjes që na ka mbetur nëpër hapësira të tilla.

decade of murals.

Moreover, "Meeting of Styles" in Kosova – part of a global network of similar festivals hosted in over 30 countries – brings forth another narrative. This years' topic is The Chosen Cause. Artists are invited to respond to a world tormented by climate crisis, economic insecurities, and social tensions as well. Each mural becomes a mirror of these shared challenges, and a call to find a cause that is truly worth the effort.

Nonetheless, Q'art influence is not confined to festivals alone. Through the "BONEveninTOND" initiative, numerous public spaces have been revitalized –starting from areas in schools to sports fields, electrical installments, and murals across city streets. These interventions are not merely aesthetic. They provide much more functional, inclusive, and inspiring spaces. They are caring acts, relying on the belief that every citizen deserves to live in environments that reflect creativity.

According to Xhelili, public art – accessible to all – often delves on social issues, provokes reflection, and stirs debate. He underscores that this kind of art is particularly important for both youth and emerging artists, as it offers a direct platform to express themselves and to communicate with the city.

"Galleries will always remain a traditional form of exhibiting and communicating through art," he says, "yet, today there are artworks in public spaces that are attract far more visitors than galleries."

Throughout its journey, the Q'art organization has delved into a variety of themes through its festivals and projects, contributing to shared social concerns as gender equality, human rights, environmental protection, and diverse cultural issues. Public reactions to these messages have been diverse, sometimes supportive and sometimes critical, but always actively engaging. And that is exactly the point.

"Sometimes, murals aim to be more provocative, thus there will be various polemics and reactions triggered by them, but even that contributes to dialogue which is often the very point," Xhelili says.

After a decade, Prishtina no longer sees street art as something peripheral. Now, it has become part of the city's identity – a force that not only attracts tourists but invites everyone to feel the rhythm of the city. A movement that has turned gray walls into mirrors of concern and opportunity.

This artistic expression compels you to pause in a world governed by algorithms and driven by speed. It surfaces around every corner, addressing directly to you. And perhaps, this is the most human connection that still lingers in such spaces.

Kosova drejt zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm

BAKI **HOTI**

Unioni i Turizmit të Kosovës është i përkushtuar në mbështetjen, zhvillimin dhe promovimin e Turizmit të Kosovës. Kosova, tashmë një destinacion turistik, është duke punuar në aspektin e turizmit të qëndrueshëm. Kjo dëshmohet edhe në bazë të statistikave, ku çdo muaj ka një rritje të numrit të turistëve.

E një ndër aktivitetet, i cili ka kontribuuar dhe dëshmuar këtë është edhe Panairi Ndërkombëtar i Turizmit "Kosova 2025", i cili edhe këtë vit bashkoi industrinë globale të turizmit në zemër të Ballkanit.

Me këtë panair, i mbajtur më 10 dhe 11 prill 2025, Prishtina u shndërrua në epiqendrën e industrisë së turizmit. Kjo ngjarje madhore - e organizuar nga Unioni i Turizmit të Kosovës (UTK), nën patronatin e Komunës së Prishtinës e i cili i mbajt në ambientet moderne të Prishtina Mall - mblodhi nën një çati akterë të rëndësishëm

Kosova Towards a Sustainable Tourism

The Kosova Tourism Union remains dedicated to supporting, developing, and promoting tourism in Kosova. Our country is now a recognized tourist destination, with the number of visitors increasing steadily each year, and is working with clear focus toward sustainable tourism. This is well reflected in statistics, which show a monthly growth in tourist numbers. Among the key events that has contributed to this trend is the International Tourism Fair Kosova 2025, which once again brought together the global tourism industry at the heart of the Balkans. With this fair, held on April 10–11, 2025, Prishtina was transformed into the epicenter of the tourism sector. This major event – organized by the Kosova Tourism Union (UTK), under the patronage of the Municipality of Prishtina, and hosted in the modern premises of Prishtina Mall – mustered under one roof notable actors from across the country and abroad, generating a dynamic environment of collaboration, promotion, and professional development. Participants in this year's edition included travel agencies, tour operators, companies from the HoReCa industry, governmental and international institutions, airlines, development organizations, and representatives from more than 16 countries. They presented their tourism offers, held B2B meetings, and shared ideas about the future of tourism in the region. The Kosova 2025 fair provided a unique platform to promote Kosova as an authentic and attractive tourist destination in the region; to foster

të sektorit nga vendi dhe bota, duke krijuar një atmosferë dinamike bashkëpunimi, promovimi dhe zhvillimi profesional.

Pjesëmarrës në këtë edicion ishin agjenci turistike, operatorë turistikë, kompani të industrisë HoReCa, institucione qeveritare dhe ndërkombëtare, linja ajrore, organizata zhvillimore, si dhe përfaqësues nga mbi 16 shtete të ndryshme. Ata prezantuan ofertat e tyre turistike, zhvilluan takime B2B dhe ndanë ide për të ardhmen e turizmit në rajon.

Panairi "Kosova 2025" ofroi një platformë unike për promovimin e Kosovës si një destinacion turistik autentik dhe tërheqës në rajon; për zhvillimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e turizmit dhe të mikpritjes; nxitjen e investimeve strategjike dhe krijimin e partneriteteve të reja biznesore; diskutime profesionale, forume dhe prezantime rreth zhvillimit të qëndrueshëm të industrisë turistike.

Përveç prezantimeve dhe ekspozitave, u mbajtën sesione të shumta të rrjetëzimit dhe diskutimeve për tema si promovimi digjital, ngritja e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimi i destinacioneve të qëndrueshme.

Panairi "Kosova 2025" dëshmoi se Kosova ka potencial të madh për t'u zhvilluar si një qendër rajonale për turizmin dhe mikpritjen, njëherësh ishte një hap domethënës drejt forcimit të këtij sektori jetik për zhvillimin ekonomik të vendit.

international cooperation in the field of tourism and hospitality; to encourage strategic investments; and to build new business partnerships. It also featured professional discussions, forums, and presentations focused on the sustainable development of the tourism industry. In addition to exhibitions and showcases, the fair hosted numerous networking sessions and thematic discussions, covering topics such as digital promotion, professional capacity building, and the development of sustainable destinations. The Kosova 2025 fair reaffirmed that Kosova holds great potential to develop into a regional hub for tourism and hospitality – and as such marked a meaningful step forward in strengthening this vital sector for the country's economic growth.

Rruga e Kosovo Girl Travels

E pa botën, rrëfen Kosovën

"Sa më shumë mësoja për vende të tjera, aq më shumë ndieja thirrjen për të treguar historinë e Kosovës"

Shëtiti botën, tash e rrëfen Kosovën. Lavdi Zymberi, është emri i vajzës që ka parë më shumë se 50 vende të botës, si: Butani, Jordania, Meksika, e Etiopia etj. Për të shpalosur krejt çka kishte përjetuar nga udhëtimet ka hapur blogun Kosovo Girl Travels, që ndan bukuritë e Kosovës dhe më gjerë, një tregim dhe një tur në çdo hap. E së fundi është certifikuar si udhërrëfyese turistike kombëtare, e gatshme për ta shpalosur Kosovën para botës.

Si udhëtare, shkrimtare dhe udhërrëfyese turistike e certifikuar, për PrishtinArt, Zymberi flet për këtë triptik të jetës së saj, të lidhur me turizimin.

"Kur e nisa Kosovo Girl Travels, blogun e parë të këtij lloji në Kosovë, ishte thjesht një hapësirë për t`i dokumentuar udhëtimet e mia nëpër botë dhe për t'ia paraqitur botës vendin tim", nis rrëfimin Zymberi.

Ajo tregon se me pasaportë kosovare, ka pasur fatin të vizitojë mbi 50 shtete, e të cilin e konsideron një rrugëtim të mbushur me sfida, por jashtëzakonisht të shpërblyeshëm, duke përballuar pengesat që shpesh hasin kosovarët gjatë udhëtimeve ndërkombëtare.

"Çdo udhëtim ma rritte dashurinë për tregimin e historive dhe ma thellonte lidhjen me vendlindjen", thotë ajo.

Të jetuarit jashtë — fillimisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për studime dhe më vonë në Sudanin e Jugut për punë — do ta bënte ta vlerësonte Kosovën edhe më shumë.

"Largësia më ndihmoi ta shihja

The Journey Behind Kosovo Girl Travels

She Saw the World, She Speaks of Kosova

"The more I learned about foreign countries, the stronger the urge to tell Koso-va's story became"

She travelled far and wide, and now she chronicles the story of Kosova. Lavdi Zymberi is known as the girl who has visited more than 50 countries across the world, including Bhutan, Jordan, Mexico, and Ethiopia. To document her trav-el experiences, she created the blog Kosovo Girl Travels, a space that showcases the gems of Kosova and beyond, yielding a story and a tour in every step. Re-cently, she was certified as a national tour guide, ready to introduce Kosova to the world.

As a traveler, writer, and guide, Lavdi shares a personal triptych tied to tour-ism.

"When I created 'Kosovo Girl Travels', the first blog of its kind in Kosova, it was a space to chronicle my journeys and to present my country to the world," Lav-di begins.

She says she was fortunate to travel on more than 50 countries on a Kosovan passport, a journey she describes as being replete with challenges. However, it was also rewarding as she overcame the obstacles that Kosovars so often face during international travels.

"Every trip bolstered my longing to tell stories and deepened my bond with my homeland," she says.

Living abroad – initially in the United States for her studies, and later in South Sudan for work – prompted her appreciate Kosova even more.

"Distance enabled me to see my country through new lenses. Thus, its

FOTO: ERMAL **META**

vendin tim me sy të tjerë: historia, qëndrueshmëria dhe kultura u bënë burime krenarie që doja t'i ndaja me botën. Sa më shumë mësoja për vende të tjera, aq më shumë ndieja thirrjen për të treguar historinë e Kosovës", thotë ajo.

Zymberi thotë ta ketë kuptuar me kohë ngaqë, edhe pse i pëlqente të eksploronte kultura të huaja, zemra e saj i qëndronte gjithmonë me Kosovën.

"Pashë nevojën për të promovuar historinë e pasur, kulturën e larmishme dhe peizazhet mahnitëse të vendit tim, veçanërisht para një audience ndërkombëtare që nuk është e njohur me atë që ofron Kosova. E kuptova se Kosova meriton të jetë më e pranishme në bisedat globale për udhëtime. Përmes shkrimeve e artikujve të ndryshëm, intervistave dhe rrjeteve sociale, iu përkushtova promovimit të peizazheve, traditave dhe kulturës sonë", thotë me krenari ajo.

E kur ndalet te Prishtina, Zymberi thotë se kryeqyteti është një qytet kontrastesh dhe energjie.

"Ajo ndërthur tradita shekullore me një frymë të re dhe kreative. Nga xhamitë historike dhe arkitektura osmane, te skena e gjallë e kafeneve dhe arti publik i guximshëm, Prishtina rrëfen historinë e së kaluarës së Kosovës dhe të së ardhmes së saj të ndritur", thotë Zymberi, teksa tregon se vetes ia dha një mision.

"Të ndaj shtresat e saj — thesaret e fshehura, rrugët plot gjallëri dhe njerëzit e qëndrueshëm — u bë një nga shtytjet kryesore të punës sime".

Nuk lë pa u ndalur te disa nga vendet më të preferuara të saj në Prishtinë. Për to thotë se janë të mbushura me histori dhe ofrojnë perspektiva unike të qytetit.

"Muzeu Etnologjik, i vendosur në një ndërtesë të vjetër, të shekullit XVIII, e paraqet bukur trashëgiminë kulturore të Kosovës. Brenda Bibliotekës Kombëtare, më mahnit arkitektura e saj unike dhe brendësia që të nxit për reflektim. Dhe për pamje të mrekullueshme të qytetit, asgjë nuk e kalon Kullën e Sahatit në Katedralen Nënë Tereza — nga aty shfaqet Prishtina në një këndvështrim tjetër,

history, resilience, and culture became sources of pride I felt compelled to share further. The more I learned about other countries, the more I felt the urge to speak about Kosova," she adds.

Over time, Lavdi realized that despite exploring other cultures, her heart always remained rooted in Kosova.

"I felt the need to promote the rich history, colorful culture, and exquisite land-scapes of my country, especially for an international audience that is not well-acquainted with what Kosova has to offer. Hence, I realized why Kosova de-serves to have more visibility in global trip conversations. Through notes, arti-cles, interviews, and social media, I've committed myself to promoting our land-scapes, traditions, and culture," she proudly shares.

When it comes to Prishtina, Lavdi deems it as a city of both contrasts and ener-gy.

"It mingles centuries-old traditions with innovation and creativity. From histor-ic mosques and Ottoman-era

> **“Nga xhamitë historike dhe arkitektura osmane, te skena e gjallë e kafeneve dhe e arti publik të guximshëm, Prishtina rrëfen historinë e së kaluarës së Kosovës dhe të së ardhmes së saj të ndritur”**

me ndërthurjen e elementeve moderne dhe historike, dhe me peizazhin përreth”, thotë ajo.

Në vitin 2024 përkushtimi i saj për turizmin merr një tjetër kahe.

“Vendosa ta çoj pasionin tim edhe një hap më tej. Tashmë po udhëzoja vizitorë që më kontaktonin përmes rrjeteve sociale, ndaj u regjistrova në programin e parë intensiv për trajnim të udhërrëfyesve turistikë në Kosovë, të organizuar nga GuideKS — një kurs prej 200 orësh për tre muaj, që më ofroi një bazë të fortë në fusha, si: historia e Kosovës, trashëgimia kulturore, etika e udhërrëfimit dhe angazhimi me vizitorët. Ishte një përvojë transformuese që jo vetëm zgjeroi njohuritë e mia, por forcoi edhe më shumë aftësinë për të krijuar përvoja kuptimplota dhe të paharrueshme për udhëtarët”, thotë Zymberi.

Në cilësinë e një vajze që pa botën, si blogere udhëtimesh dhe udhërrëfyese e certifikuar kombëtare, ajo shpreh gjithë krenarinë për të ftuar vizitorët e huaj të zbulojnë Kosovën, përtej titujve të lajmeve.

“Përmes Kosovo Girl Travels dhe tureve që organizoj, synoj të krijoj lidhje, të zgjoj kureshtje dhe ta ndaj shpirtin e Kosovës — duke filluar nga rrugët plot jetë të Prishtinës. Është privilegj të shërbej si ambasadore për vendin tim, duke ndarë historitë e tij me botën - një udhëtar në një kohë”.

architecture to lively cafés and bold public art, Prishtina encapsulates the stories of the past and the bright future of Kosova that lies ahead,” she says, emphasizing her personal mission.

“To share its layers, hidden gems, cheerful streets, and resilient people, that be-came the driving force in my work.”

She does not hesitate to speak of some of her favorite spots in Prishtina, places that, in her eyes, are full of history and offer unique views of the city.

“The Ethnological Museum, housed in an 18th century traditional building, apt-ly displays Kosova’s cultural heritage. Inside the National Library, I’m always bedazzled by its unique architecture and the interior that prompts reflection. When it comes to amazing views, there’s nothing that can be compared with the clock towers in the Mother Theresa Cathedral – there, Prishtina is revealed from a different angle, blending the modern and historical elements with the adjacent urban landscape,” she says.

In 2024, her dedication for tourism took a new turn.

“I decided to take my passion one step further. I was already instructing visitors who contacted me through social media, so I enrolled in the first intensive training program for tour guides in Kosova, hosted by GuideKS. The course consisted of 200 hours over three months and provided a solid foundations on subjects like Kosova’s history, cultural heritage, guiding ethics, and visitor en-gagement. It was a transformative experience, so not only did it broaden my knowledge, but it also bolstered my ability to create meaningful, unforgettable experiences for visitors,” Lavdi explains.

As a girl who has seen the world, a travel blogger, and guide, she expresses her will to invite international visitors to discover Kosova beyond the headlines.

“Through Kosovo Girl Travels and my tours, I hope to create human connec-tions, spark curiosity, and share the soul of Kosova, starting with the cheerful streets of Prishtina. It’s a privilege to serve as an ambassador for my country, sharing its stories to the world as a traveler.”

Monumentet që rrëfejnë historinë e Prishtinës

Monuments that Reveal Prishtina's History

GILI **HOXHAJ**

Prishtina përjetohet më së miri nëpërmjet ecjes. Kurse historia mësohet më së miri nga monumentet që ruajnë historinë dhe narrativen mbi të cilën u ndërtua jeta dikur e sot. Muamer Hasani, drejtor ekzekutiv i GuideKS që pret shumë vizitorë të huaj, nëpërmjet kësaj interviste na dërgon nga një cep te cepi tjetër i kryeqytetit, duke e bërë një vizuelizim të hartës se çfarë ia vlen të vizitohet në Kosovë dhe veçantitë prapa secilit monument. Nga ndërtesa ikonike e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës deri te monumenti "New Born" që është një kapitull i hapur, kopertina e të cilit ndërrohet çdo vit për të treguar një histori tjetër. Të tjerat mbesin të pandryshueshme lidhin të kaluarën dhe mbajnë gjallë shpirtin e kryeqytetit me besimin e kulturën që janë prehje nga dinamika që ofron qyteti. Hasani në këtë intervistë tregon se në vetëm 1 orë çfarë nuk duhet të humbasë një vizitor në Prishtinë.

Prishtina is best captured on foot. And, likewise, its history is most vividly unfolded through the monuments that retain the history and narrative upon which life, past and present, is built. In this interview, Muamer Hasani, executive director of GuideKS, which welcomes numerous international visitors, takes us on a tour across the city, thus showcasing a map of places worth visiting and highlighting the peculiarities of each monument. It's a journey that commences with the iconic National Library of Kosova and ends with the NEWBORN Monument, whose ever-changing outlook tells a new story each year. Other monuments remain unchanged, preserving the unaltered soul of the city and offering moments of spiritual and cultural solace in the midst of Prishtina's energy. Hasani shares what visitors shouldn't miss, all the more so when the visit is limited to just one hour.

Cilat janë 5 monumentet që do t'i rekomandonit çdo vizitori që vjen për herë të parë në Prishtinë?

- *Biblioteka Kombëtare e Kosovës;*
- *Xhamia e Jashar Pashës;*
- *Muzeu Etnologjik;*
- *Sheshi Skënderbeu (së bashku me Teatrin Kombëtar, ish-xhaminë e Llokaqit dhe sinagogën);*
- *NEWBORN.*

What are five monuments you recommend to first-time visitors in Prishtina?

- *The National Library of Kosova*
- *The Jashar Pasha Mosque*
- *The Ethnological Museum*
- *Skënderbeu Square (alongside the National Theater, the former Llokaqi Mosque, and the now-destroyed Synagogue)*
- *The NEWBORN Monument.*

A mund të na tregoni historinë e shkurtër ose simbolikën e secilit prej tyre?

Biblioteka Kombëtare e Kosovës është tashmë ndërtesa më ikonike e Prishtinës. Nëse sot bëni një kërkim on-line për Prishtinën,

fotografia e parë që zakonisht shfaqet është ajo e bibliotekës. Kjo ndërtesë është unike për shumë arsye nga arkitektura e saj e pazakontë, te legjendat për kupolat, e deri te vlerësimi (apo paragjykimi) si "njëra prej ndërtesave më të shëmtuara në botë". Megjithatë, ky epitet vetëm sa e ka bërë atë më të famshme ndërkombëtarisht, duke përforcuar idenë se nuk ka reklamë të keqe apo të mirë – reklama është reklamë.

Xhamia e Jashar Pashës, e ndodhur vetëm disa metra larg Muzeut Kombëtar të Kosovës, është ndërtuar në vitin 1834. Pjesa e brendshme e saj është një hapësirë unike, e ndriçuar nga dritaret e vendosura njëra mbi tjetrën, me mure të pikturuara dhe të zbukuruara me motive florale pothuajse realiste - element që është i rrallë në artin islam. Po ashtu, aty dominon ylli gjashtëkëndor, i njohur si Magen David ose vula e Profetit Sulejman (Solomon). Në fasadën ballore të xhamisë vërehen gjithashtu dy menora (qirimbajtëse hebraike), çka e bën këtë xhami unike jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan.

Could you briefly share the history and symbolism of each one?

The National Library of Kosova is already established as the most iconic building in Prishtina. A quick online search of the city will always yield its image first. The building is unique for many reasons – its unusual architecture, the legends enshrouding its domes, and the label (or prejudice) as "one of the world's ugliest buildings." Nonetheless, this epithet gave it more international renown, bolstering the idea that there is no such thing as bad publicity.

The Jashar Pasha Mosque, located a few meters away from the National Museum of Kosova, was built in 1834. Its interior consists of a unique space, illuminated with stacked windows and ornately painted walls in near-realistic floral motifs, rarely found in Islamic art. Moreover, the mosque also bears the hexagonal star, known as the Magen David or the Seal of Prophet Sulaiman (Solomon). In its frontal façade, there stand two menorahs (Hebrew candlesticks), making it a unique mosque not just in Kosova but in the Balkans.

The Ethnological Museum is among the country's most successful museums. Its exhibition sheds light on traditional lifestyles, urban organization, gender roles, and beliefs regarding life and death. The Museum comprises a complex of buildings, one dating from the 18th century and available to visitors, while the other one from the 19th century, currently being restructured to display the human lifecycle through three main themes: Birth, Life, and Death. The museum has earned recognition from prestigious outlets like The New York Times and The Guardian.

Skënderbeu Square, along with the National Theater, the Llokaqi mosque that once existed, and the now-extinct Synagogue, represents a site where Kosova's layered history can be recollected, namely the periods of major changes, destruction and reconceptualization of public spaces during various regimes. From this single spot, one can trace the story of Kosova's society and its struggle to retain or rebuild cultural identity. A case in point is the demolition of Llokaqi Mosque (in the place where today the National Theatre resides), whose only

Muzeu Etnologjik i Prishtinës është ndër muzetë më të suksesshëm në vend. Ekspozita e tij ndriçon mënyrën e jetesës tradicionale, organizimin urban, rolet gjinore, por edhe konceptet e jetës dhe të vdekjes. Muzeu përbëhet nga një kompleks ndërtesash njëra prej shekullit XVIII, e hapur për vizitorë, dhe tjetra nga shekulli XIX, e cila është në proces të rikoncepimit për të pasqyruar ciklin e jetës përmes tri temave kryesore: lindja, jeta dhe vdekja. Ky muze është përfshirë në artikuj të shumë medieve prestigjioze ndërkombëtare si The New York Times, The Guardian etj.

Sheshi Skënderbeu, së bashku me Teatrin Kombëtar, ish-xhaminë e Llokaqit dhe sinagogën e rrënuar, përfaqëson një hapësirë ku mund të tregohet dhe diskutohet për historinë e Kosovës për periudhat e ndërrimeve të mëdha, rrënimeve dhe rikonceptimeve të hapësirës publike nga regjimet e ndryshme. Nga një pikë e vetme në këtë shesh mund të shpjegohet shumëçka për shoqërinë kosovare dhe përpjekjet e saj për ruajtjen apo rindërtimin e identitetit kulturor. Shembuj konkretë janë rrënimi i xhamisë së Llokaqit (në vendin ku sot ndodhet Teatri Kombëtar), ku remnant is a drinking fountain that was uncovered during recent renovations. Similarly, the Synagogue in 1963 and a Catholic Church near the Grand Hotel were demolished – for the latter, a large part of the old quarter was destroyed.

The NEWBORN Monument, seen as the symbol of Kosova's independence, stands for a country that aims to be a functional democracy, a small state yet sustainable that provides its citizens a better and just life. Once Kosova became independent, the monument became its most representative symbol, and as such it has drawn a lot of international media attention.

If visitors only had one hour in the city, where would you guide them?

In that case, I'd suggest the National Library, the NEWBORN Monument, and Skënderbeu Square.

Which site impresses international visitors most?

Doubtless, the National Library leaves the strongest impression, and there are plenty of reasons for that. Mostly, the infamous rating as "one of the world's ugliest buildings" did not tarnish its image; on the contrary, it made it more famous worldwide. As it is often said, there's no such thing as bad publicity. And the building itself, consisting an unusual

ende shihet çezma e zbuluar gjatë rikonstruimit të sheshit, si dhe rrënimi i sinagogës në vitin 1963 dhe i kishës katolike afër Hotel Grandit, për të cilën u rrënua një pjesë e madhe e zonës së vjetër të qytetit.

NEWBORN, si simbol i pavarësisë së Kosovës, përfaqëson një vend të porsalindur me shpresën për të qenë një demokraci funksionale, një shtet i vogël por i qëndrueshëm që u ofron qytetarëve të vet një jetë më të mirë dhe më dinjitoze. Me rastin e shpalljes së pavarësisë, ky monument u shndërrua në simbolin kryesor të shtetit të ri dhe u paraqit në të gjitha mediet ndërkombëtare.

Nëse do të kishit vetëm 1 orë për t'ia treguar dikujt Prishtinën - ku do ta çonit?

Për një vizitë njëorëshe në Prishtinë, do t'i çoja vizitorët te: **Biblioteka Kombëtare, Monumenti NEWBORN dhe Sheshi Skënderbeu.**

Cili prej këtyre vendeve u lë më

architectonic appearance, has gotten that attention.

Do these monuments adequately reflect the city's identity and history?

Prishtina's monuments mirror sufficiently the complex history the society lived through. They bear testimony to the urban interventions, the political transformations, and the deliberate erasure of cultural heritage. A significant case is the demolition of the Llokaqi Mosque, in the place where today the National Theatre resides, and only the newly discovered fountain stands as a reminiscing memento. Likewise, the destruction of the Synagogue and the Catholic Church near the Grand Hotel are additional evidences of cultural and ideological shifts. These interventions are not just architectural changes because they represent erased layers of collective memory and identity.



shumë përshtypje turistëve?

Pa dyshim, objekti që u lë më së shumti përshtypje vizitorëve është Biblioteka Kombëtare, për shumë arsye. Megjithatë, arsyeja kryesore është "falë" epitetit si njëra nga ndërtesat më të shëmtuara në botë – një vlerësim që, në vend se ta dëmtojë reputacionin e saj, vetëm sa e ka bërë më të njohur ndërkombëtarisht. Siç thuhet shpesh, në botën e sotme nuk ekziston reklamë e keqe apo e mirë, ekziston vetëm vëmendja. Dhe kjo ndërtesë, me arkitekturën e saj të pazakontë, e ka tërhequr plotësisht atë vëmendje.

A mendoni se monumentet e Prishtinës reflektojnë mjaftueshëm identitetin dhe historinë e qytetit?

Monumentet e Prishtinës pasqyrojnë mjaftueshëm historinë komplekse të kësaj shoqërie dhe fazat e ndryshme nëpër të cilat ka kaluar ajo. Ato dëshmojnë për ndërhyrjet urbane, transformimet politike dhe fshirjet e qëllimshme të trashëgimisë kulturore.

> **Një shembull domethënës është rrënimi i Xhamisë së Llokaqit, në vendin ku sot ndodhet Teatri Kombëtar një ndërhyrje që vazhdon të kujtohet përmes çezmës së vjetër që ende është e dukshme dhe u zbulua gjatë shtrimit të Sheshit Skënderbeu.**

Po ashtu, rrënimi i sinagogës në vitin 1963, si dhe i kishës katolike afër Hotel Grandit, për të cilën u shkatërrua një pjesë e madhe e zonës së vjetër të qytetit, janë dëshmi të tjera të zhvendosjeve kulturore dhe ideologjike. Këto ndërhyrje nuk janë vetëm çështje arkitekturore ato përfaqësojnë humbje të shtresave të identitetit kolektiv të qytetit.

PRISHTINA E NDRIÇUAR NË FUNDVITIN 2024

Festë, ngrohtësi dhe vëmendje ndërkombëtare

Për një kohë shumë të shkurtër Prishtina ka arritur që të krijojë një traditë të dekorimit të qytetit për festat e fundvitit, që ia kanë zili edhe qytetet më të mëdha. Edhe dekorimi i dhjetorit të 2024-ës ishte krejt i veçantë. Kryeqyteti u kthye në një skenë të gjallë dhe të ndriçuar feste, duke ofruar një përvojë unike për qytetarët dhe vizitorët e saj. Dekorimet festive, tregu dhe dritat shumëngjyrëshe nëpër sheshe, aktivitetet për fëmijë, patinazhi dhe muzika e gjallë i dhanë kryeqytetit një atmosferë evropiane, plot ngrohtësi e gëzim.

E kjo nuk kaloi pa u shënuar edhe në mediet e agjencitë ndërkombëtare të lajmeve, si: Reuters, AP, Euronews, AA e të tjera. Dekorimet në Prishtinë janë shpërfaqja e shpirtit festiv, tolerant e human që e shquan jo vetëm këtë qytet, por gjithë shqiptarët përgjithësisht.

PRISHTINA LIT UP FOR THE 2024 YEAR-END HOLIDAYS

Festivity, Warmth, and International Attention

In a very short time, Prishtina has succeeded in establishing a tradition of decorating the city for the year-end holidays – one that even larger cities might envy. But the decorations of December 2024 were altogether something else. The capital transformed into a vibrant and illuminated festive stage, offering a unique experience for both its residents and visitors. Festive lights, holiday markets, colorful displays across city squares, children's activities, ice skating, and live music gave the capital a European air replete with warmth and joy. And all this did not go unnoticed by international media outlets such as Reuters, AP, Euronews, AA, and others. Prishtina's decorations reflected the festive, tolerant, and humane spirit that defines not only the city itself, but Albanians as a whole.

"Lady" - dera që për gratë nuk mbyllet kurrë

"Lady", A Door That Never Closes For Women

SANIJE **MURATI**

Kur Sanija Murati mbërriti në Kosovë, më 2004, nuk e kishte menduar se do të bëhej themeluese e një prej organizatave më jetëgjata dhe më me ndikim në jetën e grave këtu. E ardhur nga Mali i Zi, me përvojë jetese edhe në Bosnjë dhe në Kroaci, u përball me sfida të shumta, prej të cilave më e madhja qe barriera gjuhësore. Edhe pse juriste me profesion, meqenëse nuk fliste shqip, rrugën drejt një jete të re e nisi nga pastiçeria.

"E kam vërejtur që Kosovës i duhen ëmbëlsira dhe kam thënë se për të mësuar të bësh ëmbëlsira nuk duhet ta dish gjuhën", kujton ajo.

Recetat i mësoi nga e ëma, i solli më pas në forma të ndryshme - gjë që mungonte në tregun e Prishtinës asokohe. Ato Sanija ua mësoi grave të tjera, pastaj ato të tjerave, duke krijuar kësisoj një mjet për t'i fuqizuar gratë në mënyrë ekonomike.

Ideja u zgjerua e tejkaloi shijen e ëmbëlsirave kur u themelua organizata joqeveritare "Lady", shtëpia këshilluese e parë për gratë në kryeqytet që sot numëron 20 vite aktivitet në shërbim të komunitetit dhe të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Organizata ka ndihmuar qindra gra nga të gjitha komunitetet përmes trajnimeve, ndërmjetësimit për punësim, këshillimit psiko-social dhe mbështetjes për krijimin e bizneseve.

Një strehë për gratë

Me mbi 130 vullnetarë aktivë dhe pa sistem anëtarësimi, organizata joqeveritare "Lady" përfshin gra nga të gjitha komunitetet dhe moshat, me fokus të veçantë në grupet e margjinalizuara. Duke përdorur trajnimet, konsulencën, rrjetet dhe organizatat e biznesit, organizata arrin te gratë e të gjitha shtresave dhe pjesëve të shoqërisë me qëllim për ta rritur pavarësinë e tyre ekonomike, duke ndërtuar mirëbesim ndërmjet aktiviteteve ekonomike.

"Kur e mësova gjuhën kam filluar shumë më seriozisht

Upon Sanija Murati's arrival in Kosova in 2004, she never envisioned she would become the founder of one of the most long-lasting and influential organizations that impacted the lives of women here.

Hailing from Montenegro, with a wealth of life experience in both Bosnia and Croatia, she encountered numerous challenges, the most burdensome being the language barrier.

Although a lawyer by profession, as she did not speak Albanian, she commenced her new life through a pastry shop.

"I realized that Kosova needed sweets, and I said back then: to learn how to make desserts, the language is not required necessarily," she recalls.

What she learned from her mother she brought in the form of various recipes – something that was absent in Prishtina's market at the time.

Sanija taught them to other women, who in turn passed them on to others, thus creating a tool for economically empowering women.

The idea went beyond a simple love for sweets when she founded the NGO 'Lady' as Prishtina's first counseling center for women. Now, it boasts 20 years of service to the community and partnerships with both local and international institutions.

The organization has supported hundreds of women from all communities through training, employment mediation, psychosocial counseling, and assistance in establishing their own businesses.

A Shelter for Women

With over 130 active volunteers and no membership system, the NGO 'Lady' comprises women from all communities and ages, with a specific focus on marginalized groups.

të merrem me këtë punë. Çfarë i kemi sjellë Prishtinës, por jo vetëm Prishtinës, por edhe Kosovës, janë fillimisht ëmbëlsirat të formësuara. Por më vonë jemi zgjeruar edhe me punë të tjera, që kanë buruar nga puna në terren. Gjatë periudhës së koronavirusit kemi ofruar këshilla psiko-sociale. Jam shumë e lumtur që pastaj për shkak të nevojës edhe organizata të tjera kanë ndjekur hapat tanë", nis rrëfimin Sanija.

Vendosur në një pjesë të frekuentuar të qytetit, objekti i OJQ "Lady" është një ambient i ngrohtë dhe i besueshëm për gratë e të gjitha komuniteteve të Kosovës.

"`Lady' mburret që kemi 130 vullnetarë dhe jemi shoqata e vetme me kaq shumë vullnetarë. Është një vend shumë miqësor. Kemi krijuar një vend ku gratë nuk ndihen në institucion apo organizatë, por si në shtëpi të veten. Ato ndajnë problemet, bisedojnë dhe e dinë që ajo çka flitet mbetet brenda katër mureve", thotë Murati.

Ajo e di që gratë kanë nevojë për mbështetje dhe për një adresë të përbashkët. Këtë e ka përjetuar në lëkurë të vet kur erdhi të jetojë në një vend të panjohur.

"Kur kam ardhur këtu më kanë endur nëpër dyer për formularë, gjuhë, ligje. Ideja ka qenë ta bëjmë një derë ku çdo grua mund të trokasë dhe ku ka kush t'i presë, t`ua shpjegojë procedurat, ta zvogëlojë mundimin", thotë ajo.

Organziata e udhëhequr nga ajo funksionon në bazë të projekteve dhe të bashkëpunimeve të shumta me organizata e institucione. Në fillim ishte sfidë grumbullimi i përfituesve, por tash në çdo thirrje të "Lady" ka më shumë kërkesa sesa mundësi për pjesëmarrje. "Çdoherë kemi

problem që kemi shumë të interesuar në çdo thirrje", thotë Sanija. Por ajo nuk ndalet as me sfidat, as me mungesën e resurseve. Përkundrazi, shtrirja e saj ka kaluar edhe kufijtë e Kosovës. Ajo thotë se gratë, vajzat, nënat sot përballen pothuajse me të njëjtat probleme dhe situata, pavarësisht nëse jetojnë në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni, Kosovë apo Serbi. Përmes "Lady" dhe rrjetit të saj, Sanija po ndërton ura të reja bashkëpunimi, dhe një hapësirë ku gratë mund të ndihen të barabarta – jo vetëm me njëra-tjetrën, por edhe me mundësitë që u mohohen.

"Një gjë tjetër që promovojmë shumë është paqja. Gjendja është jostabile gjithkund, njerëzit janë shumë të

Through training, consulting, networking, and collaboration with business organizations, 'Lady' reaches women from all categories and segments of society with the goal of strengthening their economic independence and building trust through economic engagement.

"Once I acquired the language, I began to take this work much more seriously. What we first introduced to Prishtina, and not only here but also in Kosova, were shaped sweets. But later, we expanded over different topics that emerged from fieldwork. During the coronavirus period, we provided psychosocial counseling. I'm very happy that other organizations followed in our footsteps," Sanija begins her story.

Located in a well-frequented venue of the city, the NGO 'Lady' is a warm and trustworthy environment for women from all communities of Kosova.

"'Lady' boasts of having 130 volunteers, and we are the only association with so many. It's a very friendly place. We succeeded in creating a space where women don't feel like they are residing in an institution or organization, but in their own home. They share their problems, talk freely, and know that whatever is spoken remains within these four walls," says Murati.

She is aware women need support and a shared address. It is something she felt deep in her skin when she came to live in an unfamiliar place.

"When I arrived here, I was sent from door to door for documents, language, laws. Our main idea was to make a door where any woman could knock, and there would be someone to receive them, explain the procedures, and ease the struggle," she says.

The organization she leads functions through projects and numerous partnerships it maintains with institutions and other organizations.

At the very beginning, it was a challenge to muster beneficiaries, but now every call by 'Lady' receives more applications than they can accommodate.

shqetësuar, më shumë heshtin sesa që flasin. Mendojmë edhe si individë, edhe si organizatë nëse gjithkush prej nesh jep kontribut për paqe, u themi jo politikave që po nxisin luftë", thotë ajo.

Në një shoqëri ku shpesh gratë kanë mungesë qasjeje në informim, punësim dhe mbështetje psikosociale, "Lady" qëndron si një shtyllë e rëndësishme e shpresës dhe një dëshmi që një grua e vetme mund të ndërtojë një derë ku shumë të tjera mund të trokasin. Ky model funksionon dhe flet vetë përmes atyre që e kanë përjetuar. Gratë që kanë trokitur në këtë derë janë të shumta. Edhe më të mëdha janë sukseset e tyre, që i kanë ndarë në një botim "Sucsses stories" të publikuar nga organizata.

Një nga përfitueset, Zymrije Murturi, ka shkruar se "trajnimet kanë ndikuar shumë mirë në përgatitjen për biznes, në njohjen e njerëzve të rinj dhe hapat që duhet t'i ndërmarrë në biznesin tim. Jam shumë mirënjohëse për të gjitha."A-jo ka ndjekur kursin e rrobaqepësisë të ofruar në kuadër të aktiviteteve të organizatës dhe ka hapur dyqanin e saj të rrobaqepësisë.

Ndërsa Qëndresa Thaçi-Govori, e cila sot zhvillon markën e saj të bizhuterive, ka shkruar për admirimin e saj që ka për atë që i hapi dyert. "Sanija më ka dhënë forcë dhe guxim të vazhdoj tutje në jetë dhe në punën që bëj. Jam shumë krenare që jam pjesë e "Lady'"

"701 fshatra" sjell traditën në qytet

Në një rrugicë që çon drejt pjesës së vjetër të Prishtinës, në zemër të Tregut të gjelbër, është hapur një dyqan i vogël që ka një mision të madh. "701 Villages" (701 Fshatra) është një hapësirë ku gratë nga fshatrat e Kosovës shesin produkte të punuara me dorë, të frymëzuara nga trashëgimia kulturore dhe jeta rurale. Në dyqanin e vogël në hapësirë, ruhen vlera të mëdha të trashëgimisë. Aty janë ekspozuar suvenire të ndryshme, rroba të trashëguara ndër breza – si jelekë prej ari, kukulla punëdore, jastëkë, çanta, mbulesa etj. Çdo vizitor mund ta marrë një copë Kosove prej aty.

Në një moment, kur u pa se shumë gra nga fshatrat ishin të izoluara nga mundësitë për shkak të distancës, mentalitetit apo mungesës së infrastrukturës, "Lady" ndërmori një aksion.

"Një prej ideve, nevojave ka qenë që të punojmë me gratë e fshatrave, t`i afrojmë me tregun, sepse ishin të kufizuara për shkak të mentalitetit, largësisë, transportit, kushteve", thotë ajo.

Dyqani "701 Villages" nuk shet produkte të importuara, por vetëm punime autentike, që pasqyrojnë mjeshtërinë, traditën dhe shijen vendore.

"Specifikë është që grave ne ua mësojmë disenjet që t'i bëjnë moderne dhe

"We always have the 'problem' of receiving way too much interest in every call," says Sanija. Yet she is willing to overcome any challenge or lack of resources.

Furthermore, her NGO now surpasses Kosova's borders. She states that today, women, girls, and mothers are encountering almost the same problems and situations, no matter whether they live in Albania, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, North Macedonia, Kosova, or Serbia.

Through 'Lady' and its network, Sanija is forging new bridges of cooperation and a space where women can feel equal – not just with one another, but also with the opportunities so often denied to them.

"Another thing we promote a lot is peace. The times are precarious everywhere, people are anxious, and many prefer silence over speech. We believe, as individuals and as an organization, that if each of us contributes to peace, we say no to the politics that incite war," she says.

In a society where women often lack access to information, employment, and psychosocial support, 'Lady' stands as a vital pillar of hope and a living testament to how a single woman can build a door at which many other women may one day knock. This model works and speaks for itself through the lives it has affected. Many women have knocked on that door. Even greater are their successes, which have been collected in a publication entitled "Success Stories" issued by the organization.

One of the beneficiaries, Zymrije Murturi, wrote: "The training sessions were profusely helpful in preparing me for business, in meeting new people, and in learning the steps I need to take in my own business. I am very grateful for everything."

She completed the sewing course offered as part of the organization's

të përshtatshme për tregun, e mandej i shesim. Varësisht nga marrëveshja me to, disa nuk kanë mundësi as materialet bazë t'i blejnë," thotë Sanija.

Veçantia e kësaj qëndron edhe në qasjen gjithëpërfshirëse, por dhe në fokusin për të kthyer trashëgiminë kulturore në potencial ekonomik.

"Në lokal do të ketë edhe produkte ushqimore, se në Kosovë ka produkte shumë interesante. Edhe gjatë ditëve të shënuara dalim dhe i shesim ato produkte", shpjegon ajo.

Tashmë është në proces edhe lansimi i platformës on-line, ku njerëzit, brenda dhe jashtë Kosovës, do të mund të blejnë produkte të "701 Villages" dhe kështu të kontribuojnë në fuqizimin e grave fshatare dhe në ruajtjen e traditës.

"Shpresojmë që do të kemi bashkëpunim me ambasadat, me Komunën e Prishtinës, se janë produkte që, nëse e blen dikush, pos që merr një dhuratë të bukur, e fuqizon një grua, një nënë kryefamiljare, një nënë fshati apo dikë që ka nevojë", thotë ajo.

Ky projekt, që për nga natyra është edhe social, edhe ekonomik, edhe kulturor, është shembull i asaj që Sanija e quan "fuqi që lind nga mungesa".

"Kur jeton në një vend, nuk i sheh mungesat. Kur vjen prej jashtë, i vëren mangësitë. E ndoshta ai ka qenë momenti – se atëherë s'kisha as vetë nga të filloj. Gjuhë s'kam ditur, dhe kam thënë: për të filluar punën që dua, duhet të filloj diku", thotë ajo.

Ajo që nisi si një derë për t'i ndihmuar gratë me këshillim dhe trajnime, sot është bërë një dritare për botën që tregon fytyrën e Kosovës përmes dorës së një gruaje që punon me pasion dhe dinjitet. Ndërkohë OJQ "Lady" po vazhdon zbatimin e tri projekteve, ndërsa planet janë të shumta. E synimi i radhës i saj është shkëmbimi i përvojave dhe ekspozimi i punës së grave nëpërmjet panaireve në qytete të ndryshme.

activities and has since opened her own tailoring shop.

Meanwhile, Qëndresa Thaçi-Govori, who today runs her own jewelry brand, showed her admiration for the person who opened the door for her: "Sanija gave me the strength and courage to move forward in life and in my work. I'm very proud to be part of 'Lady.'"

"701 Villages" Brings Tradition into the City

In a small pathway leading to the old part of Prishtina, at the heart of the Green Market, a tiny shop has been opened that carries a great mission. '701 Villages' provides a space where women from Kosova's villages sell handmade products inspired by cultural heritage and rural life. Within this small shop, great values of heritage are preserved. On display there are various souvenirs, garments passed down through generations, like gold-threaded vests, handmade dolls, pillows, bags, covers, and more. Every visitor can take home a piece of Kosova from there.

At a moment when it became clear that many rural women were deprived from opportunities due to distance, mentality, or lack of infrastructure, 'Lady' took action.

"One of the ideas, was to work with women in villages and bring them closer to the market, because they were constrained by mentality, distance, transportation, and conditions," she says.

The '701 Villages' shop doesn't sell imported goods but only authentic creations that reflect local craftsmanship, tradition, and taste.

"What's unique is that we teach women how to make modern, market-ready designs, and then we sell them. Depending on the agreement, some can't even afford the basic materials," says Sanija.

What makes distinct the shop is its inclusive approach and its focus on transforming cultural heritage into economic potential.

"There will also be food products in the shop, because Kosova has some very interesting items. We also go out and sell them during special days," she further explains.

The launch of an online platform is already underway, where people from both inside and outside Kosovo will be able to purchase '701 Villages' products, thus contributing to rural women's empowerment and the preservation of tradition.

"We hope to collaborate with embassies, with the Municipality of Prishtina, because these are products that, when bought, are not just a beautiful gift, they empower a woman, a single mother, a village mother, or someone in need," she says.

This project, which is social, economic, and cultural in nature, is an illustration of what Sanija calls "power arising from absence."

"When you live in a place, you don't see the shortages. But when you come from outside, you notice what's missing. And maybe that was the moment, because back then, I didn't even know where to begin. I didn't know the language, and I said: to start the work I want, I have to start somewhere," she says.

What began as a door to support women through counseling and training has today become a window to the world, showing Kosova's face through the hands of a woman working with passion, heritage, and dignity. Meanwhile, the 'Lady' NGO is currently implementing three projects, and many more are set. Its next focus will be on experience exchange and showcasing women's work through fairs in different cities.

OBSERVATORI: NGA PRISHTINA DREJT GJITHËSISË

Rrëfimi i një trashëgimie që i shpëtoi harresës

SABIT **GASHI**

Në një kohë kur bota fliste për garën hapësinore, Kosova e viteve '80 kishte ndërtuar rrjetin e saj të vogël të laboratorëve të hapur – klube shkencore, kampe malore, revista studentore dhe një observator astronomik që më shumë se gjithçka tjetër simbolizonte ëndrrën për dije përtej kufijve.

Ky artikull sjell në dritë historinë e "Hulumtuesve të Rinj të Kosovës" - (HRK), një lëvizje rinore që i paraprin shumë koncepteve moderne të edukimit joformal, dhe e lidh këtë trashëgimi me rinisjen e Observatorit të Prishtinës – një institucion që, pas 35 vitesh heshtjeje, është rikthyer si pikë takimi për rininë dhe shkencën.

Klubi i parë: Astronomët amatorë në një vend pa teleskopë

Në fund të vitit 1977, në atmosferën e zgjimit kulturor të Prishtinës dhe pak para përfundimit të ndërtimit të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, një grup i pasionuar të rinjsh formuan Klubin e Astronomëve Amatorë të Kosovës – nismën e parë të këtij

OBSERVATORY: FROM PRISHTINA TO THE COSMOS

A Story of a Legacy that Escaped Oblivion

At a time when the world was bustling with talk of the space race, Kosova during the 1980s had built its own small network of open laboratories – science clubs, mountain camps, student magazines, and an astronomical observatory that, more than anything else, embodied the dream of knowledge beyond borders.

This article sheds light on the story of the "Young Researchers of Kosovo" (YRK), a youth movement that anticipated many modern concepts of informal education, and connects this legacy with the revival of the Prishtina Observatory – an institution that, after 35 years of silence, has returned as a meeting place for youth and science.

The First Club: Amateur Astronomers in a Land Without Telescopes

At the end of 1977, in the air of Prishtina's cultural awakening and shortly before the completion of the Palace of Youth and Sports, a group of young aficionados founded the Amateur Astronomers' Club of Kosova – the first initiative of its kind in the region. Initially based in one of the auxiliary halls of the Palace, the club quickly became the nucleus of a broader organization named the Young Researchers of Kosovo (YRK).

At first, YRK operated as part of extracurricular activities supported, and at times supervised, by the League of Socialist Youth of Kosova (LRSK), which at the time represented the institutional youth framework in society. But very soon, due to the entirely scientific and educational nature of its work,

lloji në rajon. Ky klub, i vendosur fillimisht në një nga sallat ndihmëse të Pallatit, shpejt u shndërrua në bërthamën nga e cila do të lindte një organizatë më e gjerë, me emrin Hulumtuesit e Rinj të Kosovës (HRK). Fillimisht ajo vepronte si pjesë e aktiviteteve të lira të mbështetura (dhe herë-herë të kontrolluara) nga Lidhja e Rinisë Socialiste të Kosovës (LRSK), e cila në atë kohë përfaqësonte kuadrin rinor institucional të shoqërisë. Por, shumë shpejt, për shkak të përmbajtjes krejtësisht shkencore dhe edukative të punës së saj, aktivitetet e HRK-së u dalluan dhe u mbështetën edhe nga buxheti publik i kohës. Ajo që e bënte HRK-në të veçantë ishte pavarësia metodologjike: të rinjtë jo vetëm që organizonin kurset dhe programet vetë, por edhe hartonin vetë kurrikulat, eksperimentet dhe projektet kërkimore. Ishte një edukim i bazuar jo në detyrime formale, por në kureshtje të vërtetë dhe bashkëpunim të lirë.

Kampet malore si laboratorë të lirë

Në bashkëpunim me mjekë të rinj, biologë dhe mësues en-

YRK's activities gained further recognition and received support from public funding. What set YRK apart was its methodological independence: young people not only organized the courses and programs themselves but also designed the curricula, experiments, and research projects. It was an education based not on formal obligations, but on genuine curiosity and free collaboration.

Mountain Camps as Open-Air Laboratories

In cooperation with young doctors, biologists, and enthusiastic teachers, YRK hosted scientific camps in the Albanian Alps and the highlands of Kosova. In these camps, young participants carried out ecological measurements of water and soil, medical testing, tourism and ethnological research, astronomical observations during clear nights, simple field experiments based on what we now call STEM principles, and hosted scientific conferences and debates.

tuziastë, HRK-ja organizonte kampe shkencore në Alpet Shqiptare dhe në bjeshkët e Kosovës. Në këto kampe të rinjtë bënin: matje ekologjike të ujërave dhe të tokës, matje medicinale, hulumtime turizmologjike, etnologjike, vrojtime të trupave qiellorë në netët e kthjellëta, eksperimente të thjeshta në terren sipas parimeve të asaj që sot e quajmë STEM dhe konferenca shkencore e debate nga HRK-ja. Nxirrej edhe revista "Buletini", që përpos raporteve të këtyre hulumtimeve, botonte edhe ese, poezi dhe përshkrime të jetës kulturore të kryeqytetit. Ishte një dritare e rrallë e një Kosove që kërkonte dije përmes eksplorimit dhe bashkëjetesës në natyrë. Por, bashkëpunimi me ish-republikat e tjera ishte interesant dhe i rregullt.

Pse u mbyll gjithçka?

Me fillimin e viteve '90 dhe përkeqësimin e klimës politike, aktivitetet e HRK-së u ndaluan. Arsyeja zyrtare ishte "mosshlyerja e qirasë" për ambientet në qendrën kulturore "Boro e Ramizi", por në të vërtetë, ndalimi pasqyronte indiferencën politike ndaj shkencës dhe edukimit të lirë. Klubet u shuan një nga një. Revista nuk u botua më. Dritat e Observatorit u fikën.

Nga heshtja te rilindja, - pas më shumë se 35 vitesh mbylljeje, në vitin 2022, Observatori i Prishtinës u rihap zyrtarisht me përkrahjen e kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama. Që nga ajo kohë, ai është kthyer në një hapësirë për edukim jashtëshkollor, art dhe frymëzim kulturor për brezin e ri.

Koha për trashëgimi

Fqinjët tanë, si Kroacia me Observatorin Visnjan ka zbuluar afër 2000 asteroidë dhe disa kometa. Falë kësaj, Observatori Visnjan merr donacione të rregullta nga NASA, por edhe krijon kuadro të rinj për nevojat e agjencisë NASA. Serbia me Stacionin Petnica, e ka promovuar këtë trashëgimi edhe përmes UNESCO-s, duke e paraqitur edukimin joformal shkencor si pjesë e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Pse të mos e bëjë edhe Kosova të njëjtën gjë?

HRK-ja, kampet malore dhe Observatori i Prishtinës përfaqësojnë një model unik të edukimit të lirë, të rrënjosur në vlera qytetare dhe bashkëpunim ndërbrezor. Është koha që kjo trashëgimi të dokumentohet, të ruhet dhe ta promovojë Kosovën si një vend që e ka dashur dhe e do dijen – edhe kur dritat ishin fikur.

Rilindja përmes artit dhe shkencës: Observatori i Prishtinës dhe Manifesta 14

Pas më shumë se tri dekadash mbylljeje dhe harrese, në vitin 2022, Observatori i Prishtinës u rihap zyrtarisht nga Kryetari Rama. Kjo ngjarje nuk ishte vetëm një rikthim fizik i një ndërtese simbolike të trashëgimisë

They also published the Buletini magazine, which, alongside reports on their research, featured essays, poetry, and accounts of the capital's cultural life. It was a rare window into a Kosova that pursued knowledge through exploration and shared living in nature. Notably, cooperation with the other Yugoslav republics was both consistent and engaging.

Why Did Everything Shut Down?

With the onset of the 1990s and the deteriorating of political climate, the activities of the Young Researchers of Kosova came to a halt. The official reason given was "nonpayment of rent" for the premises at the cultural center "Boro and Ramiz," but in reality, the shutdown reflected a broader political indifference toward science and free education. One by one, the clubs dissolved. The magazine ceased publication. The lights of the Observatory went off.

For silence to Revival – After more than 35 years of closure, in 2022, the Prishtina Observatory was officially reopened with the support of the Mayor of Prishtina, Përparim Rama. Since then, it has become a space for extracurricular education, art, and cultural inspiration for the younger generation.

Time for Legacy

Our neighbors, such as Croatia with its Višnjan Observatory, have discovered nearly 2,000 asteroids and some comets. As a result, the Višnjan Observatory receives regular funding from NASA and helps train young professionals for the agency's needs. Serbia, through the Petnica Science Center, has promoted this legacy through UNESCO, presenting informal science education as part of cultural heritage and sustainable development. Why shouldn't Kosova do the same? The Young Researchers of Kosova (YRK), the mountain science camps, and the Prishtina Observatory represent a unique model of free education, rooted in civic values and

shkencore të Kosovës, por edhe një kthesë drejt një të ardhmeje ku shkenca, edukimi dhe arti bashkëjetojnë në të njëjtin hapësirë vizioni.

Pikërisht në këtë atmosferë, Manifesta 14 Prishtina – bienalja ndërkombëtare e artit bashkëkohor – zgjodhi Observatorin si një nga lokacionet kyçe të edicionit të vitit 2022. Kjo përfshirje nuk ishte rastësi: Observatori, me historinë e tij të lidhur ngushtë me edukimin joformal dhe hulumtimet shkencore të të rinjve të Kosovës, përfaqësonte pikërisht atë që bienalja synonte të promovonte – hapësira që krijojnë lidhje të reja midis komunitetit, teknologjisë dhe imagjinatës.

Gjatë festivalit, Observatori u kthye në një "meeting point" të vërtetë – një qendër takimesh, diskutimesh dhe eksplorimesh mes astronomëve të rinj të Kosovës dhe qindra artistëve ndërkombëtarë, të cilët ndanë mendime mbi artin bashkëkohor, zhvillimin e qëndrueshëm dhe marrëdhëniet e reja midis njeriut dhe universit. Në kuadër të instalacioneve të Manifesta-s, në hapësirat e Observatorit u vendos edhe një kënd i veçantë ekspozimi për teleskopët, një simbol i qartë se syri drejt yjeve nuk ka nevojë për ndalesa, por për hapje të reja.

Shtypi ndërkombëtar, si The Art Newspaper, e-flux, dhe Domus, e përmendi këtë përfshirje të Observatorit të Prishtinës si shembull frymëzues të përfshirjes së trashëgimisë në diskursin bashkëkohor artistik dhe qytetar. Ky "rikthim në hartë" nuk ishte vetëm kulturor, por edhe politik, në kuptimin më të mirë të fjalës: një thirrje për të ripërdorur hapësirat publike për qëllime të emancipimit qytetar dhe edukativ.

Për astronomët e rinj të Kosovës, kjo ishte një mundësi e rrallë për të bashkëbiseduar jo vetëm me kolegë të tyre, por edhe me krijues vizionarë nga e gjithë bota, për të ndarë ide rreth rolit të shkencës në një shoqëri të hapur dhe progresive. Bukuria e kësaj ngjar-

intergenerational cooperation. It is time for this legacy to be documented, preserved, and used to promote Kosova as a country that has always valued knowledge – even when the lights were turned off.

Revival Through Art and Science: The Prishtina Observatory and Manifesta 14

After more than three decades of closure and neglect, the Prishtina Observatory was officially reopened in 2022 by Mayor Përparim Rama. This event marked not only the physical return of a symbolic building of Kosova's scientific heritage, but also a watershed moment toward a future where science, education, and art coexist within a shared space of vision.

Carrying this spirit, Manifesta 14 Prishtina, the international biennial of contemporary art, chose the Observatory as one of its key venues for the 2022 edition. This inclusion was no coincidence: the Observatory, with its deep-rooted history in informal education and youth-led scientific research, embodied precisely what the biennial sought to promote, namely spaces that foster new connections between community, technology, and imagination.

During the festival, the Observatory became a true meeting point – a hub for encounters, dialogue, and exploration between young astronomers from Kosova and hundreds of international artists. Together, they exchanged ideas on contemporary art, sustainable development, and the evolving relationship between humanity and the cosmos. Among the Manifesta installations, a special exhibition area was dedicated to telescopes – it was a clear symbol that the gaze toward the stars needs no limits, only new openings.

International media such as The Art Newspaper, e-flux, and Domus highlighted the Observatory's inclusion as an inspiring example of integrating heritage into contemporary artistic and civic discourse. This "return to the map" was not just cultural, but political in the best sense of the word, indeed a call to reclaim public space for civic and educational empowerment.

For Kosova's young astronomers, this was a rare opportunity to converse not only with their peers but with visionary creators from around the world, sharing ideas about the role of science in an open and progressive society. The beauty of this event lay in its synthesis – where

jeje ishte pikërisht në ndërthurjen – aty ku teleskopi dhe instalacioni artistik takoheshin, ndodhte diçka më shumë sesa vrojtim: ndodhte kuptimi i përbashkët i së ardhmes.

Misioni i Hulumtuesve të Rinj të Kosovës ishte të përdornin njohuritë shkencore – duke filluar me astronominë dhe duke u shtrirë në shkencat e tjera – përmes programeve edukative të bazuara në mësimin jashtëkurrikular dhe vullnetarizëm. Synimi i tyre ishte të krijonin një forcë nxitëse në shoqëri, duke fuqizuar të rinjtë që të mendonin në mënyrë kritike, të vepronin me përgjegjësi dhe të kontribuonin me kuptim në komunitetet e tyre.

Kjo është bukuria e Observatorit të Prishtinës – jo vetëm si ndërtesë, por si platformë e ideve të reja që ndërthurin edukimin, shkencën, artin dhe kujtesën. Është një trashëgimi e gjallë, që vazhdon të evoluojë, duke ndriçuar jo vetëm yjet në qiell, por edhe horizontet e brezave të rinj në tokë.Kur të rinjtë ngjiteshin në Bjeshkë për të parë yjet me teleskopët e vegjël artizanalë, ata ndoshta nuk e dinin, por ëndërronin që po krijonin një trashëgimi që sot ka vlerë më shumë se kurrë. Kjo është ftesë për ta kujtuar atë rrugëtim dhe për ta ndërtuar të ardhmen mbi dritën e tij. Ndërsa sot Kosova ka dy observatorë, një në Prishtinë dhe tjetrin, Observatorin Nacional, në Shtime që udhëhiqen nga dy të rinj entuziastë - Suhel Ahmeti dhe Pranvera Hyseni.

telescope and artistic installation converged, something more than observation took place: a shared understanding of the future emerged.

The mission of the Young Researchers of Kosova was to use scientific knowledge – beginning with astronomy and expanding into other sciences – through educational programs based on extracurricular learning and volunteerism. Their aim was to become a driving force in society, empowering young people to think critically, act responsibly, and contribute meaningfully to their communities.

This is the beauty of the Prishtina Observatory – not just as a building, but as a platform for new ideas that merge education, science, art, and memory. It is a living legacy, one that continues to evolve, illuminating not only the stars above, but also the horizons of the younger generations on Earth.

When young people once climbed the highlands to observe the stars with small handcrafted telescopes, they may not have known it, but they dreamed of creating a legacy – one that today holds more value than ever before. This is an invitation to remember that journey, and to build the future in the light it cast.

Today, Kosova has two observatories: one in Prishtina, and the other – the National Observatory in Shtime – led by two enthusiastic young scientists, Suhel Ahmeti and Pranvera Hyseni.



Bekim Fehmiu
(1936 – 2010)

Portret i realizuar nga artistja Engji Jaha

Portrait created by the artist Engji Jaha

“Nusja” (Bride)
Shqipe Kamberi (2017)

Teknikë e kombinuar mbi pelhurë
Mixed media on canvas